


PIKA TË TJERA

MISTERI
MËSHIRA
RRËMUJOLOGJIA



GEORGE VERWER

“Nganjëherë jeta më duket rrëmujë e madhe; ma merr mendja se kjo është arsyeja pse jap mësim ‘Rrëmujologjinë’, që Perëndia në mëshirën dhe misterin e Tij shpesh bën gjëra të mëdha në mes të rrëmujës.”

Në librin e Tij më biografik deri më sot, George Verwer ushtron sinjeritetin e tij të shumëdashur dhe realizmin rifreskues, duke ndarë dëshitimet e tij personale dhe duke parë sesi Perëndia punon përmes situatave të rrëmujshme.

Udhëtoni me këtë njeri të madh besimi ndërsa shpjegon se ndonëse gjithçka që prekim ka dobësitë dhe të metat e saj, Perëndia punon përmes natyrës sonë të rënë dhe qenies sonë njerëzore. Për George, misteri i mistereve është sesi Perëndia vazhdon të bëjë gjëra të mrekullueshme në mes të gjithë kësaj.

Bashkujuni George tek “Pika të Tjera: Misteri, Mëshira dhe Rrëmujologjia” (*More Drops: Mystery, Mercy and Messiology*) dhe festoni atë që Perëndia ynë i madh po bën dhe pjesën që ne mund të kemi në veprën e Tij.


“Ky është Verwer tipik! Më shumë se pika të marra nga një rubinet që pikon, ai përmban perla të zgjedhura nga një njeri i sinqertë.”

Rev. Dr. Toni Sarxhent
Drejtor Emeritus i International Christian College

George Verwer themeloi “Operation Mobilization” (OM) thujse 60 vjet më parë dhe ishte Drejtor Ndërkombëtar për 46 vjet. Bashkë me bashkëshorten e tij, Drena, George është akoma i përfshirë në këtë lëvizje me kohë të plotë dhe vazhdon të jetë Drejtor i Shërbesës së Projekteve të Veçanta.

PIKA TË TJERA

MISTERI
MËSHIRA
RRËMUJOLOGJIA



GEORGE VERWER

“Më pëlqen shumë Xhorxh Veruer dhe më pëlqen shumë ky libër! Ka pak njerëz në botë në pozitë më të mirë për të folur në mënyrë provokuese rreth jetës së një kishe sesa Xhorxhi, i cili për dekada i ka rënë rrotull globit dhe ka ndjekur pareshtur më të vegjëlit, të fundit e të humburit. Gjatë rrugës, me ndihmën e Perëndisë, ai ka prodhuar lëvizjen më të shënuar, e cila ditë pas dite sheh mijëra njerëz të prekur nga ungjilli.”

Andi Hothorn (Andy Hawthorne) OBE është ungjilltar britanik, autor dhe themelues i The Message Trust.

“Për mëse 50 vjet, Veruer ka qenë pajtues i drejtuar nga hiri, mik i mëkatarëve, far i urtësisë praktike. Pikërisht i tillë është ky libër – jo melodramë, libër studimesh, por manual i kuptimeve biblike të zbatuara nga përvoja, të cilat mund ta ndihmojnë lexuesin për të shmangur ngecjen në cekëtinat e jetës.”

Dr. Greg Livingstoun (Greg Livingstone), themelues i Frontiers

“Ky është Veruer tipik! Në këtë libër, një ndër predikuesit më të shkëlqyer të ditëve tona merr thjeshtësinë dhe pasionin që mbërthejnë shërbesën e tij të folur ndërsa trajton çështje me pasoja të mëdha për Kishën e krishterë. Ky libër i hollë e i lexueshëm është klasik në teologjinë praktike dhe dishepullimin praktik. Më shumë se pika të marra nga një rubinet që pikon, ai përmban perla të zgjedhura nga një njeri i sinqertë. Do t’u lë në dorë një kopje të këtij libri të gjithë studentëve të mi.”

Rev. Dr. Toni Sarxhent (Tony Sargent), Drejtor Emeritus i International Christian College

“Gjatë filmimit, udhëtimit dhe punës me Xhorxhin jam bekuar shumë nga ‘pikat e Ujit të Gjallë’ që ai ndan çdo ditë, jo vetëm në intervista, por në mënyrën sesi e jeton jetën e tij. Kam qenë i privilegjuar, por edhe lexuesit do të bekohen, frymëzohen, nxiten

dhe do të kapin të njëjtin pasion që ka Xhorxhi – që bota të mund ta dijë dhe ne të bëhemi më shumë si Jezusi.”

**Malkolm Tërner (Malcolm Turner), Drejtor Ekzekutiv
i Christian Television Association**

“Kjo është më e mira e Xhorxh Veruer! Secili kapitull qëndron më vete dhe do të gjeni pjesë të paçmueshme të së vërtetës në secilin prej tyre. Mendoj se fjala ‘rrëmuologji’ do të përdoret rëndom së shpejti.”

**Piter Meiden (Peter Maiden), ish-Drejtor i Keswick
Convention, Drejtor Ndërkombëtar Emeritus i OM.**

“Ky është libër i frymëzuar dhe duhet lexuar PATJETËR! Lartësitë, thellësitë dhe gjerësitë e tij do të na japin neve, lexuesve, një pasqyrë përmes së cilës të shqyrtohemi në ecjen tonë shpirtërore. Sfidat janë dëshmi nga Xhorxhi të mënyrës sesi Perëndia ynë, përgjatë Shkrimit dhe bashkudhëtarëve, e ka ndikuar, forcuar dhe nxitur të ecë përpara, dhe jam i bindur se do të prekin çdo pjesë të udhëtimit tonë shpirtëror.”

**Robin Ouk (Robin Oake), ish-Komisar i Përgjithshëm Policie
dhe autor i “Father Forgive: The Forgotten ‘F’ Word”)**

“E shijova shumë udhëtimin nëpër kapitujt e shkurtër dhe energjikë. Ka humor në këtë libër dhe një klithmë zemre për realitet, përlulesi dhe ekuilibër.”

**Majkëll Uiltshër (Michael Wiltshire), ish-
gazetar i The Financial Times**



eBooks for download
east.om.org/ebooks



Originally published in English under the title
More Drops by George Verwer
Copyright © 2015 George Verwer
International rights from Roy Hession Book Trust

© 2020 by OM EAST for the Albanian edition.
Translated by permission. All rights reserved.
ISBN: 978-9928-295-53-8

Përktheu: Albert Hysa
Redaktoi: Enkeleda Hebibasi
Graphics & Layout: OM EAST

Citimet e Shkrimit janë marrë nga Bibla. E drejta e autorit ©Shoqëria biblike shqiptare (ABS), Tiranë. Përdorur me leje. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

eBooks for download: east.om.org

Shtypur në shtypshkronjën “Vision Printing shpk”, Tiranë 2020
Tirazhi: 1000 kopje

KUSHTIM

Ky libër u kushtohet të gjithë njerëzve që kam takuar, përmes OM-së ose në një mënyrë tjetër, për të cilët, duke folur nga ana njerëzore, jeta nuk ka shkuar shumë mirë. Këta njerëz nuk janë tek plani A ose B, por diku tek plani M. Kur flas me ta, u kujtoj alfabetin e madh të Perëndisë dhe i nxis të përqafojnë hirin rrënjësor dhe të vazhdojnë përpara.

Më kujtohet vazhdimisht 1 e Gjonit 3:16: “Nga kjo e kemi njohur dashurinë: Jezus Krishti dha jetën e vet për ne. Dhe ne duhet ta japim jetën tonë për vëllezërit.”

MIRËNJOHJE

Dua të falënderoj të gjithë ata që kanë ndihmuar për ta bërë këtë libër realitet. U jam mirënjohës, në veçanti, atyre qindra njerëzve që kanë patur ndikim të madh shpirtëror në jetën time (nganjëherë përmes kasetave ose librave). Së pari babait tim shpirtëror, Billi (Billy) Graham, dhe drejtuesit të dytë të krishterë me më shumë ndikim tek unë, Dr. Osuëlld (Oswald) J. Smith. Dua gjithashtu të falënderoj Zotin në mënyrë të veçantë për motrën time Barbara, prindërit e mi, bashkëshorten time Drena dhe gjithë familjen time.

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie	9
Hyrja	13
KAPITULLI 1: Rrëmuologjia	17
KAPITULLI 2: Fikëset e zjarrit, librat dhe Fjalët e Urta	24
KAPITULLI 3: Uniteti mes larmisë	33
KAPITULLI 4: Paradoksi, ndërlikimi, misterit dhe rrëmuologjia	38
KAPITULLI 5: Kisha, misionet dhe Holliudi	47
KAPITULLI 6: A duhet të jemi kaq dogmatikë?	52
KAPITULLI 7: Romanca, martesat, paraja dhe shumë mëshirë	56
KAPITULLI 8: Gabimet kushtojnë	67
KAPITULLI 9: Drejtuesit që përdor Perëndia	75
KAPITULLI 10: Adhurimi, ecja dhe mrekullia	81
KAPITULLI 11: Nëse nuk dëshiron të lëndohesh, mos luaj ragbi	88
KAPITULLI 12: Qaravitësit, ankuesit, bllokuesit dhe ata që mendojnë negativisht	92

KAPITULLI 13: Shpallja me shqetësim dhe veprim shoqëror	98
KAPITULLI 14: Një barrë dhe vizion që nuk kanë ndryshuar kurrë.	105
KAPITULLI 15: Ku shkojmë prej këtu?	110
Lexime të këshilluara	119
Vepra të tjera nga Xhorxh Veruer.	123

PARATHËNIE

“Pika të tjera: misteri, mëshira dhe rrëmujologjia” është libër i rëndësishëm për dy arsye: së pari, për autorin, dhe së dyti, për mesazhin.

Së pari, Xhorxh Veruer është themeluesi i agjencisë “Operation Mobilization” (OM), e cila, nën Perëndinë, ka qenë një ndër agjencitë misionare më të rëndësishme në botë në shekullin e njëzetë. Duke nisur nga fundi i viteve '50, OM-ja është e mirënjohur për:

- Përkushtimin e saj të fortë ndaj botimit, por edhe shpërndarjes së letërsisë së krishterë me vlerë jetëgjatë, si dhe për ndikimin ungjillëzues në shumë gjuhë dhe vende anembanë globit. OM-ja mbështeti fuqishëm daljen e botimit e parë të “Operation World”, burim i mrekullueshëm për të krishterët me mendje misionare.
- OM-ja ishte ndoshta agjencia e parë misionare në botë që theksoi dhe krijoi mundësi për shërbesë në mision afatshkurtër (ndonëse akoma i japin përparësi shërbesës gjatë gjithë jetës). Rrjedhimisht, shumë drejtues nga agjenci të tjera si “YWAM”, “IFES” dhe “Frontiers” kanë kaluar kohë me OM-në.
- Nën drejtimin e Xhorxhit, OM-ja zhvilloi gjithashtu Shërbesat me Anije “Logos”, “Doulos” dhe “Logos Hope”, të cilat kanë qenë mjet për t’ua çuar ungjillin miliona njerëzve.
- Kur konsiderohej e papërshtatshme, duke nisur nga vitet '60, OM-ja u përqendrua tek çuarja e ungjillit tek kulturat kundërshtuese ndaj ungjillit, si India (dhe nënkontinenti indian), Turqia, Evropa Lindore dhe Lindja e Mesme – të gjitha këto shërbesa po japin gjithnjë e më shumë fryt sot.

- Shumë agjenci të tjera misionare janë themeluar nga njerëz të formëzuar nga OM-ja; ndoshta më të dukshmet janë “Good Shepherd Movement” mes dalitëve të Indisë, dhe “Pioneers”, të përqendruar veçanërisht tek grupet e paarritura dhe qytetet kryesore.

Për shkak të këtyre risive krijuese dhe strategjike, shumë (përfshirë veten time) do ta konsideronin Xhorxh Veruerin si ndoshta drejtuesin dhe personalitetin misionar më të rëndësishëm që ka dalë nga Amerika e Veriut 60 vitet e fundit. Me këto të dhëna mbresëlënëse, po të më pyesnit mua, çfarëdo që ai shkruan ia vlen të lexohet!

Së dyti, është mesazhi. Ky libër përmbledh bindjet që i kanë mbajtur fort shërbesat e Xhorxhit dhe OM-së për thujtë 60 vjet, si:

- Nevoja themelore për të qenë i rrënjësuar fort në të vërtetat e Biblës, ndërsa tregohet hir ndaj atyre që kanë mendime ndryshe.
- Thirrja për dishepullim themelor për t'i shërbyer Krishtit, përfshirë një mënyrë jetese të disiplinuar, të gëzueshme dhe të perëndishme.
- Besimi i më së mirës rreth të krishterëve të tjerë, duke iu shmangur thashethemeve, i nevojës për shmangien e mbajtjes së mërisë dhe hidhërimit ndaj atyre që mund të na kenë lënduar dhe i bujarisë në shpirt gjatë bashkëpunimit me të tjerët.
- Besimi se në sovranitetin e Tij të mistershëm dhe sigurve, Perëndia mund të zgjedhë të sjellë shumë bekim, edhe nga shumë situata tepër të rrëmujshme (gjë që Xhorxhi e quan “rrëmujlogji”).
- Rëndësia e ekuilibrit mes shpalljes së guximshme të ungjillit dhe shërbesave të dhembshurisë.
- Ngutshmëria e vazhdueshme e arritjes së të humburve ose të paarriturve. Për këtë u rreh akoma zemra Xhorxhit dhe OM-së.

Këto janë bindjet që e kanë forcuar dhe drejtuar shërbesën e Xhorxhit për dekada të tëra; ia vlen t'i dëgjosh akoma.

Në kapitullin e fundit të “Pika të tjera” Xhorxhi thotë: “nëse mesazhi i misterit, mëshirës dhe rrëmujologjisë (dhe hirit) nuk është shfaqur në këtë libër, atëherë kam dështuar”. Ai nuk ka dështuar. Dhe për shkak të kësaj, këto bindje të një nxënësi dhe drejtuesi misioni gjatë gjithë jetës ia vlen vërtet të lexohen. Nëse përvetësohet dhe vihet në zbatim, ky libër mund t'i kthejë në dishepuj të rrënjosur (dhe të plotë) shumë nga brezi tjetër.

Linsi Braun (*Lindsay Brown*)

Drejtoreshë Ndërkombëtare e “Lausanne Movement for World Evangelisation”, 2008 e në vazhdim; Sekretare e Përgjithshme e “International Fellowship of Evangelical Students” (IFES), 1991-2007; ish OM-iste, 1976-1977

HYRJA

Misteri, mëshira, rrëmujologjia

Prej disa vitesh jam lutur dhe përpjekur që të shkruaj një libër tjetër. Nuk e shoh veten si shkrimtar të talentuar dhe nuk gjej shumë kohë për t'iu kushtuar, gjë që e bën edhe më të vështirë që të këmbëngul për këtë detyrë.

Pasioni im në lidhje me librat, i cili daton që prej kthimit tim në besim, ka qenë gjithmonë për librat e të tjerëve. Kam kaluar një jetë të tërë duke botuar dhe shpërndarë libra të autorëve të mëdhenj të krishterë, burra dhe gra. Edhe ndërsa kthej kokën pas dhe shoh librat e mi, mendoj se njëra ndër karakteristikat kryesore është mënyra sesi i prezantoj lexuesit e mi me aq shumë libra të tjerë. Nëse keni disa prej librave të mi të tjerë pse nuk i kontrolloni? Në fund të këtij libri gjendet një listë e titujve të mi të tjerë si dhe e atyre që rekomandoj, të shkruar nga autorë të tjerë.

Jam i mahnitur që mëse një milion kopje të librave të mi tani kanë udhëtuar nëpër botë në rreth 50 gjuhë të ndryshme. Njëri prej librave të parë, “Hunger for Reality” (Authentic Lifestyle 1996 – fillimisht i titulluar Come! Live! Die!) më ka sjellë mbi 25,000 letra personale. Kudo që shkoj, njerëzit më tregojnë sesi këta libra i kanë ndihmuar. Ka qenë nxitje e madhe dhe e vetmja gjë që mund të bëj është të falënderoj Zotin.

Në librin tim të mëparshëm, “Drops from a Leaking Tap” (Authentic Media, 2011), vetëm njëri kapitull përpiket të paraqesë ndryshimin më të madh në jetën time dhe historinë e Operation Mobilization (OM): përfshirjen e shqetësimit shoqëror dhe veprimit shoqëror si pjesë jetësore e shërbesës sonë. Në këtë libër të fundit, “Pika të tjera: misteri, mëshira dhe rrëmujologjia”, dëshiroj ta përpunoj më shumë këtë dhe atë që kam mësuar vitet

e fundit rreth sfidës dhe ndërlikimit të kësaj dhe sa e lehtë është të futesh në vështirësi.

Nuk di sesi ta shpreh, por ndiej se shumë drejtues dhe të krishterë po bëjnë gabime të mëdha në jetët dhe shërbesat e tyre. Meqenëse i kam bëra disa vetë, shpresoj që ajo që ndaj të mund t'i ndihmojë disa që të shmangin grackat.

Nga vëzhgimi, kam mësuar se në disa vështirësi nuk ka rrugëdalje pa dëmtuar rëndë veten dhe trupin e Krishtit. Siç do ta lexoni në kapitullin 1, kur isha 18 vjeç, ndërsa merresha akoma me fikjen e zjarreve, u nisa drej perëndimit për në Kanionin e Madh, duke lexuar librin e Veprave. Kjo më çoi drejt atij që e bëra varg të jetës sime në atë kohë:

“Por unë nuk dua t’ia di fare për jetën time që nuk e çmoj aq, sa ta kryej me gëzim vrapimin tim dhe shërbesën që mora nga Zoti Jezus, të dëshmoj plotësisht ungjillin e hirit të Perëndisë.”

(Veprat 20:24)

Tani që rikujtoj 58 vitet e kaluara në Krishtin, mund të them se kjo ka ndodhur që atëherë pak a shumë çdo ditë. Lutja ime, për sa vite mbeten, është që kjo të vazhdojë të jetë realitet. A mund ta ndjeni realitetin dhe pasionin e këtij vargu? A mund ta lexoni dhe ta bëni synimin dhe qëllimin e jetës suaj? Nëse po, mendoj se ky libër do të jetë i dobishëm për ju në më shumë se një mënyrë.

Ashtu si edhe tek “Drops from a Leaking Tap”, secili kapitull i “Pika të Tjera” mund të qëndrojë më vete. Për shkak të kujtesës sime, mund të ketë mbivendosje të lehta me disa gjëra të shkruara në libra të tjerë, ndonëse të lexosh diçka jetësore dhe të rëndësishme dy herë nuk na bën dëm.

Për të qenë i sinqertë, lutja ime është që “Pika të Tjera” do t’u japë njerëzve edhe dëshirën për të lexuar ose rilexuar librat e

mi të tjerë që janë radhitur në fund të këtij libri; në shumë vende janë të disponueshëm pa pagesë.

Lutja ime gjithashtu është që të tjerë do të na bashkohen për t'i përhapur këto mesazhe. Kam pasion të madh për t'i kaluar brezit tjetër sa më shumë të mundem nga ajo që kam mësuar nga Zoti dhe populli i Tij. Në disa mënyra, mënyra ime e të shkruarit mund të duket pak “jashtë kutisë”, por nga ana tjetër, është shumë themelore dhe jo e vështirë për t'u kuptuar, veçanërisht nëse njerëzit kanë edhe gjykim të shëndoshë edhe mprehtësi shpirtërore.

Ndërsa po përfundoj së shkruari këtë hyrje, po dëgjoj muzikë fantastike klasike në piano nga Çajkovski, Moxarti dhe Bethoveni. Para pak ditësh e çova Drenën, gruan time, në një koncert të madh tek Royal Albert Hall në Londër. Lutja ime është që të paktën një pjesë e asaj që shkruaj, veçanërisht rreth faljes dhe hirit, të jetë muzikë për veshët tuaj shpirtërorë, dhe jeta juaj, si pasojë e leximit të këtij libri, të bëhet më shumë si një simfoni nga ç'është në këtë kohë. Do të përpiqem të sjell në realitet dhe ekuilibër sfidën e dishepullimit rrënjësor të shprehur në libra si “Radical” (Random House, 2010) nga David Platt dhe “The Grace Awakening” (Thomas Nelson, 2006) nga Çarlz Suindoll (Charles Swindoll). Dua t'i shtoj kësaj, lutjen për mision dhe ungjillëzim global me çfarëdolloj çmimi, që të gjithë popujt e botës ta kenë ungjillin dhe që të ketë një Kishë mes të gjithë popujve. Shpresoj që disa që e lexojnë këtë libër të më bashkohen në këtë vizion të madh dhe detyrë të madhe. I përgjigjem secilit mesazh elektronik personalisht, kështu që provoni të më shkruani tek **george.verwer@om.org**

Në hirin dhe zotërimin e Tij,
Xhorxh Veruer

KAPITULLI 1

RRËMUJOLOGJIA

Kur shkruajta fillimisht “Out of the Comfort Zone” (Bethany House, 2000), një ndër barrat e mia më të mëdha ishte që të shihja më shumë një rizgjim hiri, veçanërisht mes atyre që ishin përfshirë më shumë në misione globale. Në fakt, kapitulli rreth “Hirit” u bashkua me kapitullin rreth “Udhëheqësisë” për të formuar një libër të vetëm të quajtur “Grace Awakened Leadership”, të cilin ne e japim falas. Dëgjojmë vazhdimisht për tensione mes atyre që punojnë për të arritur botën me ungjillin dhe shumë kisha lokale duket se kalojnë ndarje të mëdha dhe të ndërlikuara. Për të qenë i sinqertë, ndonëse dëgjojmë për shumë arritje në marrëdhënie, në disa situata gjendja në këtë fushë duket më keq se kurrë më parë.

Besoj se ajo që kam shkruajtur më parë nuk ia ka dalë për ta ndarë siç duhet teologjinë time të “rrëmujologjisë”, dhe dëshiroj të përpiqem ta bëj tani. “Rrëmujologjia” është term i imi, por në fakt është i gjithi për Perëndinë dhe mënyrën sesi Ai punon dhe ka punuar për mijëra vjet.

Bibla është plot me mësim dhe nxitje për të jetuar një jetë të perëndishme realiteti dhe integriteti. Nëse ndjekim 1 Korintasve 13, do të na ndryshojë plotësisht jetët dhe kishat tona. E ndava këtë edhe tek njëri prej librave të mi të mëparshëm, “The Revolution of Love” (Authentic Media, 2008).

Po të flisja gjuhët e njerëzve dhe të mos kisha dashuri, do të bëhesha si një bronx që kumbon

ose si cimballi që tingëllon. Edhe sikur të kisha dhuntinë e profecisë, edhe të dija të gjitha misteret dhe mbarë shkencën dhe të kisha gjithë besimin sa të luaja nga vendi malet, por të mos kisha dashuri, nuk jam asgjë. Edhe sikur të ndaja gjithë pasuritë e mia për të ushqyer të varfërit dhe të jepja trupin tim të digjej, e të mos kisha dashuri, nuk do të më vlente asgjë.

(1 Kor. 13:1-3)

Ne e shohim Perëndinë të punojë edhe përmes gjithë atyre lloj situatash që unë i quaj “të rrëmujshme”, nga ku e kam nxjerrë termin “rrëmujologji”. Për vite të tëra kam cituar fjalën time të urtë: “Aty ku dy a tre janë mbledhur në Emrin e Tij, herët a vonë, do të ketë rrëmujë.” Pothuajse gjithmonë bashkësia qesh. Pyes pastaj sesa e kanë përjetuar këtë dhe shumica e duarve ngrihen. Pas kësaj, vazhdoj duke shpjeguar rrëmujologjinë. Thënë thjesht, Perëndia, në durimin, mëshirën dhe pasionin e Tij për t’i sjellë burrat dhe gratë te Vetja, shpesh bën gjëra të mëdha në mes të rrëmujës. Ky nuk është justifikim për të mëkatuar, dështuar apo bërë rrëmujë – çdo i krishterë duhet të dojë të bëjë të kundërtën – por është ana tjetër e monedhës. Është mënyra e punës së Perëndisë. Pjesë të mëdha të Veprave dhe shumica e letrave e tregojnë këtë.

Libri i Gordon Mekdonëlld (MacDonald), “Rebuilding Your Broken World” (Thomas Nelson, 2004), sëbashku me shumë libra të tjerë të mrekullueshëm, më ka ndihmuar të zhvilloj këtë bindje ose besim dhe tani është shumë i fortë në zemrën time. Më ka ndihmuar ta kuptoj Perëndinë dhe punën e Tij më shumë se pothuajse gjithçka tjetër. Nganjëherë e quaj këtë “hir radikal”.

Për pesëdhjeteshtatë vjet, në mbi nëntëdhjetë vende, në mijëra kisha dhe organizata të tjera, kam vënë re shpesh njëfarë rrëmujë. Nganjëherë duket qartë se është mëkat për të cilin duhet pendesë.

Herë të tjera, është gabim i pamend, ose sido që të duash ta quash një sjellje të paarsyeshme nga ana e fëmijëve të Perëndisë. E kam thënë, dhe e ndiej fuqishëm, se pavarësisht sesa të mbushur jemi me Frymën e Shenjtë, jemi prapëseprapë njerëz. Të qenët njerëz ka anën e vet të bukur, sikurse ka edhe anën e vet të rrëmujshe.

I admiroj shumë udhëheqës të krishterë, dhe përpiqem të kem një qëndrim të rizgjuar prej hirit ndaj të gjithë atyre, por gjatë gjithë këtyre pesëdhjeteshtatë viteve kam parë drejtues të krishterë, përfshirë misionarë, të bëjnë gjërat më të pakuptimta e të thonë gjërat më të pakuptimta ...dhe nganjëherë mund ta kem bërë vetë. Megjithatë, pasi kam vëzhguar më me kujdes, e kam parë Perëndinë të punojë mes gjithë kësaj. Mbase nuk do të doni ta lexoni këtë, por kam parë shumë njerëz të përdorur prej Perëndisë që po jetonin në mëkat në të njëjtën kohë. Kemi parë pastorë që po përdoreshin prej Perëndisë, që kishin njerëz të shpëtuar, kisha që rriteshin dhe njerëz që dishepullizoheshin, e më vonë zbuloheshin se po jetonin në kurorëshkelje dhe pabesi të vazhdueshme. Po flas për njerëz të martuar e me fëmijë. Shpesh, sigurisht, u del tymi, pushohen, nganjëherë divorcohen ose më keq. Vite më vonë e takon të njëjtin person me bashkëshortin/en tjetër dhe zbulon se po përdoret në shërbesë. Po të shkruaja një libër të tërë rreth kësaj, mund t'ju jepja qindra shembuj të ngjashëm. Si shpjegohet? RRËMUJOLOGJIA!

Disa fjalë të tjera kyçe rreth kësaj ideje janë “mister” dhe “mëshirë”. Vargjet e fundit të Romakëve 11 më kanë ndihmuar vazhdimisht: “O thellësi pasurie, urtësie dhe diturie të Perëndisë! Sa të pahulumtueshme janë gjykimet e Tij dhe të pashtershme udhët e Tij!” (Rom. 11:33).

Gjëja më e vështirë për t'u pranuar nga disa njerëz, veçanërisht udhëheqës, është kur Perëndia po punon në mënyrë të fuqishme përmes dikujt që ata mendojnë se ka teologji të gabuar. Si mund të ndodhë? Kam takuar njerëz që janë të mërzitur me disa folës/ungjilltarë televizivë dhe të tjerë në atë botë të ndërlikuar e të

pashoqe. Shumë njerëz madje më thonë se as nuk i shikojnë ata. Janë shkruajtur artikuj të tërë kundër filan televizioni të krishterë dhe bie dakord me një pjesë të asaj që më thonë. Ka gjëra që kam parë e dëgjuar në këto programe që mund të më bëjnë të vajtoj, veçanërisht marifetet e ngritjes ekstreme të fondeve të këtij të ashtuquajturit zanat. Por, mos u çuditni kur të shkoni në qiell e të takoni qindra mijëra që kanë ardhur te Krishti përmes disa prej këtyre shërbesave! A na duhet më shumë nga qëndrimi i Apostullit Pal i shfaqur tek Filipianëve 1:15-18?

Disa me të vërtetë predikojnë Krishtin edhe për smirë dhe për grindje, por disa të tjerë me vullnet të mirë. Këta e predikojnë Krishtin për grindje, me qëllime jo të pastra, duke menduar që t'u shtojnë pikëllimin vargonjve të mi, kurse ata e bëjnë nga dashuria, duke ditur se unë jam vënë për mbrojtjen e ungjillit. Ç'rëndësi ka? Sido që të jetë, me shtirje o sinqerisht, Krishti shpallet; dhe për këtë unë gëzohem, dhe do të gëzohem.

Është e qartë dhe e vështirë për t'u pranuar se Perëndia përdor shërbesa dhe njerëz me të cilët mund të mos duam të kemi të bëjmë fare. Ai duket se mbështet shërbesa, të cilave unë nuk do t'u dërgoja as 5£. Ne duam t'i shpjegojmë këto gjëra dhe të përpiqemi t'i futim në kutinë tonë, por nganjëherë shohim se nuk i nxë! Përgjigjja – Rrëmujojlogjia! Më duhet një libër tjetër i tërë për ta shpjeguar këtë me hollësi. Kam dy shkrimtarë që duan të më ndihmojnë për ta shkruar, por dyshoj se do të bëhet ndonjëherë. Do të ishte tepër i rrëmujujshëm!

Një tjetër fushë jetësore e kyçe ku gjërat bëhen shumë të rrëmujujshme është në tërë fushën e financave dhe dërgimit të fondeve në fushat e misionit për njerëz dhe projekte. Me histori tmerri mund të “provojmë” gjithçka që duam, kështu që njerëzit

tregojnë histori tmerri rreth keqpërdorimit të fondeve në terren dhe kjo i tmerron njerëzit sa të mos dërgojnë më fare para. Një fjalë e nxehtë është fjala “varësi” dhe janë shkruajtur disa libra dhe artikuj shumë ekstremë rreth kësaj. Unë besoj se kjo sjell shumë pështjellim. Jam i bindur se historia do të tregojë se bujaria dhe marrja e rrezikut për të mbështetur një projekt (psh një shkollë) madje mijëra milje larg, kanë qenë faktorë madhorë pozitivë në çuarjen e ungjillit përpara dhe ngritjen e Kishës së Tij. Do të doja, gjithashtu të kisha kohë dhe dhunti për të shkruar një libër të tërë për këtë.

Është fakt i trishtueshëm që disa njerëz nuk e mbështesin një shkollë të re ose projekte të ngjashme nëse nuk shohin se mund të jetë e vetëmbështetur menjëherë. Ky është gabim i madh veçanërisht në vende si India. Shkollat vetëmbështetëse janë theksuar për shumë vjet në Indi dhe kjo është arsyeja pse ka shumë pak shkolla shumë të mira për të varfërit e skajshëm (zakonisht dalitët ose njerëzit fisnorë), ndërsa ka mijëra shkolla mes atyre që mund të paguajnë (paçka se nuk mund të them se kjo është e gabuar). Në situatën e ndërlikuar të varfërisë së skajshme, duhet të presim që të investohen shumë para deri sa një shkollë të mund të vetëmbështetet. Mund të duhen dy dekada, deri sa njerëzit e diplomuar nga këto shkolla të kenë punë, para se gjërat të ndryshojnë. A është e mundur që njerëzit thjesht ta imagjinojnë me çfarë po ndeshemi në Indi, ku ka thuhet 300 milionë të kyçur brenda varfërisë së skajshme të paprekshmërisë? Këto situata të veçanta, dhe ka shumë nëpër botë, kanë nevojë për bujari superspeciale. Përdorimi i taktikës së frikës nga “varësia” mund të jetë një prej pengesave më të mëdha. Kjo nuk do të thotë se nuk duhet të kemi mendjemprehtësi dhe hulumtime në lidhje me gjithçka që japim. Prania e njerëzve të duhur në fushë për t’u marrë me financat dhe projektet është faktori më i rëndësishëm ndër të gjithë. Megjithatë, paçka se disa gjëra mund të shkojnë keq dhe mund të ketë situata të rrëmujshme, besoj gjithsesi se

historia do të tregojë se Perëndia po bënte shumë më shumë mes gjithë asaj rrëmuje sesa kuptuam në atë kohë. Njerëzit kishat ose fondacionet që mendojnë se kanë hedhur kot para në një projekt që shkoi plotësisht keq, mund të zbulojnë shumë rezultate fantastike të dhënies së tyre kur të shkojnë në qiell.

Në gjithë këtë duhet të kemi më shumë urtësi dhe gjykim të shëndoshë dhe të jemi të vetëdijshëm për atë që unë e quaj “idealizëm shkatërrues”. Nëse këtij idealizmi i bashkohet ai lloj delli perfeksionist që shumë prej nesh e kanë, shkaktohet shumë shkurajim, mungesë uniteti dhe pështjellim. Ja pse ka aq shumë libra që parashtrajnë idetë ose axhendën e dikujt, të cilët japin një tablo të pasaktë të njerëzve të tjerë, kishave dhe organizatave të tjera, dhe asaj që ato po bëjnë. Pak më shumë urtësi, durim dhe përlësi do të kishte mjaft sukses për të na çuar në një realitet më të madh, në një fitore më të madhe.

Ndërsa përfundoj këtë kapitull, ka kundërshti mes misionëve dhe drejtuesve të kishave, më shumë se ç’kam dëgjuar më parë gjatë jetës sime. Ka një grup të madh njerëzish që duan të konsiderohen biblikë dhe ungjillorë, por duket se, në mënyrë shumë dinake, mohojnë vetë bazat e besimit, si humbja e të gjithë atyre që janë jashtë Krishtit, vdekja zëvendësuese e Krishtit, si dhe shumë doktrina të tjera bazë me të cilat shumica e drejtuesve ungjillorë dhe agjencive ungjillore janë pajtuar për qindra vjet.

Shoh se shumë libra janë shumë kritikues ndaj Kishës dhe lëvizjes së tanishme ungjillore në botë, e cila tani përfshin miliona njerëz në thuajse çdo shtet të botës. Duket sikur po thonë se Hadson Tejlor (Hudson Taylor), Xhon Stot (John Stott), Billi (Billy) Graham, Xhon Kalvin (John Calvin), Uoçmën Ni (Watchman Nee), Bakt Sing (Bakht Singh), Uilliam Keri (William Carey), Dr. Francis Shefer (Schaeffer), Çarlz Spërxbhën (Charles Spurgeon), D. L. Mudi (Moody), Festo Kivengere, Uilliam Buth (William Booth), Xhon Uesli (John Wesley), Emi Karmajkëll (Amy Carmichael), Augustini (Augustine) i Hipos dhe qindra të tjerë që

kanë ndihmuar që kjo lëvizje të jetë siç është sot e kishin të gjithë gabim. Mund të mos e thonë pikërisht kështu, por, sipas meje, kjo është ajo që nënkuptohet nga shkrimet e tyre. Librat e tyre që janë bërë aq të pëlqyer, kanë vërtet shumë gjëra të mira për të thënë, por për mendimin tim, në mënyrë të vazhduar, lëvizin gjithashtu nga e vërteta në të gabuarën, duke i lënë lexuesit e tyre në dyshim dhe pësjellim, gjë që ka krijuar një mungesë uniteti në Trupin e Krishtit dhe ka shkaktuar ndarjen e goxha kishave. Shpesh, rezultati i natyrshëm është kritikimi i kishës ose denominacionit të tyre. Kjo, sigurisht, mund të bëjë që shumë të lënë kishat e tyre dhe të hapin kisha të reja, më shumë si reagim sesa për shkak të së vërtetës biblike. Sipas meje, kjo po çon në një nivel më të lartë të rrëmujologjisë se kurrë më parë. Besoj se në mes të kësaj, na duhet më shumë urtësi, dashuri dhe mendjemprehtësi se kurrë më parë. Na duhet realiteti i këmbënguljes “me sytë tek Jezusi” në qendër të vështirësive dhe sfidave.

KAPITULLI 2

FIKËSET E ZJARRIT, LIBRAT DHE FJALËT E URTA

Ndërsa po shkruaj këtë, është ditëlindja e vajzës sonë Krista (Christa) dhe dua t'ia kushtoj këtë kapitull asaj. Një ndër shumë dëshitimet e mia në ato ditë të hershme ishte që nuk isha në spital në Lei, Lenkshër (Leigh, Lancashire) kur ajo lindi; fatmirësisht Drena ishte aty! Po kthehesha nga takime diku jashtë shtetit dhe nuk arrita dot për ngjarjen e madhe. E quajtëm Krista në kujtim të Krista Fisher, e cila është nga ish-Gjermania Lindore e më vonë u martua me z. Rei Ajqë (Ray Eicher). Për vite me radhë, ata dhe Alfi Franks (Alfy Franks) ishin drejtuesit e shërbesës sonë në Indi. Krista kishte ardhur te Krishti në fillimet e shërbesës sonë në Madrid, ku jetuam fillimisht kur erdhëm në Evropë në vjeshtën e vitit 1960. Beni, djali ynë i parë, u lind pak kohë pas kësaj.

Në verën e vitit 1957, tre nga ne po planifikonim të shkonim në Meksikë për të shpërndarë literaturë dhe për të arritur njerëzit me ungjillin. Kisha studiuar spanjisht në shkollë të mesme dhe në vitin tim të parë në Maryville College, ku isha takuar me Uolltër Borçërd (Walter Borchard), shokun tim të dhomës, dhe Dejll Rotën (Dale Rhoton), i cili shumë shpejt u bë ndikim i fortë dhe i perëndishëm në jetën time. Nuk arritëm të shkonim në Meksikë deri rreth mesit të korrikut meqenëse Dejlli po studionte në Wheaton Summer School ndërsa Uolteri dhe unë po shisnim libra derë më derë në zonën ku banoja në Nju Xhersin verilindor. Prej disa vitesh shisja fikëse zjarri në atë zonë dhe biznesi im shkonte shkëlqyeshëm. Ndizja një zjarr në një tigan para shtëpisë

së dikujt dhe ia fikja para syve me këtë fikësen e vogël “Presto Fire Extinguisher”. Shpejt m’u bënë shumë njerëz që ua shisnin meqenëse kishte shitje me fitim të lartë, edhe me shumicë edhe me pakicë. Shefi im ishte një jude, z. Finkellshtajn (Finklestein) në Manhatan, dhe ishte e veçantë që një gjashtëmbëdhjetëvjeçar të shkonte ta takonte. Ishte aq i lumtur për shitjet e mia sa që më bëri agjent ekskluziv për kontenë Bergen, kështu që e regjistrova zyrtarisht kompaninë time, Bergen County Sales Co. Gjithçka po shkonte vaj derisa Jezusi erdhi në jetën time dhe më çoi drejt biznesit “Fikëset e Zjarrit të Përrjetshëm”. Gjatë verave të viteve 1955 dhe 1956 dhe pas kthimit tim në besim u mora me fikëse zjarri, por në vitin 1957 u mora me Bibla dhe libra të krishterë, dhe së shpejti do të themeloja një mision të quajtur “Send the Light” (Dërgo Dritën).

Ndërsa Uollteri dhe unë ishim në Nju Xhersi duke shitur libra të krishterë derë më derë, si për të shpërndarë fjalën, ashtu edhe për të fituar para për udhëtimin tonë në Meksikë, mbaj mend se ishte një zonjë në North Haledon që blinte shumë libra, gjë që më lumturonte pa masë. Mendoj se ajo e kuptonte se isha plot zell, por ndoshta i dobët në urtësi, kështu që më sfidoi të lexoja librin e “urtësisë” në Dhjatën e Vjetër, “Fjalët e Urta”. Dalëngadalë i isha afruar fundit të Dhjatës së Vjetër, por nuk isha i sigurt nëse kisha shkuar aq larg. Ajo më tha diçka që nuk e kam harruar kurrë: *“Një fjalë e urtë në ditë do ta mbajë djallin larg”* dhe pastaj më tregoi në Bibël se Fjalët e Urta kanë 31 kapituj, një për secilën ditë të muajit. Të jeni të sigurt se nuk u jam ndarë Fjalëve të Urta që atëherë. Nuk ia kisha idenë çfarë kishte përgatitur Perëndia për mua dhe sa do të më ndihmonin nxitjet dhe urtësia e këtij libri në peligrinazhin tim dyzetegjashtë vjeçar si drejtues i “Send the Light”, i cili u quajt më vonë “Operation Mobilisation” në Evropë.

Cilat janë disa prej pikave kryesore që më goditën fort në atë kohë? Ja disa prej temave kryesore:

1. Fitore mbi epshin

Në Bibël ka qindra vargje rreth seksit dhe disa prej tyre mund të duken goxha të egra dhe jashtë kutisë, si Fjalët e Urta 5:18-19:

Qoftë i bekuar burimi yt dhe gëzohu me nusen e rinisë sate. Drenushë e dashur dhe gazelë hirplotë, sisët e saj le të të kënaqin kurdoherë, dhe qofsh vazhdimisht i dhënë pas dashurisë që ke për të.

Si i krishterë i ri, aq i uritur për Perëndinë dhe i përkushtuar rrënjësisht ndaj Jezusit, nuk e kuptoja se do të ndeshesha me këtë gjatë gjithë jetës. Para se të kthehesha në besim isha përfshirë pak në të, duke besuar gjithmonë se ishte e gabuar, por vetëm kur u ktheva në besim e mora forcën për t'u ndeshur e për ta mposhtur në jetën time. Në atë kohë, nuk mendoj se kisha parë qoftë edhe një lloj imazhi pornografik të fortë, por jam i sigurt se pa Jezusin do t'i isha futur asaj rruge. Lexoja vazhdimisht Fjalët e Urta 5, 6 dhe 7 dhe vargje si këto e mësimet e tjera të ngjashme të shpërndara nëpër Bibël hodhën një themel të fortë për betejën time gjatë gjithë jetës me epshin.

Ai e ndoqi pa mëdyshje, si një ka që shkon në thertore, si një i lidhur në dënimin e budallait ... ka rrëzuar shumë të plagosur për vdekje, dhe tërë ata që ajo ka vrarë ishin burra të fortë. Shtëpia e saj është rruga e Sheolit që zbret në thellësitë e vdekjes.

(Fjalët e Urta 7:22,26-27)

Në atë kohë nuk e kishim imagjinuar kurrë që ai udhëtim për në Meksikë do të na çonte drejt kthimit në një prej shpërndarësve më të mëdhenj të Biblës dhe librave rreth kësaj teme në shumë gjuhë nëpër botë. Kapitulli rreth temës së epshit në librin tim të mëparshëm “Drops from a Leaking Tap”, i cili doli fillimisht

si artikull reviste, është një prej gjërave më të vështira që kam lejuar të printohen.

2. Mëkatet e gjuhës

Mëkatet e gjuhës janë një prej temave më të mëdha të Fjalëve të Urta. Thjesht provojini këto vargje për të parë sesi ju duken!

Përgjigjja e ëmbël e fashit zemërimin, por fjala therëse e nxit zemërimin. Gjuha e të urtëve përdor dijen ndershmërisht, por goja e budallenjve nxjerr marrëzira. Sytë e Zotit janë kudo për të shikuar të këqinjët dhe të mirët. Një gjuhë e shëndoshë është një dru i jetës, por gjuha e çoroditur e sfilat shpirtin.

(Fjalët e Urta 15:1-4)

Edhe budallai, kur hesht, konsiderohet i urtë dhe, kur i mban të mbyllura buzët e tij, konsiderohet i zgjuar.

(Fjalët e Urta 17:28)

Kush ruan gojën dhe gjuhën e tij mbron jetën e tij nga fatkeqësitë.

(Fjalët e Urta 21:23)

E mësova me dhembje sa e lehtë është që karaktere si unë të lëndojnë njerëz me një fjalë therëse; në rastin tim, personi që kam lënduar më shumë është vetë gruaja ime gjatë 55 viteve martesë bashkë. Që para se të martohesha, për shkak të veprës së hirit të Perëndisë në jetën time, po arrija një nivel të lartë fitoreje me atë që dilte nga goja ime, dhe revolucioni i dashurisë për të cilin shkruajta ishte realitet në rritje në mua. Përmes leximit të librave si “The Calvary Road” (CLC, 1980) nga Roi Hesiën

(Roy Hession), “Humility” (CreateSpace, 2012) nga Endrju Mëri (Andrew Murray) e shumë të tjerë, mësova të përulem, të pendohem e të kërkoj ndjesë.

E kuptova se shpesh ishte krenaria ajo që më pengonte për të mos e bërë këtë dhe që në moshë të re i shpalla LUFTË të gjitha formave të krenarisë. Vargje si Galatasve 2:20 u bënë pjesë e ADN-së sime shpirtërore dhe mungesa e theksimit të jetës së kryqëzuar sot në disa kisha, madje edhe mes drejtuesve, është një prej dobësive të ditëve tona që më shqetëson më shumë.

*Unë u kryqëzova bashkë me Krishtin dhe nuk rroj
më unë, por Krishti rron në mua; dhe ajo jetë që
tani jetoj në mish, e jetoj në besimin e Birit të
Perëndisë, që më deshi dhe dha veten për mua.*

(Gal. 2:20)

Përsëri, Billi Graham ishte ndihmë e madhe për mua me mesazhet e fuqishme të “Shtatë Mëkatet që Çojnë në Vdekje” dhe predikime të tjera në radio, të cilat i mora edhe të printuara, i lexova dhe i shpërndava.

“Shtatë mëkatet që çojnë në vdekje” më goditi aq fort sa që mund t’ju them kohën dhe vendin ku isha kur e lexova: 8 Tasso Road, Fulham, Londër. Jetuam aty fillimisht në apartamentin me një dhomë gjumi për të cilin Hois Bërks (Hoise Birks) flet në autobiografinë e tij “A New Man” (HB Publishing, 2012). Ishte shkurt 1962, sapo kishim mbërritur në Mbretërinë e Bashkuar dhe emri Operation Mobilisation po përdorej për herë të parë.

3. Përtacia

Mbaj mend se në një konferencë të OM-së në Indi rreth vitit 1967, u kërkova njerëzve të ndanin betejën e tyre më të madhe në punën e tyre dhe, për habinë time, më thanë se ishte përtacia. Mendoj se ishte problem kaq i madh për shkak të vapës së madhe, një pjesë

të së cilës e përjetova vetë. Leximi i hershëm i Fjalëve të Urta përsëri kishte hedhur themelin, dhe para se të bëhesha 20 vjeç i kisha shpallur luftë çdo lloji mungese të disiplinës si dhe përtacisë në format e saj të shumta. Ja disa vargje fantastike nxitjeje:

Dora e njeriut të kujdesshëm do të sundojë, por dora e përtacëve do t'i nënshtrohet punës së detyrueshme ... Përtaci nuk e pjek gjahun e tij, por kujdesi për njeriun është një pasuri e çmueshme.

(Fjalët e Urta 12:24,27)

Edhe ai që është përtac në punën e tij është vëlla i plëngprishësit.

(Fjalët e Urta 18:9)

Përtacia të bën të biesh në një gjumë të thellë dhe njeriu i plogët do të vuajë nga uria ... Përtaci e zhyt dorën e tij në pjatë, por nuk arrin as ta çojë në gojë.

(Fjalët e Urta 19:15,24)

Përtaci thotë: “Jashtë ka një luan. Do të vritem rrugës.” ... A ke parë një njeri të papërtueshëm në punën e tij? Ai do të paraqitet në prani të mbretit dhe nuk do të qëndrojë para njerëzve të humbur.

(Fjalët e Urta 22:13,29)

Isha me fat në fëmijërinë time që kisha një baba shumë punëtor dhe ai më mësoi mirë në etikën biblike për të mos qenë përtac. M'u desh të mësoj sërish me dhembje sesi të isha i duruar ndaj atyre që nuk e kishin atë etikë dhe thjesht të punuarit fort qoftë edhe për një ditë do të ishte detyrë e madhe për ta. Ky theksim i fortë i punës dhe disiplinës mund t'i çojë njerëzit në shtirje dhe një lloj jete të dyfishtë. Njerëzit do të sillëshin në një mënyrë kur askush

nuk po i shikonte, por goxha ndryshe kur dikush, veçanërisht një nga skuadra, po i shikonte. Më vonë do të ndjeheshin të dënuar, gjë që mund të çonte në lloje të ndryshme pështjellimi shpirtëror dhe emocional. Ja pse vazhdimisht tërë lëvizja jonë, dhe vetë jeta ime, u shpëtua nga “HIRI radikal”. Sigurohuni të lexoni librin e Rendi Ellkorn (Randy Alcorn) “The Grace and Truth Paradox” (Multnomah, 2003) për ndihmë në këtë fushë.

4. Zemërimi

Nisa të përfshihem në zënka që në moshë të hershme, një herë edhe me një vajzë që, le të themi, më rrihte. Mbjaj mend se formova një bandë të vogël në rrugën time në Uikof (Wyckoff), Nju Xhersi kur duhet të kem qenë rreth dymbëdhjetë vjeç. Luftonim me lende që binin nga pemët. Alberti udhëhiqte bandën tjetër dhe ishim armiq. Shkruajta me bojë të zezë fjalën e pistë më të njohur të kohës sonë në murin anësor të shtëpisë së tij të madhe e të bardhë. Shërlli (Shirley), vajza e anës tjetër të rrugës, duhet të më ketë parë dhe i tregoi babait tim. Ai nuk e vlerësoi shumë këtë shpërthim të hershëm artistik dhe m’u desh t’i kaloja sipër me bojë asaj që kisha shkruajtur. Duket gallatë, por zemërimi nuk është gallatë dhe mund të më kishte shkatërruar jetën.

Më kujtohet kur i shkova për vizitë në burg diku që kishte vrarë një burrë. I kishte shkuar për vizitë të dashurës për surprizë dhe kishte gjetur një burrë tjetër me të. Duke shfryrë zemërimin, e kishte vrarë në vend. Kur e takova, kishte gjetur falje në Jezusin dhe po këmbëngulte duke ndarë besimin e tij.

Ndonëse kisha një nivel të lartë fitoreje në këtë fushë të rëndësishme, kisha gjithashtu dështimet e mia, të cilat i mbaj mend mirë deri më sot. Edhe si fëmijë, thellë në zemër nuk doja të lëndoja ndokënd ose ndonjë gjë. U ndjeva keq kur vrava një ketër pa dashje me armën time BB (ose ndoshta me hark dhe shigjetë, nuk më kujtohet). U ndjeva keq dhe e varrosa kafshën e vogël në mënyrën e duhur. Padurimi, i përzier me zemërimin, shpesh

në reagim ndaj diçkaje, ka qenë një prej dobësive të mia, por nuk jam dorëzuar kurrë dhe kam mësuar realitetin e 1 e Gjonit 1:8-10:

Po të themi se jemi pa mëkat, gënjejmë vetveten dhe e vërteta nuk është në ne. Po t'i rrëfejme mëkatet tona, Ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi. Po të themi se s'kemi mëkatuar, e bëjmë Atë gënjeshtar dhe Fjala e Tij nuk është në ne.

Vargjet pasardhëse 2:1-2 janë gjithashtu të dobishme:

Djema të mi, ju shkruaj këto gjëra që të mos mëkatoni; dhe në qoftë se ndokush mëkatoi, kemi një avokat tek Ati, Jezu Krishtin, të drejtin. Ai është shlyesi për mëkatet tona, dhe jo vetëm për tonat, por edhe për ata të të gjithë botës.

Kam ndjenja aq të forta për zemërimin, sa që i nxis njerëzit ta mendojnë me kujdes nëse duhet të martohen me dikë që nuk ka fitore mbi zemërimin, ose nëse personi ka patur probleme madhore me zemërimin në të kaluarën; ka shumë mundësi që pas martesës do të ndizet përsëri dhe mund të ketë dhunë familjare. Dhuna në familje, madje edhe mes atyre që thonë se ndjekin Zotin, është një ndër mëkatet që kisha shpesh ka patur dhuntinë t'i fshehtë, veçanërisht nëse bëhet fjalë për një dhjak, plak ose edhe pastor a drejtues adhurimi. Nëse po dështoni shumë në këtë fushë, duhet të kërkoni ndihmë. Thjesht leximi i Fjalëve të Urta nuk mjafton. Ju duhet ndihmë, e cila do të përfshijë gjithmonë pendesën dhe ecjen në dritë.

Dhe ky është mesazhi që dëgjuam nga Ai dhe po jua shpallim juve: Perëndia është dritë dhe në Të nuk ka

kurrfarë errësire. Po të themi se kemi bashkësi me Të, dhe ecim në errësirë, ne gënjejmë dhe nuk e vëmë në praktikë të vërtetën, por po të ecim në dritë, kemi bashkësi njëri me tjetrin, dhe gjaku i Jezu Krishtit, Birit të Tij, na pastron nga çdo mëkat.

(1 e Gjonit 1:5-7)

Ka shumë më shumë rreth çfarëdolloj teme në këtë libër, dhe njëra nga arsyet për këtë kapitull është që t'ju shtyjë ta lexoni Biblën rregullisht dhe ta trajtoni me besim çdo çështje për të cilën Zoti ju flet. Shpresoj të dëgjoj prej disave prej jush që bëjnë pikërisht këtë (adresa ime e postës elektronike gjendet në fund të Hyrjes së këtij libri). Shpresoj të lexoni gjithashtu 2 Timoteut 2:2 e ta ndani atë që keni mësuar me të tjerët; ata, pastaj, mund t'ia kalojnë edhe njerëzve të tjerë.

Dhe ato që dëgjova nga unë përpara shumë dëshmitarëve, jepua njerëzve besnikë, që do të jenë të aftë të mësojnë edhe të tjerë.

(2 Tim. 2:2)

Kam filmuar së fundmi një DVD “Book by Book” rreth librit të Fjalëve të Urta me Riçard Bjuëz (Richard Bewes), Pol Bllekëm (Paul Blackham) dhe skuadrën “Biblical Frameworks”. Shpresoj që shumë prej jush të mund ta shohin. Gjithashtu, një DVD e historisë së jetës sime, e titulluar “George – for real” (CWR, 2015), është nxjerrë nga CWR dhe shkon shumë me atë që jam përpjekur të ndaj në këtë libër. Për më shumë informacion ose për ta porositur këtë DVD, ju lutem vizitoni: www.cwr.org.uk/store. Shpresoj që më shumë nga ajo që kam shkruajtur të bëhet edhe më e gjallë e të përdoret nga Fryma e Shenjtë.

KAPITULLI 3

UNITETI MES LARMISË

Ndërsa shkruaj këtë kapitull jam në Gjermani, në një vend të pazakontë. Ndodhem në atë vend që e quajnë “Nëna Shtëpi e Lëvizjes së Dhjakeve të Aidlingenit”, që është emri i fshatit këtu. Vazhdoj të vij këtu prej rreth 40 vjetësh. Pas pak javësh do të ngrenë sërish një çadër të madhe në pronën e tyre dhe do të kenë një prej ngjarjeve më të mëdha për rininë në komb, me mëse 8000 të rinj që do të vijnë nga i gjithë vendi për të dëgjuar Fjalën e Perëndisë dhe muzikë të shkëlqyer të krishterë. Këtë vit do të vijë ai yni, Bill Drejk (Drake) i OM-së. Mbjaj mend që kam folur këtu para disa vitesh dhe është gjithmonë e mahnitshme ta shohësh Perëndinë të punojë në zemrat e aq shumë të rinjve. Këto Motra të dashura bëjnë betimet e dëlirësisë dhe disa i mendojnë si Murgeshat Protestante, ndonëse janë anëtare të Kishës Luterane këtu në Gjermani. Ua, si i krishterë i ri nga ShBA-ja, nuk e dija se njerëz të tillë egzistonin. Tani ndjehem shumë i privilegjuar që i kam disa prej këtyre Motrave në Jezusin mikështetësi të ngushta. Ky është një ndër vendet e mia të preferuara për të ndryshuar ritmin dhe për t’iu përkushtuar lutjes, të shkruarit dhe disi ecjes në pyllin e madh ku ato gjenden. Ndaj gjithashtu, Fjalën e Perëndisë me to dhe kaloj kohë fantastike shoqërore gjatë vakteve të mrekullueshme që ato sigurojnë. Dashuria e tyre e madhe për Jezusin dhe Fjalën e Tij, si dhe dëshira për misione botërore, është shumë e dukshme.

A mund ta përfytyroni larminë e lëvizjeve, kishave dhe njerëzve që kam hasur këto gjashtëdhjetë vjet në rreth njëqind vende?

Sigurisht, thjesht kalimi i kohës në anijen tonë “Logos Hope” të jep rreth 40 kombësi të ndryshme sëbashku në një anije! Nuk është çudi që netët e lutjes janë veçanërisht aq interesante.

Uizlli Gardënz (Wisley Gardens), jashtë Londrës e pranë aeroportit “Heathrow”, është një tjetër vend i parapëlqyer për mua. Shoku im i ngushtë Deni (Danny) Smith, i cili erdhi te Jezusi kur e takova për herë të parë në Kalkutë (Calcutta) thujse pesëdhjetë vjet më parë, jeton aty afër. Ai është gjithmonë i gatshëm për të më marrë nga stacioni i trenit e për të më çuar tek ky kopsht me mijëra lule të ndryshme. Kam qenë atje shumë herë, shpesh duke shëtitur e dëgjuar Biblën audio ose duke folur në telefon në të njëjtën kohë. Kopshti i stërmadh më kujton Kishën nëpër botë, që tani ka mbi 40,000 denominacione/rrjedha ose lëvizje dhe vazhdon të rritet shpejt!

Njëra nga pjesët e mia të parapëlqyera në Uizlli është pjesa e kaktusëve. Nuk e kisha ditur kurrë se kishte aq shumë lloje. Më kujton shumë nga njerëzit e Zotit që kam takuar nëpër botë.

Kam dëgjuar drejtues që i respektoj të flasin në mënyrë negative për denominacionet dhe ndoshta edhe unë vetë kam qenë në të njëjtën mendje para shumë kohësh. Por duke parë shumëllojshmërinë e njerëzve që Zoti ka përdorur në Bibël dhe larminë e yjeve dhe galaktikave në pothuajse çdo pjesë të krijesës, e kuptoj se është përgjithësisht gjë e mrekullueshme dhe pozitive. Mendoj se përgjigjija ndaj pyetjes “pse nuk jemi të gjithë një kishë” (ndonëse shpirtërisht jemi) është e lehtë. Kjo nuk është mënyra e Perëndisë për të ndërtuar Mbretërinë e Tij (e di se kjo ka kuptime të ndryshme për njerëz të ndryshëm) dhe ne duhet ta kremtojmë këtë shumëllojshmëri të madhe. E di se disa prej këtyre lëvizjeve mund të jenë heretike, gjë që i përjashton përsa i përket Mbretërisë, por edhe atje mund të gjejmë disa besimtarë të vërtetë në mes të rrëmujës. Shumica e denominacioneve pësojnë ndarje dhe ndarja e madhe globale është mes atyre që besojnë se Bibla është vërtet Fjala e Perëndisë dhe atyre që nuk e besojnë këtë. Fjala

“fondamentalist” erdhi në jetë për të bërë dallimin mes atyre që besojnë se Bibla është Fjala e Perëndisë dhe atyre që nuk e besojnë, shpesh të quajtur “liberalë” (nuk ka të bëjë fare me politikën). Gjatë dekadave të fundit, fjala “ungjillor” nisi të nënkuptonte ata që i qëndrojnë besimit biblik, por përgjithësisht nuk e duan etiketën “fondamentalistë”, e cila është lidhur me legalizmin e tepruar, theksimin e gjykimit e madje është ngjasuar me fundamentalizmin musliman. Ja pse mijëra kisha dhe qindra lëvizje lidhen me WEA-n (World Evangelical Alliance) ose me njëvlerësen kombëtare në kombin e tyre. Unë jam pjesë e WEA-s dhe isha aktiv kur isha më i ri. Në ngjarjet tona të mëdha globale mësuam të respektojmë edhe më shumë mënyrat e ndryshme dhe fantastike të punës së Perëndisë në shumë denominacione dhe lëvizje.

Unë i shoh ato të gjitha si pjesë të familjes dhe besoj se Perëndia bën shumë nga puna e Tij përmes familjes. Dikur isha i ashpër me njerëzit që nuk ishin si unë, ndërdenominacional, por nuk jam më. Nëse e njohin Jezusin dhe janë besnikë ndaj Tij, kishës së tyre lokale dhe ndoshta denominacionit të tyre, thjesht them “lavdi Zotit!” Ndoshta aty e kanë gjetur Krishtin dhe janë rritur në besim. Kjo është e rëndësishme për ta dhe është normale që shumica e jetës dhe veprimtarisë së tyre shpirtërore të jetë mes familjes së tyre.

Duhet të përballemi me faktin se një pjesë e madhe e rritjes së kishës dhe gjithashtu shqetësimit dhe veprimit shoqëror ndodhin në këtë plan. Po, Perëndia përdor edhe lëvizje ndërdenominacionale dhe ne duhet të çlirohemi nga mendësia “ose-ose” e të kuptojmë se Perëndia punon në mënyra të ndryshme në njerëz të ndryshëm.

Sigurisht, sa më shumë kohë lavdërimi, adhurimi dhe ungjillëzimi të kemi bashkë, aq më mirë është. Sigurisht, pa dashuri të sinqertë për njëri-tjetrin vetëm pengojmë veten dhe kishën ose lëvizjen tonë.

Perëndia punon përmes kulturës, gjuhës, njerëzve, situatave dhe lloj-lloj rrethanave. Shumica e kishave apo lëvizjeve gjatë këtyre dyqind viteve të fundit u krijuan nga një a më shumë drejtues

vizionarë dhe ka qindra shembuj. Deri në kohën e Luterit kishte vetëm pak ndarje madhore, por në të njëjtën kohë Kisha Katolike mësoi sesi ta kanalizonte larminë në urdhra të ndryshëm, kështu që pati një gamë të gjerë urdhrash si jezuitët, françeskanët, motrat e Marisë. Nuk është ky vendi që unë të shkruaj rreth gabimeve të mëdha që u futën në atë kishë në ato ditë e deri më sot. Ishte kohë vërtet e “rrëmujsme”, por a do të guxonte ndokush të thoshte se Perëndia nuk po bënte gjë mes kësaj?

Katolikët sot janë veçanërisht kritikues ndaj gjithë kishave dhe denominacioneve tona të ndryshme, por do t’u këshilloja të shkonin në Uizlli Gardënz. Perëndia punon në gjendjen tonë të rënë dhe njerëzore kështu që gjithçka që prekim, po, edhe Kisha, do të ketë dobësitë e të metat e saj dhe nganjëherë, e trishtueshme për t’u thënë, doktrinën e saj të skajshme e të rreme. Misteri i mistereve është SESI Perëndia ynë i madh, për shkak të asaj që Jezus Krishti bëri në kryq, vazhdon të punojë e të bëjë gjëra të mrekullueshme mes gjithë kësaj. Ne duhet të kremtojmë më shumë nga ajo që Perëndia ynë i madh po bën nëpër botë në, besoj, një milion kisha të ndryshme. Ua, Atij i qoftë lavdërimi dhe lavdia!

Kjo nuk do të thotë se duhet ta lëmë mënjanë betejën për më shumë shenjtëri, realitet dhe fitore, si dhe për gjithçka për të cilën flas në këtë libër dhe në librat e mi të tjerë. Nuk do të thotë të harrojmë se Satani është luan që vrumbullon që kërkon ato që mund t’i përpijë e që nganjëherë vjen si engjëll drite. Realiteti i luftës shpirtërore i përvijuar tek Efesianëve 6 është shumë real.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm se disa kisha dhe denominacione të tëra janë të vdekura ose kryesisht të vdekura. Të tjera e kanë kaluar vijën drejt ekstremizmit e madje herezisë. Të gjithë ne duhet të marrim pjesë në luftën e mirë. Nuk duhet të nxjerrim shfajësime për mëkatën dhe marrëzinë, por gjithmonë të pendo kemi e të përpiqemi t’i rregullojmë punët. Sërish, nevojitet një ekuilibër i së vërtetës në çdo hap të udhëtimit.

Në librin tim të mëparshëm, “Drops from a Leaking Tap”, merrem posaçërisht me tensionin që lind mes Kishës dhe së ashtuquajturës para-kishë. Shpresoj ta lexoni atë kapitull (kapitulli 22).

KAPITULLI 4

PARADOKSI, NDËRLIKIMI, MISTERI DHE RRËMUJOLOGJIA

Jam shumë i vetëdijshëm ndërsa shkruaj këtë libër se shumë besimtarë të rinj do ta lexojnë dhe mund t'u duket shumë i tepruar e madje pështjellues në disa vende. Më duhet ta ndërmarr këtë rrezik sepse herët a vonë të gjithë ne do të takojmë njerëz, kisha dhe grupe të krishtera që janë vetë të tepruara, pështjelluese dhe ka mundësi të jenë shumë më keq. Ndërsa lexoni mendimet e mia rreth shumë fushave të shërbesës dhe veprimtarisë së krishterë, pavarësisht sa e trishtueshme, e egër apo madje sa e gabuar mund të duket, pika kryesore e këtij libri është madhështia dhe mëshira e Perëndisë për shkak të asaj që Jezus Krishti ka bërë për ne në kryq. Nëse e ke të vështirë të më kuptosh, mund të jetë e dobishme të lexosh librin e Xhon Stot (John Stott) "Basic Christianity" (IVP, 2012) ose atë të Billi Grahamit (Billy Graham) "Peace with God" (Thomas Nelson, 2000). Mund të më dërgoni email dhe unë do t'ju dërgoj disa prej këtyre librave klasikë si dhuratë.

Ndoshta jeni mes atyre të krishterëve të rinj që tashmë janë të pështjelluar ose madje të shkurajuar nga ajo që keni parë ose madje përjetuar në kishë, OM ose në ndonjë agjenci tjetër. Nëse është kështu, ju lutem të vazhdoni të lexoni. Ju lutem, përpiquni të kuptoni atë që po përpiqem të them meqenëse dua të ndaj nga zemra dhe mendja disa prej fushave me të cilat jam munduar shumë, të cilat më kanë çuar drejt betejave të pafundme me zhgënjimin, shkurajimin e madje me dyshimin dhe mosbesimin.

Mendoj se një nga arsytet pse po e shkruaj këtë është për shkak se për gjashtëdhjetë vjet në Krishtin kam dëgjuar të krishterë, po, edhe drejtues të krishterë, që i kritikojnë shumë të krishterët e tjerë, kishat dhe organizatat e tjera. Këtu përfshihen edhe njerëz që i respektojnë dhe i dua, e prej të cilëve kam mësuar. Problemi im nuk ishte vetëm mungesa e shqetësimit dhe e dashurisë që shihja, por edhe që shpesh nuk i kishin faktet në rregull ose i nxirrnin gjërat nga konteksti. Ah sikur, pesëdhjetë vjet më parë të kishim patur libra si “Leading with Love” (Lewis and Roth, 2006) nga Aleks Strauch (Alex Strauch) ose “If You Bite and Devour One Another” (Lewis and Roth, 2011) nga i njëjti autor, një ish OM-ist i dashur që tani e vlerësoj aq shumë! I kishim disa libra si ato dhe jam shumë i lumtur që në OM kërkohet që t’i lexonim. Këta libra ndihmuan në hedhjen e themelit tonë më shumë se ç’mund të dimë ne. Këtu përfshihet libri i pashoq “The Calvary Road” nga Roi Hesiën (Roy Hession), të cilin e kam përmendur më parë, dhe “Love is the Answer” (Back to the Bible, 1960) nga Thiodore Ep (Theodore Epp). Pak pasi e lexova atë libër, shkruajta “The Revolution of Love”, pasuar nga libra rreth dishepullimit, ekstremizmit dhe ekuilibrit.

Le ta bëjmë të qartë se, veçanërisht si drejtues i ri, isha nganjëherë njëri prej më kritikuesve ndaj drejtuesve të tjerë dhe ndaj kishave dhe organizatave të tjera. Dalëngadalë mësova të isha më pozitiv, por vetëm kur zhvillova një pikëpamje tjetër të mënyrës sesi punon Perëndia dhe me kë punon Ai isha në gjendje të shihja gjëra pozitive të bëra nga njerëz, kisha ose organizata që ndjeja se kishin gabime ose praktika të gabuara. Në librin e tij “The Grace and Truth Paradox”, Rendi Ellkorn (Randy Alcorn) na ka bërë një nder të madh duke na treguar se mund të kemi edhe përkushtim të madh ndaj së vërtetës, që unë e kam patur gjithmonë, por edhe një jetë dashurie dhe HIRI. Duke patur këtë, do të mendohemi para se të kritikojmë, veçanërisht kur nuk e kemi tablonë e plotë të tërë historisë. Faktet nganjëherë nuk gjenden lehtë.

Në të njëjtën kohë, Shkrimi na urdhëron të mbrojmë besimin. Të gjithëve mund të na ndihmonte një shikim i freskët i letrës së dytë dhe letrës së tretë të Gjonit.

Në këtë kapitull dëshiroj të ndaj disa prej fushave që kanë shkaktuar shumë pështjellim dhe mundim.

1. Librat, fletushkat dhe ajo që e quaja “faqja e printuar” në librin tim të parë fare “Literature Evangelism” (Authentic Lifestyle, ribotuar në vitin 2003). Nisa fillimisht të shisja libra derë më derë si besimtar i ri me dy vjet besim në Krishtin. Në verën e vitit 1957, para se të shkoja në Meksikë, më ra në dorë një revistë e quajtur “Floodtide” nga CLC; kjo dhe përfshirja ime me “Pocket Testament League” që para se të kthehesha në besim më shtynë drejt rrugës së shërbesës përmes faqes së printuar, veçanërisht përmes ungjijve, Dhjatës së Re dhe Biblës së plotë. Isha bekuar duke lexuar libra të krishterë dhe fletushka të krishtera dhe me sinqeritet të plotë doja të bekoja të tjerët. Duke shitur derë më derë, zbulova se librat e fëmijëve shiteshin më shumë, kështu që iu futa edhe kësaj. Shpejt zbulova lloj-lloj librash me lloj-lloj mësimesh, disa prej të cilave dukeshin shumë të skajshme e madje të pavërteta. Duke e kthyer kokën pas drejt një jete me librat mund të bërtas **“Perëndia i përdor librat”**, por ajo që mund të mos dëshironi të dëgjoni është se Perëndia mund të përdorë libra të këqinj, sikurse mund t'i përdorë edhe djalli. Zbulova se libra që unë nuk do t'i shisja e nuk i pëlqeja përdorëshin nga Perëndia për të ndihmuar njerëz e madje për të sjellë njerëz te Krishti si Shpëtimtar. Si e trajton dikë që është ndihmuar dhe bekuar nga një libër që ti beson se është vërtet i keq? Si e shpjegon faktin që Perëndia përdor libra në mënyrë të fuqishme kur autori tashmë ka rënë në kurorëshkelje apo edhe më keq? Diçka edhe më e ndërlikuar është se libra të shkruar nga burra të mëdhenj dhe gra të mëdha të Perëndisë që ne i duam dhe i respektojmë shpesh nuk bien

dakord, nganjëherë edhe për çështje madhore. Nëse lexojmë gjerësisht dhe respektojmë një gamë të gjerë njerëzish, si e vendosim në zemër çfarë të besojmë? Për besimtarët e rinj duket e lehtë, madje dhe nipi im duket më i aftë se unë për të vendosur çfarë beson rreth çështjeve dhe doktrinave më të ndërlikuara. Nuk do të jem rrotull, por pyes veten sesi do të jetë ai në moshën time. Nganjëherë më duket rrëmujë e madhe dhe ma merr mendja se kjo është arsyeja pse e jap mësim “rrëmujologjinë”, që Perëndia në mëshirën, hirin dhe misterin e Tij shpesh bën gjëra të mëdha në mes të rrëmujës, gjëra që neve na duken shumë të rëndësishme, ndoshta edhe Atij. Por ajo që Jezusi bëri në kryq zbulon përparësi të ndryshme të Perëndisë së Gjallë në mënyrën sesi Ai u përgjigjet njerëzve, kishave dhe situatave të ndryshme.

2. Nëse mendojmë se bota e letërsisë së krishterë është e ndërlikuar, të shohim njëherë televizionin dhe internetin, me YouTube-in, Facebook-un dhe të gjitha ato që gjejmë rrugës. Ju kërkoi ndjesë për klisenë, por “m”i bën trutë kaçurrel”. Kërkimet, përfshirë të miat, do të zbulojnë se predikuesit televizivë, të cilët disa prej nesh mezi i shohim ose dëgjojmë, kanë ndihmuar jo mijëra, por dhjetëra mijëra të vijnë te Krishti anembanë botës. Tani disa njerëz menjëherë thonë: “Epo, shumica prej tyre duhet të jenë kthime të rreme!” Pastaj na japin një mësim të fortë rreth pasimit të ungjillit nga një gjendje e skajshme pendese si dhe rreth Krishtit si Zot ndërsa përpiqen të na bëjnë të besojmë se, mbi gjithçka, ky nuk është kthim biblik. Unë kam shumë probleme me këtë, por i madhi fare është se i kam takuar këta njerëz anembanë botës gjatë pesëdhjetë viteve të fundit dhe më duken vërtet besimtarë të mirëfilltë. Shumë prej tyre janë përdorur prej Perëndisë jo vetëm për të udhëhequr të tjerë drejt Krishtit, por edhe për të themeluar mijëra kisha.

Mbani mend se ndodhemi akoma në mes të korrjes më të madhe të njerëzve për Zotin që bota ka parë ndonjëherë. Si person që ka besuar përmes një predikuesi që disa e kanë kritikuar, Billi Graham, më është dashur ta jetoj gjithë jetën time të krishterë me kritikën se njerëzit që marrin vendime në ato lloje takimesh nuk janë vërtet të shpëtuar, se është thjesht fiksion në mendje. Për mua ka qenë gjithmonë mister pse disa njerëz pothuajse duket sikur gjejnë kënaqësi në uljen e numrit të njerëzve që janë shpëtuar vërtet.

Ne themi se njerëzit shpëtohen përmes HIRIT ndërsa vendosin besimin e tyre në Zotin Jezus Krisht, por duket se tregojmë në sjelljen tonë se zbatimi i të gjithë rregullave dhe urdhëresave përcakton vërtet nëse e dimë a je apo nuk je vërtet i krishterë. Ju lutem të përpiqeni të lexoni “Extreme Righteousness” (Moody, 1997) nga Tom Hovestol dhe do të zbuloni siç e zbulova unë sesi ne besimtarët e fortë në të vërtetën zhvillojmë aq lehtë një dell fariseu. “The Grace Awakening” nga Suindoll (Swindoll), veçanërisht kapitulli i quajtur “Si të mos biesh dakord në mënyrë të hirshme e të vazhdosh përpara” ishte ndihmë e madhe për mua.

Unë vetë mbaj distancë nga disa njerëz, përfshirë disa të famshëm, dhe shpërndaj libra kundër ekstremizmit si ai i mësimet të begatisë së skajshme. Shkruaj dhe flas akoma kundër doktrinës së rreme dhe ekstremizmit, por kurrë nuk do t’i thoja Perëndisë, Perëndisë së Gjallë, që Ai duhet të mbajë distancë ndaj këtij ose atij personi. Unë jam qenie njerëzore e dobët, shumë e kufizuar. Ai është Perëndia i Plotfuqishëm i qiellit dhe duket se bën gjëra të fuqishme mes paradoksit, ndërlikimit dhe misterit. Unë e quaj “rrëmujologji”, por ju mund ta përshkruani si të doni.

3. Fusha e tretë për të cilën dua të flas është muzika dhe mënyra e mahnitshme sesi Perëndia ka përdorur dhe po përdor të gjitha

llojet e muzikës, këngëve dhe refreneve për t'i ndihmuar njerëzit që të adhurojnë ose të vijnë te Jezusi. Kjo ka qenë një tjetër sagë ndërlikimi, mëse pesëdhjetëvjeçare. Është mrekulli që nga fillimi unë kam qenë mbështetës i asaj që është etiketuar “muzikë bashkëkohore”. Dhjata e Re nuk flet shumë për muzikën dhe Dhjata e Vjetër duket se ka një gamë të gjerë muzike dhe vallëzimi. Akoma nuk mund ta besoj sesa kundërshti ka dalë prej kësaj dhe sesi, pa e tepruar, dhjetëra mijëra kisha nëpër botë janë ndarë për shkak të kësaj. Nga njëra anë disa kanë thënë, duke e shkruajtur edhe nëpër libërtha, se daullet janë nga Satani (e kam një kopje). Unë dëgjoja kaseta (dikur në të kaluarën ... oboho, i dëgjoj akoma meqenëse makina ime e vjetër ka vend vetëm për kasetë) dhe lexoja libërtha e madje libra të tërë nga disa njerëz që i respektoja, të cilët dënonin një pjesë të madhe të asaj muzike që unë personalisht e shikoja të përdorej prej Perëndisë në mënyrë goxha të fuqishme. Kjo mund të më kishte shkruajtur plotësisht po të mos kisha zhvilluar një pikëpamje tjetër për Perëndinë, dashurinë e Tij dhe mënyrën sesi Ai punon. Duhet të ketë sens fantastik humori ndërsa sheh mënyrën sesi fëmijët e Tij sillen.

Nëse mendoni se kjo çështja e muzikës është gjë e vogël ose është zhdukur, do t'ju thoj se nuk e dini ç'po ndodh në Kishën më të gjerë. Disa madje kanë humbur besimin dhe janë larguar nga Kisha e krishterë dhe nganjëherë nga vetë besimi i tyre për shkak të asaj që kanë parë përse i përket shpalljeve dhe ashpërsisë në lidhje me çështjen e muzikës. Përfundimisht, duket sikur muzika e re e bashkëkohore ka fituar ... por çështja nuk është mbyllur akoma. Volumi i lartë paraqet një kategori të re problemesh dhe e pranoj se mbaj kufje pothuajse kudo. Rënia e jo pak muzikantëve kyçë në imoralitet ose divorc e ka bërë skenën edhe më të rrëmuajshme, por edhe muzikantët flasin fort kundër njëri-tjetrit, gjë që nuk ndihmon. Disa njerëz duket se i vënë vizën gjithë industrisë muzikore të krishterë me

lloj-lloj historish rreth lakmisë, krenarisë dhe imoralitetit. Sipas meje, ky ishte gabim i madh meqenëse mes rrëmuajt, Perëndia po bënte punë fantastike dhe shumë njerëz po vinin tek Zoti.

Ata prej nesh që lexojnë gjerësisht, veçanërisht periodikë të krishterë, do të përballen së tepërmi me raporte negative dhe histori të tmerrshme të krishtera. Kujdes kur argumentoni një pikë thjesht duke treguar histori negative meqenëse nuk është kurrë tabloja e plotë dhe nuk jep kurrë tablonë e plotë të asaj që Perëndia mund të bëjë në mes të rrëmuajt dhe në mes të gjithë natyrës sonë njerëzore. Të gjithë duhet të mësojmë përmendësh Romakëve 8:28: “Dhe ne e dimë se të gjitha gjërat bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë të thirrur sipas qëllimit të Tij.”

Ku është Perëndia në gjithë këtë? Unë them mu në mes – duke dashur, duke falur, duke shpëtuar dhe duke përdorur lloj-lloj “enësh balte”, siç i quan Bibla, për të përmbushur qëllimet e Tij. Qetësohuni, tani nuk është e nevojshme të largoheni nga kisha juaj me himnet e saj tradicionale; thjesht ndaloni së dënuari të gjithë ata që ndjekin një rrugë tjetër. U them bashkëmoshatarëve në klubin e të gjashtëdhjetave dhe shtatëdhjetave: “Çfarë ka më shumë rëndësi, që të shijojmë muzikën apo që më shumë nga brezi i ardhshëm të vijnë dhe të adhurojnë Jezusin?” A kemi qoftë edhe një ide të asaj që Perëndia ka bërë përmes kishave si “Hillsong” dhe muzikës së tyre? Shumëzoheni me 1000 dhe mund të keni njëfarë ideje të asaj që Perëndia ynë po bën nëpër botë përmes të gjitha llojeve të muzikës dhe njerëzve. Merrni kujde dhe vazhdoni përpara!

4. Së fundmi, dua të shkruaj rreth popullit të Perëndisë në politikë, në krah të majtë, në krah të djathtë, pa krahë. Në ShBA kjo është tani një fushë kundërshtie dhe ndarjeje të madhe mes popullit të Perëndisë dhe po përkeqësohet nga dita në ditë. Një prej besimeve të mia më të forta është se Perëndia

mund të punojë përmes një Kise të ndarë (duke folur për tërë trupin e Krishtit) meqenëse me këtë i është dashur të punojë gjithmonë. Pse të mos e provojmë me njërën prej Letrave në Dhjatën e Re? Ky, gjithsesi, nuk është kurrë justifikim për mungesë dashurie apo për ndonjë mëkat tjetër. Një pjesë e madhe e problemit ka lidhje me faktin se disa njerëz besojnë në “teorinë e kombit të krishterë” ndërsa të tjerë nuk e besojnë. Unë nuk besoj në “teorinë e kombit të krishterë”, por i dua ata që e besojnë. Të gjitha kombet në të gjitha kohët kanë vepruar mes ligësisë dërrmuese. Ata që besojnë se e gjitha kjo do të ndryshojë në të ardhmen janë të mashtruar, por i dua edhe ata.

U diplomova në histori para se të transferohesha tek “Moody Bible Institute” në Çikago (Chicago) dhe kam studiuar histori që atëherë. Mund të mësojmë shumë nga historia. Leximi i pikëpamjeve të ndryshme është i vështirë dhe zbulimi i asaj që ka ndodhur vërtet është edhe më i vështirë, kështu që të gjithë studentët e historisë duhet të jenë të paktën të përlurur dhe ndoshta më pak dogmatikë. A duhet të përfshihen të krishterët në gjuhë urrejtjeje dhe të qarkullojnë mesazhe elektronike urrejtjeje? Nuk mendoj kështu, por nëse e bëjnë, në njëfarë mënyre Perëndia ynë i fuqishëm akoma i do dhe mund t’i përdorë më shumë se ç’do të doja unë ndonjëherë. Kësisoj, ju lutem të mos shkurajoheni nga rrëmuja në këtë fushë ose në qeveri, por të përpiqeni të përqendrohni te Perëndia dhe ajo që Ai po bën në mes të rrëmujes. Kemi shumë mijëvjeçarë histori për të treguar ç’mund të bëjë Perëndia në mes të një rrëmuje. Ndoshta duhet të shkojmë të shohim filmin e fundit të bujshëm “Noah” (2014) dhe t’ia kujtojmë vetes.

Kjo nuk do të thotë se nuk besojmë në të qenët kripa dhe drita, dhe sigurisht nuk do të thotë se të krishterët nuk duhet të përfshihen në politikë ose që nuk ka vend për atdhetarë. Perëndia punon brenda kulturës sonë dhe këto gjëra janë pjesë e rëndësishme e kulturës sonë. Sa më shumë vlera të

vërteta të krishtera të mund të shohim në shoqëri, përfshirë vetë komunitetin tonë, aq më mirë është, por ne nuk mund t'i detyrojmë dhe të bëjmë ligje në vendin e tyre. Nuk duhet ta përziejmë qeverisjen me kishën. Të tepërt janë ata që po luftojnë errësirën këto ditë në vend që të përhapin dritën. Është betejë e humbur dhe nuk ia vlen mundi. Le të kuptojmë cilat janë përparësitë tona. Më shumë se kaq, le të respektojmë faktin se Perëndia do t'i drejtojë njerëz të ndryshëm dhe kisha të ndryshme në mënyra të ndryshme. Pse të mos ecim edhe një milje më shumë duke respektuar drejtimin që Perëndia u jep njerëzve të tjerë? Në shumë çështje të afërta nuk do të biem të gjithë dakord, por shpresoj që mund të biem dakord se Perëndia ynë mund të bëjë gjëra të mëdha në çfarëdolloj situatë, përfshirë ato prej të cilave mund t'ia mbathnim.

KAPITULLI 5

KISHA, MISIONET DHE HOLLIUDI

Në kapitujt paraardhës preka shkurtimisht vetëm pak fusha që duken të ndërlikuara dhe të rrëmuishme. Jam i sigurt se nuk dëshironi ta teproni me leximin rreth këtyre çështjeve, por më lejoni të radhis shkurtimisht disa të tjera të rëndësishme në këtë kapitull. Kam lexuar dhe folur me njerëzit rreth të gjitha këtyre fushave të shumta për gjysmë shekulli, kështu që më duroni pak. Besoj se kuptimi i tyre do t'ju ndihmojë të jeni më të rizgjuar nga hiri, zemërmëdhenj dhe falës. Besoj se do të keni urtësi dhe mendjemprehtësi më të madhe për të përballuar situatat e vështira, veçanërisht nëse jeni drejtues.

Qeverisja e kishës

Kur isha i krishterë i ri nuk mund ta kisha besuar kurrë sesa shumë mënyra të ndryshme ka për të udhëhequr një kishë dhe sesi Zoti duket se bekon aq shumë metoda të ndryshme. Shpesh ata që kanë një metodë të veçantë besojnë fort në të, dhe nëse jeni një prej tyre nuk po ju kërkoj të ndryshoni, por ndoshta do të jeni paksa më pak dogmatik ndërsa mendoni se mënyra juaj e të bërit të gjërave është e vetmja mënyrë. Po të thonim gjëra si “njëra nga mënyrat” do të ishte shumë më e arsyeshme sesa të thonim “kjo është mënyra e vetme”.

Tani kemi kisha të udhëhequra nga skuadra dhe ky koncept quhet nganjëherë drejtimi me pleq, i cili daton që nga Lëvizja e Vëllezërve (Brethren Movement), lëvizje shumë dinamike në kohën

e saj e në disa raste edhe sot. Dejll Rotën (Dale Rhoton), të cilin e takova në Maryville College dhe e pata me vete në Meksikë gjatë atij udhëtimit të parë fare, u bë pjesë e Lëvizjes së Vëllezërve dhe shkruajti një libërth ku shpjegohej se kjo ishte mënyra e Dhjatës së Re. Unë sa po filloja ta kuptoja këtë lëvizje të pashoqe, pasi kisha adhuruar mes tyre në Qytetin e Meksikos (Mexico City). Uilliam Mekdonëlld (William MacDonald), President i Emmaus Bible College në Çikago (Chicago) në atë kohë, po bëhej gjithashtu mik dhe mbështetës. Libri i tij “True Discipleship” (Gospel Folio, 2003) u bë ndikim i madh në lëvizjen tonë. Kishte shumë faktorë që më çuan të pagëzohesha përmes zhytjes nga Dejll në Bethany Chapel në Uitën (Wheaton). Megjithatë, në atë fazë të jetës sime isha tashmë shumë ndërdenominacional meqenëse Moody Bible Institute më kishte ndihmuar për të ndjekur atë rrugë. Në vazhdim u martova me një baptiste, uau!

Dejlli dhe ca të tjerë u rekomanduan nga asambleja e tyre për të punuar me OM-në dhe ne e konsideruam këtë përgjigje të madhe lutjeje. Nga ta dinim ne atëherë se disa vite më vonë do ta gjenim veten duke nisur një punë në MB, ku lëvizja e vëllezërve ishte lindur dhe akoma vazhdonte e fortë. Historikisht, disa prej udhëheqësve tanë, përfshirë Drejtorin e parë në MB, Kith Bekuith (Keith Beckwith) e më vonë Piter Meiden (Peter Maiden), i cili më vonë u bë Ndhimësdrejtor e më pas pasues, ishin të lidhur me ta. Lëvizja e Vëllezërve ka patur shumë ndarje, pothuajse çdo kishë individuale ka patur një ndarje, por Perëndia vazhdon të punojë dhe Lëvizja është akoma lëvizje relativisht e shëndetshme globale. Të qenët i pranuar prej shumë prej tyre, madje duke folur në ngjarje madhore për udhëheqës, ka qenë nxitje e madhe për mua. Disa tani kanë pastorë që përpiqen të drejtojnë duke qenë akoma lojtarë skuadre. Të tjerë tmerrohen nga kjo ide, gjë që ka shkaktuar ndarje të reja. Të jemi të sigurtë, në mënyrën misterioze të të punuarit të Perëndisë, shkëputjet dhe ndarja janë një nga mënyrat sesi kisha rritet. Me këtë nuk justifikojmë ndonjë mëkat ose sjellje të keqe.

Përsëri, koncepti i punës së Perëndisë në mes të rrëmujës na sheh ngultazi në fytyrë.

Nuk na mjafton hapësira për të parë të gjitha mënyrat e ndryshme sesi kishat drejtohen. Për habinë e shumë prej nesh, shërbesa jonë në Indi, plotësisht e drejtuar nga indianët, vendosi të ndiqte më mirë një rrugë që përziente vëllezërit, baptistët, metodistët dhe anglikanët, duke patur gjithashtu një dell karizmatik. Kishat “The Good Shepherd” janë ndër frytet më të mëdha të tërë historisë sonë, por na u desh t’i lejonim që të gjenin udhën e tyre, dhe ndryshimi i pikëpamjes sime në lidhje me mënyrën sesi Perëndia punon më ka ndihmuar ta kuptoj më shumë se ç’mund ta shpreh me fjalë. Të jeni të sigurt se jam tifoz i zjarrtë dhe mbështetës i fortë i asaj që po ndodh, por kjo nuk do të thotë se jam dakord plotësisht me të ose që e kuptoj plotësisht. Sa herë që ka shumë njerëz që vijnë te Krishti në një rast të vetëm, nuk është thjesht rrëmujë, por megarrëmujë! Ja pse duhet të lutemi dhe të mbështetim më shumë se kurrë atë punë të madhe dhe punë të tjera të mëdha. Përmes kësaj rritjeje të shpejtë kemi mësuar se *gabimet kushtojnë*. Kemi mësuar gjithashtu më shumë sesi djalli dhe ndihmësit e tij mund të përdorin thashethemet në përpjekje për të shkatërruar punën tonë. A nuk është e mundur që ne të gjithë thjesht të jemi pozitivë për mënyrat e shumta sesi Perëndia punon në këtë larmi kishash me stile të ndryshme udhëheqjeje?

Holliudi dhe filmat e krishterë

Kur isha fëmijë, më pëlqenin shumë filmat e mirë (dhe disa të këqinj) kështu që ishte goxha tronditje si besimtar i ri kur më thanë se filmat dhe kinemaja janë nga djalli! Tek Moody m’u desh të nënshkruaja një letër se nuk do të shkoja të shikoja filma. Ndieja aq fort për Jezusin dhe misionet botërore, sa që në njëfarë mënyre nuk doja të rrezikoja dhe në shumë çështje thjesht zbatoja urdhrin e ditës. Vetëm më vonë e kuptova se një pjesë e madhe e kësaj ishte legalizëm dhe shpejt isha në kthetrat e tij. Një gjë e sigurt

është se qindra vjet na provojnë se Perëndia mund të punojë në mes të një mjedisi legalist, por besoj se Bibla na mëson se ka një mënyrë më të mirë. Kjo është e lidhur ngushtë me kulturën dhe me mënyrën e mahnitshme sesi Perëndia duket i aftë për të hyrë me forcë në pothuajse çdo situatë kulturore. Kur një teksan shpëtohet, mbetet teksan. Kjo mund t'i acarojë miqtë tanë të krishterë nga Bostoni, por nuk është problem i madh për Perëndinë e Gjallë. Shumë keqkuptime mes shteteve, kombeve dhe qyteteve mund të zgjidheshin po të ishim më të qendëruar te Perëndia dhe po t'i kuptonim më mirë udhët e Tij të mrekullueshme.

Lëvizja jonë eci paralelisht me Lëvizjen e Filmave të Krishterë (Christian Film Movement) nën udhëheqjen e njerëzve si Ken Anderson dhe shumë të tjerë. Edhe në vitin 1963 kishim projektorë në shumë prej kamionëve tanë ndërsa i binim kryq e tërthor Evropës, duke arritur miliona njerëz me Fjalën e Perëndisë. Kemi përdorur filma (dikur videokaseta, tani DVD) në shkallë të gjerë që atëherë. Shpejt zbulova se pothuajse të gjithë ato filma kritikoheshin, veçanërisht nga njerëz në botën e filmit. Shumica, sigurisht, ishin me buxhet të ulët, kështu që kishte kufizime të mëdha. Historia dhe qielli do ta tregojnë sa miliona njerëz erdhën te Jezusi përmes këtyre filmave. A nuk na tregon kjo sesi të menduarit e Perëndisë ndryshon aq shumë nga të menduarit tonë? Kemi dëshirë të madhe për gjëra të mëdha dhe filma më të mirë, por ndërkohë Perëndia po përdor atë që ne e quajmë jo fort të mirë ose madje e hedhim poshtë. A nuk jemi ne shumë më gjykses dhe mendjengushtë se Perëndia i gjallë? Sipas jush, kush duhet të ndryshojë?

Ndërtesat e kishave

Hedhja e parave për ndërtesat e kishave ndërkohë që ka njerëz që vdesin nga uria dhe të tjerë që jetojnë në varfëri anembanë botës është diçka që shumë nuk mund ta kuptojnë. Sistemi klasor që e shoqëronte në shekullin e nëntëmbëdhjetë është thujtë përtej së

kuptueshmes për radikalët shoqërorë të krishterë të kohës sonë. Lëvizje të tëra u lindën kryesisht si reagim ndaj tij, lëvizje si “Salvation Army” dhe metodistët. Këto lëvizje dhe shumë të tjera, e përhapën besimin e tyre nëpër botë, kështu që edhe në Indinë dhe Pakistanin e ditëve tona kemi ndërtesa të mëdha, shpesh të lidhura në çështje gjyqësore, zakonisht të rrënuara dhe shumë të shëmtuara. Po, kini kujdes nëse do të thoni se Perëndia nuk po punon mes njerëzve në disa nga këto ndërtesa sot.

Disa prej lëvizjeve të mëdha e të reja të kishave kanë akoma, për mendimin tim, një pasion të pashëndetshëm për ndërtesa të reja e të veçanta. Është problem për mua, por nuk ma merr mendja se është problem i madh për Perëndinë. Pyes veten nëse e kuptoni çfarë po përpiqem të them. Disa njerëz mërzhiten shumë nëse disa nga ndërtesat e vjetra shiten dhe bëhen xhami, për shembull. Personalisht, mendoj se Perëndisë i interesojnë më shumë njerëzit, përfshirë muslimanët, sesa ndërtesat e vjetra. Në fakt, pyetja që Perëndia mund të jetë duke na bërë është pse nuk po i duam dhe arrijmë fqinjët tanë muslimanë me ungjillin. Disa nga kishat që janë mbyllur kanë qenë shpirtërisht të vdekura prej vitesh, duke i kthyer shpinën dekada më parë së vërtetës së Shkrimit; pse atëherë jemi aq të shqetësuar? Edhe në vende si Mbretëria e Bashkuar kemi mijëra kisha të reja dhe lloj-lloj grupesh të krishtera, dhe kjo sigurisht ka të bëjë më shumë me zemrën e Perëndisë sot. Ka një vend për ndërtesat e kishave dhe jam i sigurt edhe për të gjitha llojet e ndërtesave të tjera, por Perëndia do të udhëheqë njerëz të ndryshëm në mënyra të ndryshme dhe shumë pak do të ndikohen nga kultura e ditës së tyre, përfshirë kulturën e kishës. Shpesh më duket tronditëse, por fatmirësisht nuk mendoj se është problem i madh për Perëndinë.

KAPITULLI 6

A DUHET TË JEMI KAQ DOGMATIKË?

Sa e vështirë është që ne të krishterët mendjefortë, të përkushtuar, besimtarë të Biblës të ndryshojmë ndonjëherë! Por duhet të jemi të gatshëm për të ndryshuar nëse e kemi patur gabim. Po, pa bërë disa ndryshime shpesh mund të bëhemi shpirtërisht të ngecur dhe të pafrytshëm, shpesh pa kontakt me më të rinjtë. Pa ndryshim, bëhet e vështirë t'ia kalosh vizionin dhe shërbesën brezit tjetër.

Nëse kemi marrë mësim në një denominacion, kolegji teologjik ose kolegji biblik të caktuar, ndikimi prej tij do të jetë i madh. Ne të diplomuarit mund të ndjehemi sikur e kemi gjithë doktrinën tonë të çimentuar. Nganjëherë mendojmë se kemi përgjigje për gjithçka, madje edhe për pyetjet më të vështira të jetës dhe teologjisë. Sipas meje, ky është gabim i madh. Duhet të vazhdojmë të mësojmë dhe të rritemi, dhe kjo shpesh nënkupton të pranojmë se e kemi gabim. Duhet të qëndrojmë të palëkundur përse u përket bazave të besimit të krishterë, por në shumë çështje për të cilat ka shumëllojshmëri interpretimesh, besoj se është më mirë të mos jemi aq dogmatikë. Nëse duam, siç thotë Bibla, të “çmojmë tjetrin më shumë se vetveten” (Fil. 2:3), atëherë mendoj se duhet të bëhemi më të hapur për të dëgjuar të tjerët dhe të gatshëm për të ndryshuar.

Përgjatë viteve kam takuar shumë njerëz që nuk duken të interesuar për faktin se jam besimtar në Jezusin dhe i shpëtuar nga hiri i Tij. Mesa duket u intereson më shumë nëse jam i reformuar, karizmatik, arminian, baptist, e kështu me radhë. Ka të tjerë që duan të dinë çfarë besoj në lidhje me kohët e fundit, ose judenjtë,

ose cilin përkthim të Biblës përdor. Nuk po them se të gjitha këto nuk kanë vlerë, por a e kënaq kjo vërtet Perëndinë? A i jep ky lloj mentaliteti lavdi Perëndisë? Kjo duhet të ishte ajo që duam më shumë. A ka shpresë për pleq si unë, që pas pothuajse 60 vite studimi të Biblës, doktrinës së Biblës dhe, po, teologjisë, akoma nuk janë plotësisht të sigurt cila është e vërteta në lidhje me disa çështje kundërvënëse rreth të cilave udhëheqës të mëdhenj, që unë i respektoj shumë dhe librat e të cilëve i kam lexuar, e kundërshtojnë fort njëri-tjetrin?

Gjatë gjithë jetës sime më ka munduar fakti që shumë studiues të teologjisë e humbasin rrugën dhe nuk besojnë më se Bibla është Fjala e Perëndisë. E shpeshquajtura “teologji liberale”, u bë mbizotëruese në vitet 1920 dhe 1930 në shumë seminare dhe kolegje. A është e mundur që vetëm të fillojmë të kuptojmë ndikimin e teologjisë liberale në vende si Gjermania, Zvicra, Holanda, po, edhe në vende si Sri Lanka dhe India, dhe sigurisht ShBA-ja? Nën dritën e kësaj, a nuk duhet që ne që besojmë në Biblën, të qëndrojmë në unitet e të mos i lejojmë aq shumë çështje të vogla të na ndajnë? Përqaftimi i rrëmujologjisë do të na ndihmojë me siguri.

Po të kishte më shumë përulësi dhe më pak superdogmatizëm rreth çështjeve të vogla kundërvënëse, do të kishte më pak njerëz që do të reagonin ndaj saj e do të binin në pellgun e thellë të mosbesimit. Në fund, ka njerëz tepër dogmatikë që nganjëherë e humbasin plotësisht besimin e tyre. Historia e provon këtë dhe unë mund të kisha qenë njëri prej tyre. Çfarë po kërkoj? Një ndryshim qëndrimi? Po. Më shumë përulësi? Po, dhe një këndvështrim tjetër të asaj që Perëndia dëshiron prej nesh dhe mendjeve tona. Patjetër më shumë fryt të Frymës së Shenjtë dhe më pak vërejtje dogmatike. A do të përballemi ndonjëherë me mesazhin e qartë se pa DASHURI jemi ASGJË? A mund të ketë më shumë dëgjim dhe vlerësim ndaj atyre që besojnë ndryshe, veçanërisht nëse janë në themel njerëz që akoma besojnë se Bibla është Fjala e Perëndisë?

Së fundmi, një prej autorëve dhe predikuesve tanë superdogmatikë të modës së vjetër dënoi tërë Lëvizjen Pentakostale dhe Karizmatike, e cila është njëra prej lëvizjeve më të mëdha gjatë gjithë 2000 viteve të historisë së Kishës. Për habi, një tjetër mësues/pastor dhe teolog shkruajti një libër për ta kundërshtuar librin e parë. E gjej veten tek të dy ata. Ua, çfarë udhëtimi! Besoj se libri i dytë është më afër së vërtetës dhe zemrës së Perëndisë. Quhet “Holy Fire” (Charisma House, 2014) nga R.T. Kendall.

Kam shkruajtur gjithmonë kundër ekstremeve, gjë që e kanë bërë edhe shumë pentakostalë si Li Grejdy (Lee Grady) i revistës “Charisma”, dhe kjo pjesë e Trupit të Krishtit duket, më e pakta që mund të thuhet, më e cënueshme. Por sipas këndvështrimit tim, kjo lëvizje është ndër më besniket (me një larmi të pabesueshme denominacionesh dhe kishash) që beson se Bibla është Fjala e Perëndisë dhe me këtë predikon ungjillin në mënyrë besnike. Ja pse dhjetëra MILIONA njerëz kanë ardhur te Jezusi përmes përpjekjeve të tyre dhe si përgjigje ndaj lutjes.

Po, shtojnë shpesh mësimet e tjera dhe për disa mendoj se e kanë gabim. Megjithatë, ndiej se kjo është e vërtetë për shumicën e kishave dhe lëvizjeve në histori. Është e sigurt se Perëndia, në mëshirën e Tij, akoma shpëton njerëz në mes të gjithë kësaj dhe mendoj se shpëtimi i NJERËZVE është vërtet ajo që ka Perëndia në zemër. Për të çuar përpara mësimet tona të tjera, gjë për të cilën pentakostalët janë shumë të aftë, ne nënvlerësojmë rëndësinë e një shpëtimi kaq TË MADH. Më mundon vërtet fakti që kur miqtë e mi pentakostalë dhe karizmatikë sulmohen, ata shpesh bien në gropën e njëjtë të të qenët tepër dogmatikë rreth gjërave që nuk janë aq të qarta në Bibël dhe për të cilat burra të mëdhenj dhe gra të mëdha të besimit nuk kanë rënë dakord shekuj me radhë.

Një grup shpesh sulmon një grup tjetër duke treguar histori të tmerrshme rreth njerëzve të famshëm (veçanërisht njerëz të famshëm televizivë) që kanë dështuar dhe mëkatuar në fusha madhore. Prej vitesh kam ndier se nuk mund të provosh gjë me

histori të tmerrshme të krishtera, ndonëse duhet të shqyrtohen. Perëndia na urdhëron të mendojmë më shumë për “gjërat që janë të vërteta, gjërat që janë të ndershme, gjërat që janë të drejta” etj (Fil. 4:8). Punëtorë të një shoqërie të rëndësishme misionare konservatore janë burgosur për pedofili, gjë që na thyen zemrat, por kjo nuk provon gjë për misionin dhe pjesën tjetër të njerëzve. Pikërisht këtë mëngjes po studioja rreth Davidit, Saulit dhe Solomonit. Nëse lexoni librin e shkëlqyer “Rebuilding Your Broken World” nga Gordon Mekdonëlld (Gordon MacDonald), do të shihni se shumica e shenjtorëve të Dhjatës së Vjetër kishin ato që ai i quan “përvoja të botës së thyer”. Po, ka shumë fusha ku duhet të jemi të fortë dhe të palëvizshëm (disave u pëlqen fjala “dogmatikë”), por le të qëndrojmë gjithmonë të përlur, të mësueshëm dhe të gatshëm për të ndryshuar e për t’u bërë **MË SHUMË SI KRISHTI**.

A interesohemi për njerëzit vetëm meqë është pjesë e punës sonë apo interesohemi vërtet për njerëzit për shkak të punës revolucionare të HIRIT në zemrat tona? Kjo më çon në një pyetje tjetër ... a interesohemi për njerëzit kryesisht kur janë pjesë e organizatës sonë, e kësaj pasie të largohet prej nesh mezi u mbajmë mend emrin, apo bëjmë një përkushtim dashurie dhe interesohemi për ta pavarësisht ku mund të shkojnë? Kërkimet e mia tregojnë se shumë njerëz shpejt ndjehen të harruar pasi largohen nga një shërbesë ose organizatë. O sa mirë di ta përdorë djalli këtë! Ai përpiket t’i bëjë të besojnë se organizata vetëm sa i përdori. Shumica e njerëzve thonë se nuk kanë kohë të mbajnë lidhje me aq shumë njerëz, por kur studioj jetët e njerëzve dhe shoh sesi e shpërdorojnë kohën, më ikën truri. Përballja me të vërtetën e vetëqendërimit tonë dhe mungesën e dashurisë së vërtetë dinamike, falëse dhe praktike është e vështirë për ne. E shkruaj këtë edhe për vete meqenëse jam shtegtar, dështak dhe nxënës.

KAPITULLI 7

ROMANCA, MARTESA, PARAJA DHE SHUMË MËSHIRË

Mendoj se në moshën trembëdhjetë vjeçare romanca u bë gjëja më e madhe në jetën time, në konkurrencë vetëm me sportin dhe fitimin e parave. Vajza e parë me të cilën dola u bë e dashura ime e qëndrueshme. Mendoj se pas mësimeve të vallëzimit shkuam për të parë “Quo Vadis” (1951) dhe vetëm përjetësia do ta tregojë çfarë lloj ndikimi pati ai film në jetën time si i ri. Rreth së njëjtës kohë, e dashura zonja Kllep (Clapp), e cila banonte përballë shkollës sime të mesme, e përfshiu emrin tim në “Listën Kryesore të Frymës së Shenjtë”, duke u lutur që të bëhesha jo vetëm i krishterë, por edhe misionar. Ua, as nuk e diskutoi këtë me mua. Në fakt kisha plane të tjera për jetën time. Tashmë i isha futur biznesit dhe po mendoja ta vazhdoja këtë karrierë.

Një vajzë fantastike e quajtur Lin (Lynn) pati ndikim të mirë në jetën time. Ajo shkante në një kishë baptiste dhe unë nuk ia kisha idenë çfarë ishte ajo. Mbaj mend që më tregoi vendin e pagëzimeve, i cili m'u duk gjë e çuditshme. Arrita të njoh dhe vlerësoj prindërit e saj dhe patën të gjithë ndikim të mirë në jetën time. Lin dhe unë vallëzanim dhe nganjëherë putheshim gjithë pasion, por nuk kalonim përtej kësaj, gjë për të cilën jam mirënjohës ndërsa kthej kokën pas. Pasi u ndamë, kishte shumë vajza të tjera që m'i dogjiën qarqet romantike dhe me trishtim them se rreth asaj kohe, në shkallë të vogël, u futa në botën e së ashtuquajturës porno e lehtë dhe epush. Pikërisht në këtë kohë, Ungjilli i Gjonit, i dërguar nga zonja Kllep dhe djali i saj, Deni (Danny) hynë me forcë në jetën time. Edhe

në kishën time të reformuar gjysmëliberale kisha një mësues të përëndishëm të takimit të fëmijëve i cili thujse u bë dëshmitar i Jehovahit, por përmes shërbesës në radio të Dr. DeHaan u bë besimtar dhe rrjedhimisht pati ndikim tek unë. Pas ardhjes sime në besim, ai do të bëhej shok për gjithë jetën. Quhej Fred Gnade. Më kujtohet veçanërisht motra e tij e vogël, Shërlli (Shirley), vajza e shtëpisë ngjitur gjatë fëmijërisë sime aty në Van Houten Ave, Uikof (Wyckoff), Nju Xhersi (New Jersey). Ajo ishte vajza e parë që kam puthur ndonjëherë – mendoj se ishim gjashtë vjeç.

Jezus Krishti, Madison Square Garden, Billi Graham dhe 3 marsi 1955 sollën gjithë ndryshimin tim. Atë natë u linda prej së larti dhe gjithçka nisi të ndryshonte. Mund të lexoni diçka rreth atyre ditëve të hershme në historinë zyrtare të OM-së, “Spiritual Revolution” (Authentic Media, 2008) nga Ian Randell. Isha i ri në familjen e Perëndisë dhe shpejt do të zbuloja sa të ndryshëm ishin dhe sesa rregulla ishin futur në lojë. Dukej sikur nuk më lejohej më të vallëzoja ose puthja, por nuk gjeta vargje rreth kësaj kështu që vazhdova t’i bëja të dyja.

Tani isha 17 vjeç, kisha makinën time personale (Henry J – ua, jemi vërtet të së njëjtës kohë!), dhe maturant në shkollë të mesme, kur më ra në kokë për një vajzë që quhej Margo, e cila ishte shumë më e re dhe shkonte në Kishën Episkopale. Perëndia po më ndiqte fort ndërsa i isha futur Fjalës dhe kisha nisur të ungjillëzoja shkollën e mesme ku isha zgjedhur President i Këshillit Studentor. Më kishin mbajtur larg Shoqërisë së Nderit Kombëtar për shkak të marrëzisë sime dhe sjelljes si palaço, por vitin e fundit jeta ime kishte ndryshuar aq shumë sa që më në fund u pranua në atë shoqëri, gjë që kishte vlerë të madhe në kulturën tonë asokohe. Në atë kohë kisha bërë një budallallëk të madh. Parkuar jashtë rrugë, në një si tip pylli, Margoja dhe unë nisëm të “fërkoeshim” (nuk jam i sigurt nëse amerikanët e përdorin akoma këtë term) dhe ndërsa nisa të kaloja pak më tej, policia i ra xhamit tim dhe ju siguroj se nuk mbaj mend çfarë tha oficeri. Në panik, eca mbrapsht

dhe e futa makinën në një kanal nga i cili nuk munda të dal. Ishte nata më e keqe e viteve të adoleshencës sime meqenëse babait të saj iu desh të vinte e të na shpëtonte; për shkak se ndoshta i kishte kthyer disa gota, më akuzoi për gjëra që nuk i kishim bërë dhe marrëdhënies sonë i erdhi shpejt fundi. Jam ndjerë gjithmonë keq për këtë meqenëse e di se e lëndova këtë vajzë të re dhe shpejt humba lidhjet me të.

Një tjetër ngjarje e ngjashme në një parking të kishës do t'i jepte fund romancës së egër në jetën time; jam i sigurt se ndodhi për shkak se njerëzit po luteshin. Vendosa të bëja “agjërime të menjëhershëm”, zero dalje me vajza, zero puthje (përveç jastëkut, pak fare), dhe kjo vazhdoi për pothuajse dy vjet. Vajza tjetër me të cilën dola pas kësaj ishte Drena, e cila u bë bashkëshortja ime.

Kisha zgjedhur të shkoja në Maryville College kryesisht sepse kishin vallëzim pas drekës çdo ditë. Kurrë nuk vallëzova apo dola me vajza atje. Pikërisht në atë vend ndodhi shumë nga rritja ime e hershme në jetën e krishterë. Isha në zjarr për Jezusin, siç e thonë disa. Çdo orë të lirë kur nuk studioja dilja për të ungjillëzuar ose për t'u lutur, lexoja Fjalën ose shkoja në ndonjë takim të krishterë. Në një mënyrë të mahnitshme, një pastor baptist në një kishë fshati më lejoi të predikoj. Pastaj u hap dera për predikim në Burgun e Kontesë Bllaunt (Blount County Jail) i cili, ndërsa isha akoma 18 vjeç, më hapi derën për të ndarë Fjalën në Shtëpinë e Korrektimit të Shtetit të Neshvillit (Nashville State Penitentiary).

Në jetën time hynë libra fantastikë si “The Passion for Souls” (Welch, 1986) nga Osuëlld (Oswald) Smith dhe “Through Gates of Splendour” (Authentic Media, 2005) nga Elizëbeth (Elisabeth) Elliot, si dhe shumë të tjerë. Një kurs në distancë sesi të drejtoja njerëzit tek Krishti pati ndikim të madh tek unë. Pasi pastori baptist që përmenda më parë më mori me vete në konferencën time të parë për misionin në të njëjtën rrugë në Çatanuga (Chattanooga) në një kolegji biblik të quajtur “Tennessee Temple”, nuk isha më i njëjti person. Që para ardhjes sime në besim, për shkak të Ungjillit

të Gjonit dhe “Pocket Testament League” që e kishte botuar dhe shpërndarë, doja që gjithkush, kudo ta kishte atë libër fantastik. Si i krishterë “foshnjë” mora premtimet e 1000 bashkëstudentëve të shkollës sime të mesme për ta lexuar atë. Ndërsa u njoha me shumë kombe dhe zbulova sa shumë ishin aq të paarritur, vizioni për t’i arritur ata, veçanërisht muslimanët, nisi të rritet në zemrën dhe mendjen time. Kur nisa të kuptoj se duheshin urgjentisht financa, nisa të shes gjithçka që mund të shisja dhe i dhashë paratë për misione botërore. Nisa të punoj si kamarier në restorantin e kolegjit për të qenë në gjendje që të jepja më shumë.

Gjatë kësaj periudhe shkuam për herë të parë në Meksikë në verën e vitit 1957. Shpejt nisa të flas një spanjishte të varfër dhe ndikimi i asaj që pashë si dhe faktorë të tjerë bënë që të doja të largohesha nga “Liberal Arts Maryville College” dhe të shkoja në “Moody Bible Institute” në Çikago. Doja veçanërisht të jetoja dhe ungjillëzoja në Qytetin e Madh. Këtë përvojë e kisha shijuar paksa afër shtëpisë sime kur kisha shkuar për të shpërndarë fletushka në sistemin e metrosë së qytetit të Nju Jorkut dhe më vonë, pak para se të shkonim në Meksikë, ku isha përfshirë në fushatën e famshme të Billi Grahamit. Kisha predikuar edhe në rrugë atje.

Mbërritja në një vend si “Moody Bible Institute” ishte tronditje e madhe për mua, veçanërisht kur pashë aq shumë vajza tërheqëse. Duhet të më kenë dalldisur disa prej tyre javën e parë, por e mbajta premtimin dhe e vazhdova agjërimin e plotë të romancës. Ndërsa kthej kokën pas, pyes veten nëse do të më kishin goditur në kokë me Biblat e tyre të mëdha “King James”, po të isha përpjekur të puthja ndonjërin! Sigurisht, “Moody” kishte një libër rregullash dhe dukej se kishte rregulla të rrepta për gjithçka.

Pasioni im për ungjillëzimin më çoi për të marrë një film nga zyra e “Moody” në katin e shtatë ose të tetë; nuk e dija se kjo ditë do të më ndryshonte jetën. Drena ishte ulur tek recepsioni përgjegjës për atë zyrë. Kur e pashë, m’u dogj qarku romantik dhe e prisha agjërimin, duke hedhur hapa drejt synimit. Për mua ishte

dashuri me shikim të parë, por sapo thashë diçka disi të marrë, për të ishte frikë me shikim të parë! Nuk ndodhi gjë, por pranoi që të takoheshim. Pikërisht atëherë i thashë: “Epo, ndoshta nuk do të ndodhë asgjë mes meje dhe teje, por nëse ndodh, le të themi ndonjë tip martesë, duhet të kuptosh se unë do të bëhem misionar dhe ty ndoshta do të të hanë kanibalët e Guinesë së Re”. Sesi pranoi më në fund të marotohej me mua është histori e gjatë, përfshirë një verë të vështirë sëbashku në qytetin e Meksikos dhe lënien e saj atje kur u ktheva tek “Moody”. Kjo çoi në rënien në dashuri të shokut tim më të mirë meksikan me të dhe në telefonatën e tij për të më pyetur nëse ishte problem. Epo, kjo më çoi në agjërim serioz dhe lutje serioze. Pas një telefonate me Drenën, ajo u nis shpejt në udhëtimin e gjatë me autobus për t’u kthyer në Çikago.

Përmes gjithë kësaj u binda thellësisht se më mungonte dashuria praktike dhe ndjeshmëria. Drena po zbulonte veten dhe nevojat e saj të thella emocionale. Fejesa jonë mund të ishte prishur nëse nuk do të kishte patur atë përvojë të thellë me Jezusin në qetësinë e dhomës së saj ndërsa kuptonte diçka rreth gjithëmjaftueshmërisë së Jezusit. Kjo çoi gjithashtu në një përvojë shërimi të disa simptomave fizike që e kishin shqetësuar për një kohë të gjatë.

Nuk do ta harrojmë kurrë atë ditë të madhe, 31 janar 1960, kur u martuam. Nuk bëmë ndonjë gjë të jashtëzakonshme; Henri (Henry) njerku i Drenës nuk ishte i krishterë. Historia e ardhjes së tij në besim vite më vonë është diçka për të cilën do ta falënderojmë gjithmonë Perëndinë. E zhvilluam ceremoninë e martesës pas shërbesës së mëngjesit të së dielës tek “Lake Drive Baptist Church”. Ata nuk kishin ndërtesën e tyre, kështu që ndodhi në një palestër shkolle. Uolltër Borchërd (Walter Borchard) ishte shoqëruesi im. Erdhi një autobus nga Çikago me miqtë tanë, kryesisht studentë të “Moody”. Dejlli predikoi një mesazh të fuqishëm, duke përmendur se ndoshta gjëja më e mirë që mund të bënin për ne ishte që të luteshin sepse me shumë mundësi ne

do t'i shisnim të gjitha dhuratat për para për misionin botëror. Ah sikur të mos e kishim humbur atë kasetën e vjetër të mbushur me atë mesazh!

Ndërsa kujtojmë pesëdhjetepesë vitet e martesës sonë, çfarë mund të ndajmë për të ndihmuar ata që po e lexojnë këtë? Rreth vitit 1970, do të shkruaja një libër rreth martesës dhe kisha zgjedhur edhe titullin, "The Revolutionary Marriage", e madje kisha edhe skicën. E vërteta është se kisha nevojë të mësoja më shumë sesi ta bëja martesën tonë të funksiononte në vend që të shkruaja rreth saj. Ja disa mësimet që kam mësuar rrugës:

1. Martesa jonë bazohet tek Bibla. Ky ka qenë themeli praktik i martesës sonë, duke e dashur Krishtin gjithmonë në qendër të gjithçkaje. Jetesa në dysheme në fund të librarisë sonë në qytetin e Meksikos kur ishim të sapomartuar solli disa sfida dhe shpejt do të mësoja se martesë ishte vërtet programi i doktoraturës nga Perëndia për shenjtërim. Lexuam "Rizgjimi në shtëpi", njërin prej kapitujve në librin "The Calvary Road" nga Roi Hesiën (Roy Hession) dhe mësuam më shumë rreth të qenët i thyer, përlësisë dhe një jete të mbushur me Frymën e të kryqëzuar. Vazhdimisht përgjatë gjithë këtyre viteve e dija se kisha pikërisht personin e duhur për të qenë partnerja e jetës sime dhe përmes hirit të Tij i kemi qëndruar plotësisht besnikë njëri-tjetrit, gjë për të cilën shumë njerëz qeshin tani. Nga Bibla nuk pamë alternativë tjetër. Vendosja në qendër të vëmendjes e gjendjes së humbur të njerëzve dhe nevojës së tyre për t'u arritur, është diçka që na ndikon çdo ditë.
2. Ideja e "Revolution of Love", të cilin e shkruajmë dhe predikojmë dhe përpiqemi ta praktikojmë me 1 Korintasve 13 dhe shkrime të tjera si themel, ka qenë ndër aspektet më të rëndësishme të martesës sonë. Unë priresha veçanërisht drejt ekstremizmit dhe pandjeshmërisë, dhe Perëndisë i është

dashur ta shembë këtë e të merret me mua. Padurimin e kam patur problem gjithë jetën. Urrejtja ime ndaj mëkatit dhe çdo lloj krenarie më kanë ndihmuar të përulem e të pendohem shpejt. Mrekullia e hirit që më çliroi nga zemërimi në ditët më të hershme të ecjes sime me Perëndinë ishte faktor madhor në ecjen tonë sëbashku dhe në udhëheqjen e lëvizjes prej meje. Akoma kisha dështime të herëpashershme për të cilat duhet të pendohesha shpejt, por edhe sot ndjehem i trishtuar për rastet kur kam lënduar gruan time e më vonë fëmijët e mi me një shpërthim zemërimi ose me një fjalë të ashpër. Mbërritja në Angli nga Spanja, ku u lind Beniamini (Benjamin), djali ynë i parë, ishte hap i madh për ne. Në atë kohë, leximi i veprës së rëndësishme të Billi Grahamit “Freedom From The Seven Deadly Sins” (Zondervan, 1963) më përuli dhe e falënderoj shumë Perëndinë për këtë libër. Siç e kam përmendur më parë, lexoja gjithashtu predikimet e tij në radio gjithë kohën si i krishterë i ri. Libra të tjerë nga ai si “Peace with God” dhe “The Secret of Happiness” (Thomas Nelson, 2002) ishin që të gjithë kyçë në hedhjen e themelit në jetën time.

3. Dëshira jonë për të arritur njerëzit me Fjalën e Perëndisë në shkallë lokale dhe botërore, bashkë me nisjen e një lëvizjeje misionare krejt të re, sillte gjithmonë tension financiar dhe sfida dhe më çonte drejt një ekstremizmi që Perëndia dukej se e përdorte. Por në të njëjtën kohë dukej sikur i pështjellonte disa njerëz duke përfshirë këtu edhe gruan time. Unë theksoja Lukën 14:33: “Kështu, pra, secili nga ju që nuk heq dorë nga të gjitha që ka, nuk mund të jetë dishepulli im.” Ajo sfidë na kishte bërë të shitnim shumicën e gjërave që zotëronim. Kishte edhe të tjerë që na ndoqën në këtë, por nganjëherë na bënte gjykues ndaj atyre që dukej sikur po shpërdoronin para. Na duhej balanca që siguronte Filipianëve 4:19. Po fillonim të mësonim më shumë rreth misterit sesi gjëra që duken aq të

mira mund të kenë një anë të errët. Grija nisi të futet në botën tonë që deri atëherë kishte qenë bardhë e zi, dhe ka vazhduar të shtohet. E gjeni dot pse vargjet e fundit të Romakëve 11 kanë qenë aq të rëndësishme për ne?

*O thellësi pasurie, urtësie dhe diturie të Perëndisë!
Sa të pahulumtueshme janë gjykimet e Tij dhe të pashtershme janë udhët e Tij! “Sepse kush e njohu mendjen e Zotit? Ose kush u bë këshilltar i Tij? Ose kush i dha Atij më parë, që të ketë për të marrë shpagim?” Sepse prej Tij, me anë të Tij dhe për Të janë të gjitha gjërat. Lavdi Atij përjetë! Amen!*

4. Misteri më i madh ndërsa vazhduam udhëtimin e martesës ishte mospërgjigjja për shumë lutje edhe në fusha për të cilat është e vështirë të flasësh. Nisëm betejën ndaj sulmeve të shumta të shkurajimit, shpesh të lidhura me zhgënjimin. Vitet me tre fëmijë ndërsa jetonim në Indi, vitet në Katmandu, Nepal, e më pas në “Logos”, na dhanë raste të pafundme për të mësuar e për t’u rritur bashkë. Ndjeva ndihmën e Drenës dhe miratimin e saj gjatë gjithçkaje që kalonim dhe mbaj mend shumë pak raste ankimi, madje edhe në mes të betejës së ndezur.
5. Depresioni erdhi në jetën e Drenës në mesin e viteve 1970, gjë që na zuri të gjithëve të papërgatitur. Një grua u përball me mua gjatë asaj kohe duke vënë në dukje se ndoshta isha unë pjesë e problemit. Perëndia më përuli dhe më tregoi ndryshimet që duhej të ndodhnin në jetën time dhe në mënyrën sesi sillësia si bashkëshort dhe baba. Pas një viti, Drena doli nga ajo periudhë e errët dhe nuk u kthye më atje. Na trishtojnë përgjigjet e thjeshtëzuara që disa të krishterë e madje libra japin për këto sëmundje të ndërlikuara; sipas këndvështrimit tim, mësimet e skajshme rreth shërimit (dhe unë besoj se

Perëndia shëron) i kanë lënduar njerëzit dhe trupin e Krishtit në tërësi më shumë se ç'do ta marrim vesh ndonjëherë. Një kishë në ShBA, që shkoi deri në pikën më të fundit e të skajshme të “shmangies së plotë të doktorit”, ka varrezën e saj; deri njëzetepesë vjet më parë kishte mëse shtatëdhjetë të varrosur atje, kryesisht fëmijë.

6. Trajtimi i kritikave është pjesë e rëndësishme e udhëheqësisë. Mua nganjëherë më dukej i vështirë dhe ndjeja lëndim personal. Kurrë nuk kisha dëgjuar shumë kritika për martesën tonë ose gruan time, por e kishim të vështirë të merreshim me atë që dëgjonim, shpesh nga një burim i dytë. Një pjesë madhore e udhëheqësisë dhe ecjes suaj me Perëndinë do të vihet në provën e zjarrit kur t’ju kritikohet martesja. Për shkak të mëshirës së Perëndisë, jam i sigurt se nuk i dëgjojmë kurrë disa prej thashethemeve dhe kritikave më të këqija, veçanërisht duke qenë në korsinë e shpejtësisë në përpjekje për të ungjillëzuar tërë botën. Kam qenë shumë i bekuar që kam patur gjithmonë njerëz besnikë si Dejll Rotën (Dale Rhoton), Pitër Meiden (Peter Maiden) e të tjerë, të cilët e di që më kanë mbrojtur shpesh. Për udhëheqës që nuk kanë miq dhe bashkëpunëtorë kaq besnikë është shumë më e vështirë.
7. Ndërsa kthej kokën pas, kuptoj se kam mësuar shumë nga kritikët e mi dhe nga miq të ngushtë të cilët do të më vinin në dukje rreth diçkaje që shihnin në jetën dhe shërbesën time e që kishte nevojë për ndryshim. Perëndia na tregoi nga Fjala e Tij dhe librat e krishterë se nuk është e mundur të bësh gjë pa kritikim. Gjithmonë jemi përpjekur t’i duam kritikët tanë dhe kemi kërkuar bekimet e Perëndisë mbi ta. Fuqia e thashethemeve nuk na ka çuditur kurrë. E vërteta është se ishim/jemi të lumtur e të përmbushur shumicën e kohës, edhe tani që jemi futur në këto vite të pashoqe të pleqërisë

kur shumë gjëra ndryshojnë, veçanërisht në fushën e shëndetit. Jemi me fat që kemi patur shumë njerëz në lutje për ne dhe disa prej jush që po e lexoni këtë jeni në këtë kategori. Ju falënderojmë me gjithë zemër dhe shpresojmë se do të vazhdoni të luteni.

8. Balanca u bë një prej fjalëve më të rëndësishme të jetës sonë. Balanca mes punës dhe familjes. Balanca mes mbledhjes dhe shpërndarjes. Balanca mes dhënies dhe marrjes. Balanca në lidhje me ecjen edhe një milje tjetër për të arritur më shumë njerëz dhe ngadalësimin për të bërë qejf dhe për të kaluar kohë me familjen. Në Biblën time të vjetër kisha dy lista që funksiononin për balancën. Njëri prej librave të mi fillimisht titullohej “The Revolution of Love and Balance” (Revolucioni i Dashurisë dhe Balancës).
9. Fëmijët e tu dhe fëmijët e fëmijëve të tu gjithmonë të ndihmojnë të ndryshosh jetën. I jemi mirënjohës Perëndisë për tre fëmijët tanë dhe pesë nipërit dhe mbesat. Në këtë kohë nuk po e ndjekin të gjithë Zotin Jezus, por ne i duam dhe përpiqemi të jemi prindërit, dhe tani gjyshërit, më të mirë të mundshëm. Kalojmë kohë të mrekullueshme sëbashku, përfshirë këtu udhëtime dhe pushime. Për të qenë i sigurtë, jemi shumë të vetëdijshëm për dështimin dhe kuptojmë lehtësinë e asaj që tani e quaj “idealizëm jorealit shkatërrues”. Kur vendosim synime të larta, siç e kemi bërë, ne do të dështojmë. Disa jo të krishterë as nuk do t’i mendonin disa prej këtyre gjërave si dështime. Ja pse libra si “What’s So Amazing About Grace?” (Zondervan, 2002) nga Phillip Jeni (Philip Yancey) dhe “The Grace Awakening” nga Suindoll (Swindoll) kanë qenë aq të rëndësishëm për ne. E çfarë mund të themi për marrjen e ajrit të freskët të “The Ragamuffin Gospel” (Multnomah, 2005) nga Brenan Mening (Brennan Manning), i cili së fundmi shkoi

pranë Perëndisë? Në ato ditë të hershme veçanërisht, legalizmi kishte hyrë në lëvizjen tonë dhe në shtëpinë tonë gjithashtu dhe kishte bërë ca dëm. Tani duhet të praktikojmë 1 e Pjetrit 5:7 dhe “gjithë merakun tuaj hidheni mbi Të, sepse Ai merakoset për ju”, dhe të pranojmë faljen e Tij. Pa falje RRËNJËSORE, dishepullimi rrënjësor nuk do të funksionojë kurrë.

KAPITULLI 8

GABIMET KUSHTOJNË

U detyrohem aq shumë prindërve të mi, të cilët mund të mos e kenë njohur Jezusin personalisht gjatë fëmijërisë sime, por kishin shumë vlera të krishtera dhe na mësuan të dallonim të mirën nga e keqja. Ata më ndihmuan të mësoj sesi të punoj fort, që në moshë të hershme, gjë që hodhi një themel jetësor në jetën time para se të vija te Jezusi. Të punuarit fort në shkollë, sport dhe në Lëvizjen e Djemve Zbulues (Boy Scout) më ndihmuan gjithashtu ndoshta më shumë se ç'arrij ta kuptoj. Zbuluesit më dërguan në një Trajnim të Përparuar të Udhëheqësisë kur isha shumë i ri. Më thoni, a mendoni se Perëndia i Gjallë po më përgatiste për diçka që nuk mund ta kisha përfytyruar kurrë në një moshë aq të re?

Mësova shpejt se gabimet mund të kushtojnë dhe mund të sjellin vështirësi në më shumë se një mënyrë. Kur isha djalë i vogël bëra gabimin e mbajtjes së një monedhe njëqindarkëshe me hundë, e pas kësaj e gëlltita. Mamaja ime këmbëngulte që të shkoja nga shkolla në shtëpi sa herë që më duhej të shkoja në banjo. Shkolla Filllore “Washington” ishte afër shtëpisë sonë në 243 Van Houten Ave, Uikof (Wyckoff), Nju Xhersi (New Jersey), kështu që e morëm përsëri monedhën! Një gabim tjetër që bëra ishte mbi një liqen të ngrirë gjatë sezonit të patinazhit mbi akull; rashë brenda përmes akullit të thyer. Dikush më kapi dhe më nxorri jashtë. Kemi lexuar për të tjerë që e kanë bërë këtë gabim dhe kanë humbur jetën.

Gjithë jetën time, veçanërisht pasi u bëra ndjekës i Jezusit, kam qenë lexues i zellshëm. Tek ato që kam lexuar futen libra, gazeta, revista, artikuj dhe tani bashkëngjitje të pafundme mesazhesh elektronike, gjë që po më ndihmon të shkruaj këtë libër. Shikimi i shumë filmave dhe DVD-ve, veçanërisht dokumentarëve, ka qenë gjithashtu ndihmë e madhe. Asnjë libër nuk ka qenë më i rëndësishëm se Bibla, e cila besoj se është Fjala e Perëndisë. Bibla është e mbushur me histori suksesi të madh dhe dështimesh të mëdha dhe ne duhet të mësojmë nga të dyja.

Duket se, pavarësisht çfarë lexon, ti gjithmonë lexon rreth gabimeve që bëjnë të tjerët. Mendoj se, si besimtarë në Jezusin, është e rëndësishme që të mos mendojmë se të gjitha gabimet janë mëkat. Ato mund të kenë disa rrënjë në natyrën tonë mëkatore, por nuk janë gjithmonë plotësisht mëkat për të cilin duhet të pendohemi menjëherë. Satanit i pëlqen të përdorë mëkatet tona për të na shkurajuar ose mërëzitur me veten. Kur e lejojmë veten të mërëzitemi dhe zhgënjehemi, ia hapim veten mëkatit ose qëndrimeve dhe sjelljeve të gabuara, gjë që pastaj na fut në telashe të tjera shpirtërisht. Kështu, pra, mësimi i madh është që kur bëjmë një gabim duhet të marrim veten, të kërkojmë Planin B dhe të ecim përpara. Të gjithëve mund të na ndihmonte libri “Second Choice” (Paternoster, 2000) nga Viv Thomas.

Historia tregon efektin domino të gabimeve, me një gabim që çon te një tjetër. Në vitin 1988, humbëm anijen tonë të parë, “Logos” (e cila dikur ishte shtëpia e gjithë familjes sonë; falenderojmë Zotin për shtatëmbëdhjetë vitet e saj të shërbesës jetësore), tek disa shkëmbinj nënujorë në Kanalin Bigëll (Beagle Channel) në jug të Kilit dhe Argjentinës. Kërkimet nxorrën në pah një sërë gabimesh nga njerëz të ndryshëm që çuan në atë ditë fatale. Megjithatë, Perëndia ishte i mëshirshëm, nuk pati humbje jete dhe Ai e përdori gabimin për publicitet, lajm kombëtar, veçanërisht në MB, për të ndihmuar në gjetjen e fondeve për një anije shumë më të mirë, “Logos II” (e cila më vonë çoi drejt “Logos HOPE”). Nuk

dua të harxhoj kohë këtu duke folur për aksidentet e tmerrshme me makinë gjatë këtyre pesëdhjeteshtatë viteve, gjithmonë të shkaktuara nga, po, e gjetët, GABIMET.

Historia tregon gjithashtu se të gjithë bëjnë gabime dhe sigurisht, SA MË PAK GABIME, AQ MË MIRË. Nuk duhet të lejojmë që ajo që besojmë rreth sovranitetit të Perëndisë, apo ajo që unë e quaj Rrëmuologji, të na mbajë larg një përkushtimi të fortë ndaj arsyetimit të shëndoshë për t'i bërë gjërat siç duhet e për të bërë sa më pak gabime që të jetë e mundur. Do të doja që në një mënyrë a një tjetër në Kolegjin Biblik të më kishin paralajmëruar sa e vështirë është jeta dhe me sa probleme dhe vështirësi do të përballëshim të gjithë. Duhet të rilexojmë dhe studiojmë Jakobi 1 dhe 1 e Pjetrit 1, si dhe shumë pjesë të tjera. Nuk e kuptova kurrë sesi për aq shumë njerëz thjesht të pasurit para për të blerë ushqime është gjë e madhe dhe kërkon shumë disiplinë dhe punë të palodhur.

Ta konsideroni një gëzim të madh, o vëllezër të mi, kur ndodheni përballë sprovash nga më të ndryshmet, duke e ditur se sprova e besimit tuaj sjell qëndrueshmëri. Dhe qëndrueshmëria të kryejë në ju një vepër të përsosur, që ju të jeni të përsosur dhe të plotë, pa asnjë të metë. Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe atij do t'i jepet.

(Jakobi 1:2-5)

Përgjatë shërbesës sonë, dukej sikur ne, duke përfshirë OM-në, e mbitheksonim lutjen, besimin dhe jetën shpirtërore, duke dhënë përshtypjen e gabuar se nëse e kemi gjetur çelësin në ato fusha, gjithçka do të shkojë vaj. Tani, ndërsa kthej kokën pas drejt gjashtëdhjetë viteve në Krishtin, për shumë njerëz që kam ndjekur gjatë viteve, NUK KA SHKUAR VAJ! Pas besimit, lutjes dhe jetës

ungjillëzuese të OM-së, pati shumë që u kthyen në shtëpi dhe nuk mundën të gjenin ose të mbanin një punë. Disa nga martesat e njerëzve që janë takuar në OM janë prishur, shpesh për shkak se nuk kishin menduar për disa nga problemet me të cilat do të përballëshin në të ardhmen. Nëse kësaj i bashkon gabime të tjera që bëjmë lehtësisht, të del një formulë për telashe, shpesh telashe të mëdha. Shumë nuk kanë patur sukses në shërbesat, punët, e madje as në martesat e tyre. Takoj njerëz si këta gjithë kohën dhe përpiqem të ndaj hir radikal. U them: “Nëse keni dështuar shumë dhe e keni humbur Planin A, lavdëroni Zotin që Plani B mund të jetë po aq i mirë”. Disa kanë bërë shumë gabime, kanë patur shumë dështime dhe ndiejnë se ndoshta janë te Plani H ose M. U them: “Lavdi Zotit që alfabeti është i gjatë”. Njerëzit zakonisht qeshin në këtë pikë, por në fund nuk është gallatë. Ato gabime mund të ishin shmangur. Mund t’i kishim kursyer vetes dhe të tjerëve shumë telashe. Duhet të ruhem nga çfarëdo fatalizmi në cilëndo formë të tijën. Duhet t’i marrim seriozisht të gjitha mësimet biblike në të gjitha llojet e fushave shpirtërore dhe praktike, përndryshe pse e kemi librin e Fjalëve të Urta?

Mëkati është më serioz në shumë mënyra, por shpesh gabimet tona janë bashkim i mëkatit dhe budallallëkut të dalë mode. Ose, për të qenë më të butë, mungesë urtësie dhe gjykimi. Një nga arsyet pse kam lexuar aq gjerësisht është për të mësuar nga gabimet dhe dështimet e të tjerëve, dhe në jetën time kam lexuar për mijëra prej tyre.

Ja çfarë kam mësuar rreth mënyrave sesi mund të shmangim gabimet:

1. Ta ngopim veten me Fjalën e Perëndisë, duke ia dhënë veten lutjes dhe të gjitha aspekteve të ecjes sonë me Perëndinë. E kam ndarë këtë në të gjithë librat e mi të tjerë. Do të isha i lumtur t’jua dërgoja si dhuratë; ju lutem të më shkruani email nëse jeni të interesuar.

2. Të mësojmë disiplinën në të gjitha fushat bazë të jetës – të përpiqemi të ruhem nga legalizmi në çdo hap të rrugës.
3. Të mësojmë të lexojmë dhe të studiojmë fort. Të kemi një sistem për të mbajtur mend informacionet e rëndësishme.
4. Të mësojmë të mbajmë shënime. Nëse udhëtojmë, të kemi një listë të gjërave që nuk duhet të harrojmë. Tipet e reja të telefonave dhe aparateve mund të ndihmojnë, por duhet disiplinë gjithsesi.
5. Të planifikojmë paraprakisht dhe të llogaritim koston sikurse na bëjnë thirrje vargjet e fundit të Lukës 14. Mund të shkruaja një kapitull të tërë rreth këtij koncepti të rëndësishëm dhe disa prej gabimeve më të mëdha që kam parë janë në këtë fushë. Lloj-lloj njerëzish më kanë ardhur dhe kanë ndarë vizionin dhe ëndrrat e tyre të mëdha, por shumica prej tyre kurrë nuk bëhen realitet ose nuk zgjasin gjatë. Shpesh nuk e kishin llogaritur koston ose nuk ishin gati për të paguar çmimin.
6. Kur kemi kohë, të përpiqemi të mendojmë për pro-të dhe kundra-t e një hapi ose veprimi të caktuar që duhet të ndërmarim.
7. Të përpiqemi të kërkojmë këshilla. Kjo ka disavantazhet e veta si shumë gjëra në jetë sepse mund të marrim edhe këshilla të gabuara, kështu që gjithmonë peshojeni me kujdes profecinë personale.
8. Brenda mundësive, të planifikojmë paraprakisht. Të rikontrollojmë oraret, datat dhe të përpiqemi të llogaritim çfarë do të bëjmë nëse punët shkojnë keq. Të kemi një Plan B në mendje. Nëse unë udhëtoj me tren, gjithmonë përpiqem të marr një tren më përpara se ai që do të më çonte fiks në kohë.

9. Shumë nga gabimet tona bëhen kur jemi në lëvizje. Nga njëra anë, duhet të mësojmë të jemi udhëtarë profesionistë, duke mësuar nga gabimet tona dhe nga ato të të tjerëve. Njëherë në Stacionin e Trenit në Frankfurt, ndërsa isha vetëm, i hoqa sytë nga çanta ime e dokumenteve (për më pak se një minutë); u zhduk dhe nuk e pashë më kurrë. Fatmirësisht, hajduti nuk mori laptopin tim ose shumë gjëra të çmuara. Sa të mundemi, t'i mbajmë gjërat e çmuara me vete. Pse të mos mbajmë një rrip parash ose një çantë beli? Më vjen keq të them se në gjithë këtë, jeta është më e vështirë për gratë se për burrat dhe ua lë grave të shkruajnë rreth kësaj. Të sigurohemi që të kemi fotokopje të kartave të kreditit, pasaportave, etj.
10. Meqenëse, herët a vonë, të gjithë harrojmë të marrim gjëra të çmuara, duhet të zhvillojmë një strategji për të mos e bërë këtë. Për shembull, pasi largohemi nga një dhomë, të kthehemi dhe të kontrollojmë sërish nëse kemi harruar gjë pa marrë. Të kontrollojmë veçanërisht të gjitha prizat elektrike për të parë nëse kemi lënë një telefon ose karikues në prizë. Në gjithë këtë, sa më shumë të jemi dyshe, sesa vetëm, aq më mirë. Të mësojmë të kontrollojmë për njëri-tjetrin dhe të mësojmë nga njëri-tjetri. Le të vdesë krenaria dhe të ecim në përlulësi, gati për të rrëfyer shpejt dobësinë.
11. Të kemi një sistem të mirë kopjesh për të gjitha adresat, numrat e telefonit, etj. Të kemi një sistem për të arkivuar gjërat. Dosjet e mia në laptopin tim janë tani pjesë kyçe e jetës sime. Çfarë mjeti fantastik për t'u përdorur në punën e Perëndisë! Unë kam një bllok të vogël kopjesh të numrave të telefonit dhe nuk jua merr mendja sa shumë përdoret. Nëse i duam vërtet njerëzit dhe duam t'i nxisim, do ta bëjmë edhe një milje tjetër për të ruajtur të dhënat e tyre bazë. TË ORGANIZOHEMI, TË ORGANIZOHEMI, TË

ORGANIZOHEMI! Libri i Gordon Mekdonëlld (MacDonald) “Ordering Your Private World” (Thomas Nelson, 2012) ka ndihmuar shumë njerëz. Nëse lexoni gjerësisht, do të gjeni lloj-lloj këshillash praktike rreth pothuajse çdo aspekti të jetës dhe është gabim i madh në vetvete të mos mësojmë prej tij.

12. Të mësojmë nga ai që unë e quaj “Paralajmërimi i Frymës së Shenjtë”. Ishte dikur një misionar i mrekullueshëm që kishte dalë për të ecur në kodrat e Anglisë, por nuk kishte veshur llojin e duhur të këpucëve. Eci shumë afër cepit të një shkëmbi, rrëshqiti dhe ra drejt vdekjes së tij. Nuk do ta harroj kurrë kur më telefonuan ditën tjetër dhe më njoftuan vdekjen e këtij shoku të dashur. Gruaja e një shoku tjetër misionar rrëshqiti në një kodër afër një shkëmbi dhe ra për vdekje. Po të ndaja ca qindra histori të ngjashme që kam dëgjuar, do ta kuptonit më mirë pse po kaloj kohë për të shkruar këtë libër dhe veçanërisht këtë kapitull. Nuk kam dyshim se nëqoftëse njerëzit i vënë veshin asaj që po shkruaj këtu, do t’u shpëtojë jetën dhe më pëlqen shumë ta bëj këtë.

Me siguri ju mund t’i shtoni gjëra të tjera kësaj liste ose të bëni një listë tuajën, por nuk duhet të marr më shumë hapësirë këtu. Mund të mendoni se ky udhëzues “si të bëni gjëra të ndryshme” nuk është i rëndësishëm në krahasim me të gjitha mesazhet shpirtërore rreth jetës si Krishti ose dishepullimit, por ajo lloj ndarjeje e së ashtuquajturës shpirtërore nga praktikja është gabim i madh në të menduarit tonë. Ne duhet t’i mbledhim të gjitha bashkë nën fuqinë dhe drejtimin e Frymës së Shenjtë. Ne jemi krijuar në shëmbëlltyrën e Perëndisë. Ne kemi vullnet të lirë dhe, në nivel njerëzor, ne do ta vendosim vetë fatin tonë. Ne e vendosim çdo të bëjmë çdo orë të secilës ditë, ku do të shkojmë dhe si do të sillemi. Ne duhet të rritemi dhe të piquemi në çdo fushë të jetës. Edhe në moshën time ka mësim për të mësuar.

Çdo realitet dhe mësim i madh biblik duhet të rimësohet në faza të ndryshme të jetës sonë. Nuk duhet vetëm të jetojmë mirë, por edhe të mësojmë e të jemi gati për të vdekur mirë. Ndërsa plakemi, duhet të kemi kujdes nga SBP-ja. Dikush më pyeti para ca kohësh ç’kuptim kishte. I thashë: “Epo, do të thotë Sindromi i Budallallëkut të Pleqërisë.” Problemi është se tani është përhapur në çdo grupmoshë në kulturën tonë.

E mbyll këtë kapitull me këto fjalë fantastike nga Jakobi 1:22: “Dhe bëhuni bërës të fjalës dhe jo vetëm dëgjues, që gënjejnë vetveten.” Veproni siç thotë ai. Ju rekomandoj një studim të mirë të librit të Jakobit.

KAPITULLI 9

DREJTUESIT QË PËRDOR PERËNDIA

Po e shkruaj këtë kapitull në një vend shumë të veçantë në bregdetin perëndimor të Uellsit, të quajtur Huksiz (Hookses), ku një nga drejtuesit më të mëdhenj të shekullit të njëzetë hodhi në letër shumë nga shkrimet e tij. E kam fjalën për Dr. Xhon Stot (John Stott), i cili u bë mik i ngushtë dhe librat e të cilit kanë ndikim global edhe sot. Shpresoj të lexoni shumë prej tyre. Është e trishtueshme që veçanërisht në ShBA, për disa njerëz, nëse përmend emrin e Xhonit të thonë se mohoi egzistencën e ferrit dhe veçanërisht të dënimit të përjetshëm, gjë që nuk është fare e vërtetë. Ai besonte se njerëzit jashtë Krishtit janë të humbur. Fola me të personalisht rreth kësaj. Në njërin prej librave të tij, shkruajtur posaçërisht për t'iu përgjigjur pyetjeve të vështira që disa teologë liberalë bënë, ai preku mundësinë e njëfarë lloji asgjësimi dhe ne folëm personalisht edhe rreth kësaj. Shumë burra të shquar dhe gra të shquara janë munduar fort me përshkrimin e saktë të ferrit. Mbjaj mend që Billi Graham ka thënë se ishte kryesisht ndarje prej Perëndisë.

Që prej ardhjes sime në besim, jam përpjekur çdo ditë që ta jetoj gjithë jetën time në dritën e kësaj të vërtete që nuk e kuptoj plotësisht. Jam ndihmuar nga meditari rreth drejtësisë së Perëndisë. Universalizmi është më popullor se kurrë ndonjëherë, por Xhon Stot nuk iu fut asaj rruge dhe jam i sigurt se kjo është njëra prej arsyeve pse ishte i përkushtuar ndaj misioneve botërore. E dëgjova të thoshte në një mesazh fantastik rreth misionit se njëra prej

betejave më të mëdha të Kishës në ditët tona ishte ekskluziviteti i ungjillit. Jezusi thotë: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta. Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje” (Gjoni 14:6).

Kjo më çon tek synimi kryesor i këtij kapitulli. Është një lutje për të kuptuar më mirë gamën e gjerë të njerëzve që Perëndia përdor në udhëheqësi, qofshin burra apo gra. A mund ta përfytyroni numrin e drejtuesve që kam takuar dhe në kishat e kujt kam folur? Shtojini kësaj gjithë llojet e ndryshme të drejtuesve që kam njohur në agjenci misioni dhe organizata të tjera. Po, bëhen mijëra dhe, po, kam dëgjuar mijëra mesazhe, shumë prej të cilëve në kaseta ose forma të tjera audio. Përveç kësaj, kam lexuar rreth të gjithë drejtuesve kryesorë të përmendur në Bibël.

Që prej fillimit të kohës, kemi një gamë të gjerë librash rreth udhëheqësisë, si dhe autobiografi dhe biografi të burrave dhe grave të Perëndisë. Shumë prej tyre i kam lexuar dhe recensionuar, ndërsa ato që u kam hedhur një sy janë edhe më të shumta. Tani po na vijnë më shpejt se kurrë ndonjëherë dhe një prej pjesëve më të rëndësishme të shërbesës sime është të folurit me drejtues si dhe shpërndarja e materialeve të jashtëzakonshme rreth udhëheqjes. Dy librat kryesorë për momentin janë “Spiritual Leadership” (Moody, 2007) nga J Ozuëlld Sendërz (J. Oswald Sanders) i cili është në shumë gjuhë dhe “Leading with Love” nga Aleks Strauç (Alex Strauch). I kam shprehur fort disa prej pikëpamjeve të mia në libërthin tim “Grace Awakened Leadership”, i cili në fakt përbëhet nga dy kapituj prej librit tim “Out of the Comfort Zone”.

Përsëri, nëse nuk përqaftoni atë që e quaj rrëmujiologji, ndoshta nuk do të bini dakord me atë që përpiqem të ndaj këtu. Jam i bindur fort se Perëndia punon fuqishëm nëpërmjet një game të gjerë drejtuesish të ndryshëm dhe stileve të ndryshme të udhëheqjes.

Disa libra dhe mësues kanë ideale shumë të larta për udhëheqësinë dhe disa janë aq dogmatikë saqë stilet e ndryshme, të ndryshme nga stili i parashtruar në librat e tyre, dënohen ose përçmohen. Përpiqem t’i paralajmëroj njerëzit rreth këtij idealizmi shkatërrues i cili e

përjashton faktorin e hirit radikal dhe përfundimisht i bën njerëzit të shkurajuar, të pështjelluar ose madje plotësisht të eliminuar.

Historia provon të kundërtën. Lloj-lloj drejtuesish dhe skuadrash drejtuese janë përdorur fuqishëm për të bekuar, dishepullizuar dhe mësuar popullin e Tij si dhe për të sjellë dhjetëra miliona te Zoti Jezus anëmbanë globit. Ne jemi shpërndarës kyçë të librit “Learning to Lead” (Authentic India, 2010) nga Çua Ui Hian (Chua Wee Hian), por për dekada me radhë kemi parë gjithashtu sesi ai drejtoi një kishë kyçe që e kishte themeluar në Londër pasi kishte qenë drejtuesi ndërkombëtar i tërë Lëvizjes IFES. Bashkojani librit “Servant Leadership for Slow Learners” (Paternoster, 2002) nga Dejvid Landi (David Lundy) dhe do të keni një kombinim të pashoq. Kam vënë re se shumë udhëheqës që në fakt kanë arritur majat nuk kanë ndjekur këtë stil. Ata shpesh kanë qenë më autokratikë dhe zakonisht akuzohen, të paktën disa, si diktatorialë ose edhe abuzues. Kam lexuar një libër rreth udhëheqjes abuzive në të cilin, me sa mund të kuptoja, pothuajse çdo drejtues dinamik që përpiqet t’i bindë njerëzit me njëfarë pasioni dhe emocioni për t’i shërbyer Jezusit dhe për ta dashur me gjithë zemrën, mendjen, frymën dhe forcën e tyre, do të konsiderohet abuziv. Disa njerëz, kur vendosen nën atë lloj presioni, nuk duan ta pranojnë mesazhin e fortë e më pas, në disa raste, përpiqen të gjejnë disa dobësi te personi që po jep mesazhin. Për të qenë të sinqertë, ka shumë vargje biblike të cilat, kur i lexojmë me zë të lartë, duken abuzive. Provoni “Unë i njoh veprat e tua, që ti nuk je as i ftohtë as i ngrohtë. Do të doja të ishe i ftohtë ose i ngrohtë! Por, mbasi je kështu i vakët, dhe as i ftohtë e as i ngrohtë, unë do të të vjell nga goja ime” (Zbu. 3:15-16). Pastaj provoni Lukën 14:33: “Kështu, pra, secili nga ju që nuk heq dorë nga të gjitha ato që ka, nuk mund të jetë dishepulli im.”

Na duhet vërtet shumë urtësi për përdorimin e fjalës së rëndë “abuzive”. Mbjaj mend një grua në njërën nga skuadrat e mia vite më parë e cila për mendimin tim po martohej shumë shpejt; kur u

përpoqa ta ngadalësoj pak, m'u kthye e më akuzoi se isha i fiksuar për kontroll. Pas asaj bisede lënduese, i qëndrova pranë dhe madje mora pjesë në ceremoninë dhe dasmën e saj; brenda dy vjetësh, martesës i erdhi fundi.

Një gjë e sigurt që dua të them, pas gjashtëdhjetë viteve në njëfarë lloji udhëheqjeje, është se në më të mirën e saj, udhëheqja është shumë e vështirë. Të gjithë ne drejtuesit jemi të papërsosur dhe kemi dobësitë tona që nganjëherë çojnë në mëkat të dukshëm. Të gjithë njerëzit që ne përpiqemi të drejtojmë dhe ndihmojmë kanë gjithashtu dobësi që nganjëherë çojnë në mëkat, dhe cili është rezultati? Shpesh një rrëmujë e madhe! Njerëz të lënduar, zemra të thyera dhe zhgënjime. Shumë nga ata që vendosen nën drejtimin tonë sot janë lënduar tashmë aq shumë, nganjëherë edhe abuzuar seksualisht, saqë është tejet e vështirë t'i drejtosh dhe ndihmosh. Shumica e drejtuesve janë të zënë dhe të mbipërkushtuar, shpesh për shkak se po përpiqen të duan dhe t'i shërbejnë Jezusit dhe popullit të Tij. Shtojni kësaj përpjekjen për të ungjillëzuar e për të patur shumë miq jo të krishterë, dhe po sheh të pamundurën. Punët do të shkojnë keq. Njerëzit do të lëndohen. Kjo është arsyeja pse për mendimin tim, pa realitetin e fortë të I Korintasve 13 që rrjedh në zemrat tona dhe përlësinë dhe thyerjen që e shoqëron, shpesh bëhet e pamundur ecja përpara. Kam parë dhe lexuar për qindra drejtues që janë prishur me njëri-tjetrin. Kam parë një zëvendësdrejtues që përpiqet të bëjë puç ose të rrëzojë të ashtuquajturin numër një. Kur përfshihet bashkëshortja ose bashkëshorti, bëhet edhe më e çuditshme.

Duhet një nivel i lartë i realitetit shpirtëror nga drejtues me mendje të fortë për të punuar bashkë. Disa libra mbi udhëheqësinë lënë jashtë mesazhin e Kryqit dhe jetës së kryëzuar:

“Unë u kryqëzova bashkë me Krishtin, dhe nuk rroj më unë, por Krishti rron në mua; dhe ajo jetë

*që tani jetoj në mish, e jetoj në besimin e Birit të
Perëndisë, që më deshi dhe dha veten për mua.”*

(Galatasve 2:20)

Dëgjova dikë të thoshte se arsyeja për rritjen e shpejtë të Kishës ishin gjithë ato ndarje të Kishës. Ideja se Perëndia nuk mund të punojë kur ka mëkat në kamp duket e mirë dhe disa mund të mendojnë se kanë një histori të Dhjatës së Vjetër që e mbështet këtë. Këtu kemi vetëm një problem madhor! Thjesht nuk është e vërtetë. 2,000 vitet e historisë së Kishës tregojnë se Perëndia po bën gjëra të mëdha dhe po shpëton shumë njerëz në mes të situatave mëkatore e të rrëmujshme.

Le të ruhem nga të qenët tepër mendjengushtë përsa u përket ndjenjave tona rreth mënyrës sesi Perëndia punon përmes njerëzve. Mund të kemi bindjet tona rreth mënyrës sesi duhet të drejtojmë, por të jemi të ngadaltë për të kritikuar njerëzit që kanë një stil tjetër. Kisha të ndryshme kanë lloj-lloj formash të udhëheqjes. Po, personalisht besoj se disa janë më të mira se të tjerat, por për ta matur këtë është shumë më e vështirë sesa më dukej dikur. Zor të ketë një kishë, mision a organizatë të krishterë që të mos ketë patur rrëmujat e saj, problemet e saj, patjetër, edhe sjelljet e saj të mëkatshme. Në disa raste marr një vendim të prerë për t'u tërhequr e për të qëndruar larg. **Por, nuk mund t'i them Perëndisë së Gjallë të qëndrojë larg.** Ai do të vazhdojë të na mahnisë me mënyrën sesi ai përdor lloj-lloj drejtuesish në lloj-lloj situatash, përfshirë situata shumë të rrëmujshme. Po, është Rrëmujologji në shkallë të madhe.

Disa që e lexojnë këtë nuk do të binden, por po të mund të ulesha me ju dhe të ndaja ato një mijë e kusur incidente që kam parë dhe lexuar e që më kanë shtyrë drejt kësaj rruge, mendoj se mund të bëheni edhe më të bindur se unë. Nëse jeni shumë të rinj do t'ju duket gjithashtu e vështirë, madje edhe

pësjtjelluese. Megjithatë, ju lutem të mos prisni derisa të plakeni për t'i mësuar këto mësimë të çmuara. Shtini në dorë libra të mirë rreth udhëheqjes tani, duke filluar me vetë Biblën.

KAPITULLI 10

ADHURIMI, ECJA DHE MREKULLIA

Sapo jam kthyer nga ecja dhe adhurimi këtu në Huksiz (Hookses) ku Xhon Stot (John Stott) duhet të ketë ecur dhe parë zogjtë shumë herë. I hodha një sy zyrës dhe shtëpizës së tij ku duhet të ketë kaluar ca kohë fantastike. Shumë prej librave të tij ishin në raftë, përfshirë biografinë e tij dyvolumëshe. Gjeta një libër të ri që nuk e kisha parë më parë, redaktuar nga Kris Rajt (Chris Wright) i cili tani është drejtuesi i “Langham Partnership”, që zotëron këtë vend. Libri quhet “John Stott: A Portrait by His Friends” (IVP, 2011). Ah sikur thjesht të ulesha e ta lexoja të gjithin!

Kam shëtitur në bregdetin e Pembroukshër (Pembrokeshire) shumë herë, veçanërisht me mikun tim shumë të veçantë uellsian Uejn Thomas (Wayne Thomas) të cilin ma prezantoi Dag Bërtën (Doug Burton), themeluesi i “The Haven” jo larg prej këtej në Pembrouke (Pembroke). Uejni ishte larg Perëndisë, shpesh duke jetuar një jetë qejfi me shumë pije dhe gjithçka që e shoqëron. Ai po dorëzonte kekë tek “The Haven” dhe u takua me një ish-dublant nga Shtetet e Bashkuara të quajtur Çak Koks (Chuck Cox), gjë që çoi drejt ardhjes së tij të fuqishme në besim. Dagu i tha të vinte te njëri prej takimeve të mia në Karmarthën (Carmarthen) dhe pas takimit më çoi me makinë në një fermë shumë larg në Kuontoks (Quantocks) jashtë Tontonit (Taunton). Ky është një vend ku unë dhe Drena shkonim shumicën e viteve për një ndryshim rutine dhe një pushim meqenëse administrohej nga Dejve (Dave) dhe Meri

Hothorn (Mary Hawthorne) që ishin bërë miq shumë të ngushtë. Ishte fillimi i një miqësie për gjithë jetën. Shpesh shëtisnim këtyre brigjeve sëbashku. Uejni përfundimisht iu bashkua OM-së, duke punuar me mua, dhe takoi një punonjëse të mrekullueshme të OM-së, Hilarinë (Hilary), me të cilën më vonë u martua. Ata u bënë drejtuesit dhe kujdestarët e Qendrës sonë të Pushimit / Konferencave në Uest Uoç (West Watch), Uest Sasiks (West Sussex). Bashkë me dy vajzat e tyre të rritura, tani ata shërbejnë në bazën tonë në Tajroun, Xhorxha (Tyrone, Georgia), ShBA.

Ecja dhe, për goxha vite, vrapimi kanë qenë pjesë e rëndësishme e jetës sime. Unë shpesh i bashkoj me lavdërimin, lutjen dhe adhurimin. Më duket më e lehtë të adhuroj përjashta në mes të krijimit të Perëndisë sesa në ndonjë lloj ndërtese të mbushur me njerëz, por sigurisht që besoj në të dyja. Të qenët vetëm me Perëndinë ka qenë pjesë madhore e mënyrës sime për t'u marrë me stresin dhe me të gjitha sfidat e udhëheqjes. Më mahnitin veçanërisht uji, kanionet, grykat dhe bregdetet shkëmbore.

Vendet e mia të parapëlqyera që konkurojnë me Alpet Zvicerane (veçanërisht kur i kaloj me tren duke diktuar letra) janë të gjitha parqet kombëtare dhe shtetërore në Jutën e jugut (Utah) dhe Arizonën veriore (Arizona), përfshirë Brajsin (Bryce), Harqet (Arches), Sionin (Zion) dhe Kanionin e Madh (Grand Canyon). Perëndia në mëshirën dhe dashurinë e Tij më ka lejuar t'i vizitoj këto vende shumë herë me shumë njerëz të ndryshëm, përfshirë fëmijët, nipat dhe mbesat.

Tani në fakt jam ulur në buzën e brendshme të një dritareje duke parë bregdetin e bukur me Milford Hejvën (Haven) diku në largësi, ku mbaj mend se “Logos” erdhi për vizitë shumë dekada më parë. Lutja ime është që shumë prej jush do t'i lexojnë “The Logos Story” (Paternoster, 1992) dhe “The Doulos Story” (BookRix, 2014) nga Ellein Rotën (Elaine Rhoton), dhe tani “Logos HOPE” (BookRix, 2014) nga Rodni (Rodney) Hui dhe Xhorxh (George) Simpson. Do të mahniteni sesi Perëndia e ka

përdorur këtë shërbesë me anije. Kush e di, mund të përfundoni duke shërbyer në një anije të OM-së një ditë.

Mendja më shkon përsëri te shërbesa ime dhe e Xhon Stotit sëbashku në “Logos II” në Londër. Ai dhe unë ishim shumë të ndryshëm dhe kur më dëgjoji për herë të parë të flisja tek “Urbana” në fundin e viteve '60 u mërziu goxha nga mungesa e përmbajtjes biblike në mesazhin tim (ishte kryesisht dëshmia ime) dhe kur u përball me mua rreth kësaj, unë nisa të qaj. Nga ta dija unë se ky do të ishte fillimi i një miqësie për gjithë jetën. Sa më shumë që flisnim ose shërbenim bashkë, aq më shumë kuptonim sa shumë të përbashkëta kishim dhe ai u bë mbështetës i madh i OM-së. Çfarë gëzimi ishte kur së fundmi predikova tek “All Souls Church” ku ai ishte drejtues dhe rektor për shumë vjet.

E shkruaj gjithë këtë për t'i nxitur njerëzit që të gjejnë ekuilibër në jetët e tyre. Shpresoj të keni lexuar rreth kësaj në disa prej librave të mi të tjerë, por nuk mund ta mbitheksoj rëndësinë e saj, veçanërisht gjetjen e balancës së duhur mes aspektit të punës dhe shërbesës që ju duket goxha shteruese dhe shërbesës dhe veprimtarisë që ju duket sikur ju rimbush vërtet.

Edhe në studimin tuaj biblik është jetësore që ta lejoni një varg të fortë të Shkrimit që të vijë në perspektivën e tij të vërtetë nga pjesë të tjera të Shkrimit. Nxjerrja e vargjeve jashtë kontekstit, veçanërisht nga Dhjata e Vjetër, dhe goditja e njerëzve në tokë me to nuk është mënyra e duhur. Vazhdoj të çuditem nga keqpërdorimi i Shkrimit, veçanërisht i Dhjatës së Vjetër. Ne sigurisht marrim vargjet që na pëlqejnë dhe lëmë pa përmendur ato që nuk na pëlqejnë ose nuk i kuptojmë. Më thyhet zemra kur shoh shumë miq dhe besimtarë të futen në ekstreme dhe tangjente të ndryshme. Njerëzit kapen me këndvështrime të ndryshme ekstreme, shpesh të qarkulluara nga lloj-lloj mesazhesh elektronike ekstreme e të njëanshme që rrallë japin tablonë e plotë dhe të dyja anët e historisë.

Kur takoj njerëz të tillë, shpesh duken shumë negativë dhe madje të hidhëruar dhe të zemëruar. Të folurit me njerëz të tillë

më bën të mendoj se leximi përzgjedhës (leximi i vetëm njëres anë të çështjeve) duket më i keq se mosleximi fare. Gjithkush që ka njëfarë shkollimi dhe përvoje e di se nuk mund të besosh gjithçka që lexon; madje edhe librat, revistat dhe gazetat e krishtera e teprojnë ose e kanë gabim nganjëherë. Edhe disa gazeta kryesore mbizotërohen nga vetëm një pikëpamje. Egzistojnë kulte dhe grupe ekstremiste të pafundme që propagandojnë atë “gjënë” e tyre mbi gjithë botën. Nganjëherë ka ndjesa, por aq shpesh me shkronja të vogla saqë shumica e njerëzve nuk i marrin vesh. Disa mesazhe dhe blogje të nxehta elektronike kanë rezultuar plotësisht të rreme. Lloj-lloj teorish kompletesh fluturojnë andej-këndej, disa të vjetra sa malet, disa të reja fare. Shëndeti, feja dhe politika janë fusha të mëdha përgjithësimesh, gjysëm të vërtetash, reagimesh të tepruara dhe gjërash të pakuptimta pa fund. Kur njerëzit janë të kyçur brenda një partie të caktuar politike (jo domosdoshmërisht gabim), ata nganjëherë e kanë të pamundur të shohin disa gjëra pozitive që partitë e tjera mund të jenë duke thënë ose bërë. Shpesh shoh mungesë të madhe gjykimi të shëndoshë dhe balance tek ajo që njerëzit thonë; këtu përfshihen shpesh edhe shumë predikime që kam dëgjuar.

Shpesh njerëzit nuk janë në gjendje të kuptojnë sesa ndikojnë temperamentit dhe lëndimet e tyre tek ajo që ata besojnë dhe thonë. Sigurisht, ata që mendojnë bardhë e zi janë veçanërisht të cënueshëm në këtë botë me aq shumë gri. Si besimtarë të përkushtuar në Jezusin dhe Fjalën e Tij kemi çështje bazë ku ndiejmë se është qartësisht bardhë e zi. Ka fusha ku të menduarit bardhë e zi nevojitet. “Nuk do të vrasësh” (Eksodi 20:13) është një shembull, dhe prapëseprapë, ka të krishterë që nuk bien dakord, veçanërisht rreth armëve dhe luftës. Kam mërëzitur shumë njerëz të cilët, pasi kanë parashtruar mendimin e tyre fantastik rreth diçkaje, kanë marrë përgjigjen time për atë çështje të ndërlikuar. Fakti që kam kaluar shtatëdhjetë vjet duke lexuar, studiuar dhe shërbyer në pothuajse njëqind kombe, nuk duket se ka shumë vlerë. Gjëja

që është vërtet e frikshme është se kur disa njerëz vazhdojnë të ndjekin një rrugë ekstreme, duket se bëhen nevrastenikë (nëse nuk janë tashmë) dhe sa e trishtueshme bëhet e gjitha.

Kam frikë se brenda Kishës po i japim jetë një lloji krejt të ri farisenjsh, gjë që sjell gjithashtu ndarje, pështjellim dhe në fund shkurajim dhe humbje besimi. Kjo ndodh edhe brenda familjeve. A nuk është e mundur që ne, me bindjet tona të forta, të jemi të përlulur dhe të kuptojmë se mund ta kemi gabim? A nuk mund të lexojmë më shumë anë të një çështjeje? (Eh, punë e vështirë në botën tonë të korsisë së shpejtë “dërgo një mesazh”). A nuk duhet të mësojmë nga studiuesit dhe veçanërisht nga burrat e perëndishëm dhe gratë e perëndishme ndërsa shkruajnë dhe ndajnë rreth pothuajse çdo teme në botë? Përgjithësimet rreth muslimanëve (dhe shumë njerëzve të tjerë), të cilat shpesh përfshijnë paragjykimin dhe gjuhën e urrejtjes, duhet të jenë shqetësim për të gjithë ne. Disa libra po e mbajnë zjarrin ndezur dhe lloj-lloj njerëzish tani pretendojnë se dinë shumë për islamin. Mund ta kem gabim, por shoh shumë krenari, padurim dhe arrogancë dhe shumë pak nga Jezusi, shumë pak përlulësi dhe thyerje.

Ky është nganjëherë gur i madh pengese për ata që po përpiqen t'i arrijnë këta popuj të ndryshëm me ungjillin. Kur takojmë dikë me të cilin nuk biem dakord, le të themi rreth një çështjeje politike ose doktrinale, a na intereson më shumë që t'i ndryshojmë këndvështrimin apo që t'a shohim duke ardhur tek Jezusi? Ose, si besimtar, t'i zgjasim dashurinë dhe miqësinë tonë, si dhe të dëgjojmë historinë e tij/saj? Një arsye pse disa njerëz kanë pak miq është sepse nuk i duan vërtet njerëzit ose nuk i dëgjojnë. Ata thjesht vazhdojnë në atë botën e tyre të vogël, duke përcmuar ata që nuk bien dakord me ta. Mendoj se e dini se kjo është arsyeja pse e shkruajta “The Revolution of Love” pesëdhjetë vjet më parë, përveç librave të mi të tjerë, si dhe arsyeja pse vazhdojmë ta rekomandojmë “The Calvary Road” nga Roi Hesiën (Roy Hession) pesëdhjetegjashtë vjet më vonë. Kjo është gjithashtu arsyeja pse

“The Grace Awakening” nga Çarlz Suindoll (Charles Swindoll) u bë një prej librave më të rëndësishëm në jetën e shumë prej nesh. Fjala që mungon tek shumë njerëz sot është **pendimi**, i cili përfshin kthime 180 gradë dhe ndryshim.

Unë besoj se DVD-të rreth transformimit mund të ndërtojnë besim, por edhe pritshmëri jobiblike dhe jorealiste. Në të vërtetë, ky nuk është një mendim i ri. Teologjia e mbizotërimit e çon në ekstrem dhe besoj se është bërë e pabesueshme. Historia tregon se është shumë e vështirë të transformohen kombe të tëra apo edhe qytete të tëra. Një qytet ose fshat i vogël është synim më i lehtë, por edhe atje e liga do të jetë përreth dhe shpesh transformimi i jashtëm do t'i shtyjë njerëzit drejt konformizmit, krishtëritimit nominal dhe hipokrizisë me tonelata. Historia e Kishës ka qenë një lëndë e parapëlqyer imja për pesëdhjetegjashtë vjet dhe e mbështet atë që po përpiqem të them. Ndikimi i “Maximum Salt and Light” tek unë është histori tjetër dhe ndihmon vërtet nëse e fusim në teologjinë tonë të transformimit. Prirja e karizmatikëve dhe ungjillorëve për ta tepruar është epidemi që i bën dëm punës së Perëndisë. Sigurisht, teologjia ime e rrëmujologjisë më ndihmon të qëndroj pozitiv në mes të saj. Ideja ose teoria se Evropa u bë aq e madhe për shkak se ishte e ashtuquajtur e krishterë është plot me boshllëqe, por sigurisht që ka disa elementë të mëdhenj të së vërtetës. Nëse duam transformim, vëmendja jonë maksimale duhet të jetë tek jeta jonë, pastaj përreth nesh e pastaj te Kisha. Pas kësaj, Perëndia do të punojë në shumë mënyra të ndryshme dhe djalli do të jetë dy herë më aktiv.

Kam lexuar shumë tregime për ringjallje të mëdha të cilat japin ëndrra transformimi. Ato sigurisht patën ndikim në shoqëri, por janë shpesh të tepruara dhe nuk japin tablonë e plotë. Dëshira jonë e madhe për thjeshtësi në mes të ndërlikimit thjesht çon në më shumë pështjellim.

Në mes të rrëmujes që shohim përreth, edhe te Kisha dhe organizatat e krishtera, si të vazhdojmë dhe të qëndrojmë të nxitur

dhe pozitivë? Ka sigurisht libra të tërë dhe predikime që i përgjigjen kësaj, por për mendimin tim duhet të përfshihet rrëmujojlogjia, që është një këndvështrim tjetër i mënyrës sesi Perëndia punon mes popullit të Tij. Ishte e vështirë për mua si drejtues i krishterë ta pranoja se kisha një këndvështrim të gabuar rreth Perëndisë dhe mënyrës sesi Ai punon mes popullit të Tij. Po për ju?

KAPITULLI 11

NËSE NUK DËSHIRON TË LËNDOHESH, MOS LUAJ RAGBI

Njëherë po haja drekë me Pol Dendou (Paul Dando), një pastor në Uells. Ai drejton një kishë në Narbërth (Narberth) ku kam folur shumë herë. Mbjaj mend që kam qenë atje me nipin tim Çarli (Charlie) i cili më ndihmoi me tryezën libërmbajtëse. Çarli nuk e kishte bërë këtë më parë dhe u çudit që nuk mund t'i mbanim të gjitha paratë që njerëzit dhanë.

Poli ndau historinë e mëposhtme në një restorant të vogël në Litëll Hejvën (Little Haven). Ishte një takim drejtuesish dhe disa prej drejtuesve kishin shumë dhembje nga vështirësitë dhe njerëzit në kishat e tyre. Pak para se një folës më i vjetër vizitues nga Afrika e Jugut të kishte radhën për të ndarë fjalën kryesore, një prej tyre drejtoi në lutje dhe u lut posaçërisht për ata që ishin në dhembje. Fjalia e parë e mesazhit të këtij drejtuesi të stazhionuar ishte: “Nëse nuk dëshiron të lëndohesh, mos luaj ragbi.” O sa e vërtetë!

Anëmbanë botës u kam thënë njerëzve, veçanërisht drejtuesve, “nëse nuk dëshiroheni të lëndoheni, jeni në planetin e gabuar”. Kështu është ky planet i rënë dhe kryengritës dhe ne duhet të mësojmë të këmbëngulim në mes të tij. Edhe në kishat më të mira fare, me gjithë natyrën tonë njerëzore, do të bëhen gabime. Njerëzit do të mëkatojnë dhe dështojnë, njerëzit do të kenë nevojë për ndihmë. Nuk bëhet më e lehtë kur e mendojmë Satanin si luan vrumbullues që kërkon kë mund të gllabërojë. “Jini të përmbajtur, rrini zgjuar, sepse kundërshtari juaj, djalli, sillet

rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë” (1 e Pjetrit 5:8).

Jam ndihmuar dhe frymëzuar shumë nga aq shumë burra dhe gra, të cilët nëpër çdo lloj lëndimi dhe vështirësie kanë ushtruar falje dhe kanë vazhduar përpara. Në të njëjtën kohë, nëse ne që jemi në udhëheqje do ta jetojmë realitetin e banimit të Frymës së Shenjtë brenda nesh, besoj se do të lëndojmë vetëm një numër të vogël njerëzish. Jam përpjekur shpesh të zbuloj nëse diçka që kam thënë ose bërë ka lënduar dikë dhe pastaj i kam lënë mënjanë ato që po bëja për të kërkuar ndjesë dhe falje. Duhet të pyesim veten sa shpesh themi nga zemra: “Më vjen keq. Të lutem më fal.” A nuk duhet të jetë kjo themelore në zemrat tona dhe fjalorin tonë?

Keqkuptimet janë të zakonshme në jetën e këtij planeti (nuk flas dot për planetet e tjera); kam parë mijëra prej tyre, të mëdha e të vogla. Thashethemet shkatërruese shpesh dalin jo për shkak të ndonjë mëkati të prerë, por për shkak të ndonjë lloj keqkomunikimi ose keqkuptimi. Gjatë gjithë jetës sonë si të martuar, Drena dhe unë kemi vuajtur në këtë fushë. Shumicën e herëve bëhet fjalë për një çështje shumë të vogël, por armiku përpiket ta përdorë për të sjellë pështjellim, lëndim dhe dhembje. Ne duhet të mësojmë sesi ta kundërshtojmë me dëgjim më të mirë dhe përpjekje më të mëdha për ta kuptuar personin që flet ose atë për të cilin po flitet.

Sfida për të besuar më të mirën dhe parimi laik i pafajësisë së një personi derisa të provohet fajësia janë shumë të rëndësishme. Më është thyer zemra kur kam parë njerëz duke i flakur këto parime nga dritarja dhe duke vazhduar me forcën e tyre.

Dua të sjell këtu përgjërimitim tim që t'i bëjmë lutjen, takimet ose koncertet e lutjes (sido që t'i quani) pjesë qendrore të jetës dhe shërbesës suaj. Një ndër gjërat më të rëndësishme që kam mësuar si i krishterë i ri ishte sesi të lutesha dhe gjithashtu si t'i bëja takimet e lutjes përparësi kryesore, gjë që e kam mbajtur gjatë gjithë jetës, me hirin e Tij. Egzistojnë me qindra libra rreth lutjes dhe nuk dua të përsëris atë që kanë thënë të tjerët, por

dua t'i kujtoj lexuesve të mi se jeta pa lutje do t'u hapë derën pengesave, problemeve dhe lëndimeve. Do të nxitesha shumë po të merrja vesh se njerëzit i kanë lexuar dy kapitujt e mi rreth kësaj të “Drops from a Leaking Tap” dhe po i vënë në zbatim.

Kjo më shtyn të ndaj një prej aspekteve më të rëndësishme të ecjes sonë me Perëndinë, sfidën për të mos i mbajtur lëndimet ose ndonjë gjë tjetër kundër askujt. Përmes hirit të Tij, nuk kam rënë kurrë të fle me ndonjë gjë kundër njerëzve ndërkohë që jam lënduar dhe zhgënjyer nga njerëzit qindra herë. Për mua nuk është zgjedhje. Duhet të falim dhe madje të punojmë për të harruar. Vargjet rreth dashurisë ndaj armiqve e bëjnë edhe më të gabuar dhe të pakuptimtë mbajtjen e ndonjë gjëje kundër ndokujt. Përpjekja për “t'u larë” ose çfarëdolloj hakmarrjeje nuk ka vend të dishepulli i Zotit të dashur e të Gjallë. Kjo nuk do të thotë se do të ketë gjithmonë bashkësi fantastike ndërsa punojmë bashkë. Ky është shpesh një hap më i ndërlikuar dhe nuk është gjithmonë i mundur. Ndërsa bëhemi më të pjekur në besimin tonë, gjë që ishte e vështirë për mua, mësojmë të vazhdojmë përpara me marrëdhënie komplekse ende të pazgjidhura. Si mund të ecin dy njerëz bashkë nëse nuk janë dakord? Ky është nivel tjetër nga dashuria, respekti dhe falja bazë. Duhet t'i kujtojmë vetes shpesh se ka vetëm një Trup. Po, ne të gjithë përbëjmë Trupin e Krishtit.

Si mund të mendojmë ne se do të ungjillëzojmë botën dhe të mbjellim kisha mes të gjithë njerëzve pa çdo lloj problemi dhe sprove që mendja mund t'i përfytyrojë se janë të pranishme, përfshirë edhe humbjen e jetës së disave për shkakun e Krishtit? Martirët që kemi patur në lëvizjen tonë kanë patur ndikim të madh te shumica prej nesh dhe na kanë ndihmuar që të përcaktojmë përparësitë tona për LAVDINË E TIJ. Do t'i nxitja njerëzit të lexonin “Total Abandon” (Tyndale House, 2005), shkruajtur pas martirizimit të gruas së tij në Liban. Bashkë me të, ju lutem përpikuni të lexoni librin “Total Forgiveness” (Hodder & Stoughton, 2010) nga R.T. Kendall. Me siguri, shërbimi në ushtrinë e madhe globale të Perëndisë do të

jetë më i vështirë se ragbi. Kujtoni 2 Timoteut 2:3: “Ti, pra, duro pjesën tënde të vuajtjeve, si një ushtar i mirë i Jezu Krishtit.” Në fakt, jeni që jeni, lexojeni të gjithë kapitullin.

KAPITULLI 12

QARAVITËSIT, ANKUESIT, BLOKUESIT DHE ATA QË MENDOJNË NEGATIVISHT

Uau, a flet titulli i këtij kapitulli për ju? Shpresoj që jo – është rrugë vërtet vdekjeprurëse dhe shumë po ecin në të. Mendoj se kisha ca nga këto kur isha besimtar i ri e madje edhe më vonë si bashkëshort, baba dhe drejtues i krishterë. Në tërësi, dukem optimist në shumë mënyra, por kam edhe një dell shumë negativ. Bëhet edhe më e ndërlikuar ndërsa duket sikur Perëndia përdor disa prej deklaratave të mia negative, veçanërisht rreth gjendjes së Kishës e madje edhe rreth të krishterëve të zakonshëm.

Më kujtohet një rast në veçanti kur na u desh ta mësonim me dhembje se **dishepullimi radikal pa hirin radikal është shpesh rrugë e dhembshme, pështjelluese e pa krye**, megjithatë Perëndia bëri gjëra të mëdha mes ekstremizmit tonë, dobësive dhe dështimeve tona. Në fundin e viteve '50 dhe '60, ishim në autostradën e dishepullimit radikal dhe po vinim në zbatim atë që Dejvid Pilet kishte shkruajtur tek “Radical”.

Më kujtohet mirë kur isha në Pakistan pak pasi kishte nisur puna atje rreth dyzet vjet më parë. U hap një derë për një takim kyç në një katedrale në një qytet kryesor. Do të vinin drejtues kyçë kishash, përfshirë Peshkopin e Kishës së Pakistanit. Unë isha folësi kryesor dhe mbaj mend se një drejtues kyç i OM-së po më kërkonte të kisha kujdes me atë që do të thoja ndërsa

predikojta. Ma merr mendja se e dinte se nganjëherë thosha gjëra fyese e madje proçka kur predikojta! Më duket se i thashë se do të përpiqesha në maksimum. Pastaj, dikush tjetër më pyeti nëse mund të vishesha hijshëm. Kostumet dhe kollaret vlerësoheshin shumë asokohe në Kishën e Pakistanit e madje edhe sot. Nuk shquhesha si person që vishej hijshëm, por, e besoni apo jo, ditën tjetër isha atje me kostum dhe kollare. Mendoj se dukesha si varrmihës. Kjo ndodhi të ishte një kohë në jetën time kur isha i vendosur për të qenë më pak negativ, edhe në situata të errëta e të vështira. Perëndia deshi të më jepte një krizë në jetën time sepse, ndërsa po flisja, një pëllumb fluturoi sipër meje dhe e lëshoi “dhuratën” e tij mbi mëngën e xhaketës sime. Çfarë sikleti para Peshkopit dhe të gjithë atyre njerëzve, shumë prej të cilëve po më dëgjonin për herë të parë! Por Perëndia po bënte një gjë të re dhe unë thjesht thashë: “Lavdi Zotit që nuk fluturojnë elefantë këtu.” Sigurisht që qeshën me të madhe.

Po, mund të jeni në një situatë të keqe, por pse të mos falënderoni dhe lavdëroni Perëndinë? Jam i sigurt se mund të ishte shumë më keq. Kjo nuk do të thotë se duhet të lavdëroni me gojë Zotin kur dikush po ju zbraz një situatë të dhembshme e të vështirë. Në atë çast ju duhet të mbani mend vargun: “Gëzohuni me ata që gëzojnë dhe qani me ata që qajnë” (Rom. 12:15). Në të njëjtën kohë mund të gëzojmë në zemrat tona duke e ditur se Perëndia mund të nxjerrë diçka të bukur nga një situatë e tmerrshme. Po lexoj librin e Hena Majlli (Hanna Miley), ish OM-iste, rreth jetës së saj si fëmijë që erdhi në Angli me trenat e famshëm që sillnin fëmijë nga Gjermania para Holokaustit. Libri titullohet “A Garland from Ashes” (Outskirts, 2013) dhe është historia e pajtimit me ata që u morën jetën prindërve të saj dhe shumë të tjerëve në kampet e përqendrimit të Gjermanisë gjatë asaj lufte të tmerrshme. Ka shumë libra të tjerë të ngjashëm që ne duhet të lejojmë të përdoren nga Perëndia për të ndryshuar jetët tona.

Pse aq shumë njerëz të fortë që besojnë tek Bibla (unë njëri prej tyre) janë kaq të shpejtë për të kritikuar, shpeshherë madje para se të kenë faktet? Pse qaraviten aq shumë të krishterë për aq shumë gjëra, veçanërisht për qeveritë e tyre? Çfarë bëjmë ne me Filipianëve 4:4-7?

Gëzohuni gjithnjë në Zotin; Po jua them përsëri: Gëzohuni! Zemërbutësia juaj le të njihet nga të gjithë njerëzit; Zoti është afër. Mos u shqetësoni për asgjë, por, në çdo gjë, ia parashtroni kërkesat tuaja Perëndisë me anë lutjesh dhe përgjërimesh, me falenderim. Dhe paqja e Perëndisë, që ia tejkalon çdo zgjuarsie, do të ruajë zemrat tuaja dhe mendjet tuaja në Krishtin Jezus.

Perëndia nuk dëshiron që ne të jemi njerëz qaravitës, ankues, negativë dhe jofalenderues. Ju lutem të ndaloni për një moment dhe të lejoni që Fryma e Shenjtë të bëjë një punë të re në zemrën dhe jetën tuaj. Kam folur për këtë tashmë në kapitullin 2, “Fikëset e zjarrit, librat dhe Fjalët e urta”, por dëshiroj të rinxjerr në pah sesi kjo ka lidhje të fortë me të qenët kryesisht person negativ ose ndoshta edhe person zemërak. Ishte e vështirë si besimtar i ri që të kuptoja se kisha një dell armiqësie. Njëherë e vura re këtë dell armiqësie të shfaqej ndërsa flisja dhe u pendova menjëherë. Shfaqej veçanërisht ndërsa ngjisja makinën. Zbulova se ishte më mirë kur udhëtoja me tren.

Kudo që jeton sot, gjen njerëz rreth vetes që qaraviten dhe ankohen gjithë kohën. Çfarë arritjesh sjell kjo në fakt? Për mendimin tim, ndryshon shumë nga kritikata ndërtuese. Kam lexuar një libër, “The Tough Minded Optimist” (Touchstone, 2003) nga Dr. Norman Vinsent Piëll (Vincent Peale), si dhe libra të tjerë të ngjashëm, të cilët më kanë ndihmuar të ndryshoj mënyrën time të të menduarit.

A kaloni shumë kohë me këta lloj njerëzish? Të jeni të sigurt se do të bëheni si ai/ajo; është ngjitëse! Njerëzit që gjithmonë shohin anën e errët janë shpesh shumë krenarë, në fakt, njerëz që në dukje i dinë të gjitha; prapëseprapë, ajo krenari shpesh ka lidhje me pasigurinë, gjë që e kthen në kombinim shumë të rrezikshëm. Një ditë shkruajta një listë gjërash për të cilat kam dëgjuar të krishterët të qaravitën ose ankohen:

Oh, muzika është tepër e lartë.

Oh, po përdorin versionin e gabuar të Biblës.

Oh, si mund të vishen ashtu në kishë?

Oh, pastori predikoi tepër gjatë.

Oh, pyes veten pse vishet aq hijshëm gruaja e tij dhe si e kalon kohën vallë?

Oh, Selli është aq e shëndoshë dhe Lilit s'i mbyllet goja.

Oh, Semi vazhdon të harrojë të hedhë deodorant.

Oh, a e vure re makinën e re të shtrenjtë që sapo ka marrë pastori?

Oh, pashë njërin prej pleqve në një klub para ca ditësh.

Obobo, kishin verë të kuqe në gotën e Darkës së Zotit.

Oh, pashë se djali i pastorit po pinte birra.

Në ditët e mia të hershme, mbaj mend se të krishterët mërziteshin kur gratë lyenin buzët ose burrat mbanin flokë të gjatë. Lista vazhdon e vazhdon. Kur mendojmë dhe sillemi në këtë mënyrë, ç'gjë me vlerë të përjetshme arrijmë? A nuk e kuptojmë rëndësinë e prirjes dhe qëndrimit tonë? Edhe një herë, i nxis njerëzit të lexojnë “The Grace Awakening” nga Çarlz Suindoll i cili është në shumë gjuhë tani. Unë po lexoj një libër të ri rreth hirit të titulluar “Pharisectomy: How to Joyfully Remove Your Inner Pharisee and Other Religiously Transmitted Diseases” (Influence Resources, 2012) nga Piter Has (Peter Haas), dhe

besoj se mund ta merrni me mend për çfarë bën fjalë. Duhet të kemi parasysh se Perëndisë nuk i intereson vetëm ajo që bëjmë dhe themi, por ajo që mendojmë. Qëndrimi është pjesë kryesore e ecjes sonë me Jezusin.

Në pothuajse çdo situatë, dhe në çdo person, ka gjëra pozitive dhe të mira dhe duhet të fokusohemi tek ato shumë më shumë se tek negativet. Gjithashtu duhet të kemi parasysh vargjet “Mos gjykoni, që të mos gjykoheni. Sepse ju do të gjykoheni sipas gjykimit me të cilin gjykoni; dhe me masën me të cilën ju masni, do t’ju masin të tjerët” (Mat. 7:1-2).

Gjithashtu, si ju duket ky rregull i mrekullueshëm: “Gjithçka, pra, që ju dëshironi t’ju bëjnë njerëzit, ua bëni edhe ju atyre” (Mat. 7:12). Po, e di se i jemi kthyer mesazhit të libri im “The Revolution of Love” dhe shpresoj ta përfaqësoj me gjithë zemrën tuaj dhe veprimet tuaja. Ka theks të stërmadh në Bibël. Si mund ta humbasim? Lexoni Thesalonikasve 5:16 dhe mësoni të “gëzoheni gjithmonë”.

Kur vjen puna te të qenët pozitivë, zor të mundet Filipianëve 4:8:

Së fundmi, vëllezër, të gjitha gjërat që janë të vërteta, të gjitha gjërat që janë të ndershme, të gjitha gjërat që janë të drejta, të gjitha gjërat që janë të pastra, të gjitha gjërat që janë të dashura, të gjitha gjërat që janë me famë të mirë, nëse ka ndonjë virtyt dhe nëse ka ndonjë lëvdim, këto mendoni.

Një mik në botën e arsimit më shpjegoi çfarë ishte një “bllokues”, meqenëse ishte fjalë e re për mua. Është një person që mendon se gjithçka është shkëlqyeshëm, veçanërisht te puna dhe mësimdhënia e tij, dhe bllokon çdo përpjekje për ndryshim. Nëse duam të rritemi e të bëhemi njerëzit që Perëndia dëshiron që të jemi, duhet të vazhdojmë të mësojmë dhe të vazhdojmë të ndryshojmë.

Ankesat dhe kritikrat e bashkëshortes ose bashkëshortit janë shpesh rruga drejt një marrëdhënieje të prishur. Me hirin e Perëndisë, rrallë e kam kritikuar gruan në publik dhe jo aq shumë privatisht, por më është dashur të pendohem për shprehje të tërthorta dhe nganjëherë humor që mund të kenë mbjellë një ide të gabuar për gruan time te njerëzit që e kanë dëgjuar ose lexuar ç'kam thënë. Më kujtohet që një herë në një mesazh i kushtova më shumë se disa fjali lavdërimit të gruas time dhe pastaj u kritikova edhe për këtë! E keni vënë re se jeta nganjëherë është plot me situata nga ku nuk del dot fitues? Uau, delli negativ e nxorri kokën përsëri. Oh, Zoti pastë mëshirë për të gjithë ne.

KAPITULLI 13

SHPALLJA ME SHQETËSIM DHE VEPRIM SHOQËROR

A mund të vijë ndryshimi më i madh në jetën dhe teologjinë e dikujt pasi mbush gjashtëdhjetë vjeç? Po, më ndodhi mua dhe lëvizjes që ndihmova të themelohej, “Operation Mobilisation”. Ka vetëm një kapitull rreth kësaj të “Drops from a Leaking Tap” dhe kanë kaluar rreth dymbëdhjetë vjet qëkur ndryshimet e mëdha ndodhën.

Duhet të kthehemi te Xhon Stot, Billi Graham dhe Kongresi Botëror për Ungjillëzimin (World Congress on Evangelism) i vitit 1974 në Lozanë (Lausanne) të Zvicrës, ku u mbledhën dy mijë drejtues të krishterë që përfaqësonin botën. Kisha një seminar të vogël me temë “Literatura dhe Ungjillëzimi” dhe mendoj se i humba disa prej mesazheve kryesore. U bë një debat i madh në lidhje me faktin se veprimi shoqëror dhe shpallja duhet të qëndronin sëbashku dhe si përfundim i famshmi “Dokumenti i Lozanës” deklaroi se ato duhet të bashkëqëndronin. Shumë artikuj dhe libra dolën pro dhe kundër këtij vendimi, por ky kongres, si dhe shumë libra nga njerëz të tjerë apo lëvizje, ndryshuan rrjedhën e historisë. Kini parasysh se disa kisha dhe misionarë tashmë kishin ecur goxha përpara në bashkëshoqërimin e këtyre dy aspekteve të shërbesës. Uau, shikoni Gjeneral Buthin (General Booth) dhe “Salvation Army”. Ka sigurisht disa mësimë për të nxjerrë nga kjo, jo të gjitha pozitive.

Vite para kësaj, “Operation Mercy” ishte themeluar nën Bertil Enkvist (Engqvist), drejtues kryesor në OM nga Suedia. Mbjaj

mend se dhashë miratimin për këtë, veçanërisht me shpresën se shumica e fondeve do të vinin nga Suedia.

Afganistani ishte një ndër kombet kyçë në vizionin tonë që nga fillimi dhe kjo lloj shërbese ishte mënyra e vetme për të funksionuar në atë komb dhe mes refugjatëve në anën tjetër të kufirit në Pakistan, ku Gordon Megni (Magney), themeluesi i punës sonë atje, tashmë i varrosur në Kabul, vazhdonte shërbesën bashkë me gruan e tij Grejs (Grace). Ata kishin një shërbesë fantastike duke u kujdesur për të gjitha llojet e nevojave fizike dhe duke u përpjekur për të sjellë ungjillin në të njëjtën kohë. Nuk ishte detyrë e lehtë.

Xhozef D'Soza (Joseph D'Souza), drejtuesi i shërbesës në Indi, ishte një prej udhëçelësve të gjithë lëvizjes për të sjellë këtë ndryshim të madh. Shërbesa "The Good Shepherd", me klinika dhe shkolla në lagje të varfra, ishte historike në lëvizjen tonë dhe tani ka mëse 110 shkolla shumë më të mëdha anembanë kombit, veçanërisht për fëmijët dalitë, të cilëve shpesh u mohohet arsimimi i duhur. Sikurse e kam përmendur më parë, mbi 250 milionë njerëz në Indi konsiderohen të paprekshëm. Sot quhen shpesh dalitë. Shumë besojnë se është një formë skllavërie. Nuk po flasim për njerëz të kastës së ulët (qindra milionë a më shumë), por për të dëbuarit. Interesimi ynë për këta njerëz ndihmoi në ndryshimin e rrjedhës së historisë sonë. Nuk duhej të ishte kështu në të ashtuquajturën demokraci më të madhe të botës, por kështu është, dhe në mënyrën misterioze të të punuarit të Perëndisë, në njërin prej situatave më të rrëmujshme të botës, qindra mijëra prej këtyre njerëzve po vijnë te Jezusi.

Kam shkruajtur një artikull që do të doja ta ndaja këtu:

Çfarë do të thonë fëmijët e fëmijëve tanë?

Dy ose tre breza pas heqjes së skllavërisë, fëmijët e fëmijëve të atyre që besuan, praktikuan dhe u përfshinë, pyetën

veten sesi ata mundën të ishin aq të verbër dhe të pamend. (Zgjidhni fjalët tuaja.)

Gjatë ecjes sime stërvitore kam qenë duke dëgjuar librin e Fillip Jensi (Philip Yancey) “What’s So Amazing About Grace”, veçanërisht pjesën rreth veçimit racor. Tani pyesim veten sesi ai brez mundi të ishte aq i verbër, racist (përfshirë ata që e quanin veten të krishterë) dhe shpesh urryes. Neve na duket e pavërtetë.

Brezi i ri në Afrikën e Jugut është i çuditur nga ajo që prindërit e tyre besonin, praktikonin (lavdi Zotit për çdo përjashtim) dhe bënë në ato ditë, gjë që njihet si aparteji. Kur shohin filma ose lexojnë historinë, u duket e vështirë ta besojnë dhe shpesh ndjehen në turp. Sigurisht që kishte një mbetje që e mbronte skllavërinë dhe ndarjen dhe ka akoma që e mbrojnë. Aktualisht, në ca pjesë të Evropës ka një lloj ringjalljeje të atij lloji ekstremizmi dhe racizmi. Në fakt Lëvizja Neonaziste është akoma gjallë, veçanërisht në ShBA.

Ja pyetja ime e madhe ndaj të gjithë atyre që e lexojnë këtë: Cilat çështje sot i kemi aq gabim saqë brezat e ardhshëm do të mbeten të habitur nga verbëria, paragjykimi, përtacia dhe mendjetrashësia jonë sot? Uau, tani një gisht më drejtohet mua.

Besoj se është “PAPREKSHMËRIA” ajo që ka krijuar një grup njerëzish që po jetojnë në një formë skllavërie dhe aparteji me një superndarje. Ndërsa vazhdon, ajo ndikon jetët e 200 milionë njerëzve sot, kryesisht në Indi, por edhe në kombe të tjera.

Ku qëndroni ju në këtë çështje? Çfarë po bëjmë unë dhe ju për këtë? Unë lexoj gazetatat dhe ndjek lajmet dhe mund të radhitja përmendësh njëqind njerëz të famshëm e të shquar nga çdo fushë e shoqërisë (ku futeni ju?) dhe zor të ketë ndonjë prej tyre që po bën ndonjë gjë për këtë fshikull dhe padrejtësi globale! Le të pyesin çfarë do të thonë fëmijët e

tyre dhe fëmijët e fëmijëve për ta në të ardhmen. Ne të gjithë le të shqyrtojmë zemrat tona.

Unë jetova në Indi dhe nuk arrita ta kuptoj, por falënderoj Perëndinë për ata që më ndihmuan të zgjohem e ta bëj ndryshimin e kësaj situatë një prej synimeve kryesore të jetës sime.

Hapi tjetër për disa prej jush mund të jetë leximi i librit të Xhozef D'Sozës "Dalit Freedom: Now and Forever" (Dalit Freedom Network, 2005). Jemi të gatshëm t'ia dërgojmë si dhuratë çdokujt që më dërgon adresën. Adresa ime e e-mailit është george.verwer@om.org. Ju lutemi të na dërgoni adresën tuaj kur ta kërkonti këtë libër.

Një nxënës që akoma po mëson rreth Drejtësisë dhe Hirit, si dhe një Shërbëtor i Perëndisë së Gjallë,

Xhorxh Veruer

Në vitin 1998, në konferencën tonë vjetore të drejtuesve kryesorë në Afrikën e Jugut, unë shpalla se besoja se brenda pesë vjetësh duhet të largohesha nga Udhëheqësia Ndërkombëtare e OM-së. Kjo ndodhi në verën e vitit 2003 dhe Piter Meidën, i zgjedhur nga Lëvizja (proces goxha i gjatë me disa tronditje), mori drejtimin për dhjetë vitet e ardhshme. Tani drejtues është Lorenc (Lawrence) Tong me bazë në Singapor, nga ku është.

Ndërsa po largohesha nga drejtimi, disa menduan: VERUERI, ZOTI SHPALLJE, UNGJILLËZIM, NUK DO TË NDRYSHOJË KURRË. U çuditën si asnjëherë më parë ndërsa Perëndia më trazoi për të përqaftuar këtë teologji shërbese. E pashë qartë në Bibël dhe në histori. Kjo ka ndryshuar mënyrën sesi mendoj, flas dhe jetoj. Ka ndryshuar veçanërisht mënyrën sesi i përdor kohën dhe paratë. Qindra herë kam predikuar mesazhe të ngjashme me kapitullin rreth kësaj te "Drops from a Leaking Tap".

Në Shërbesën tonë të Projektit të Veçantë, të cilën Piter Meidën dhe drejtuesit e OM-së ndjenë se duhej ta mbaja dhe udhëhiqja

si pjesë e OM-së, nisëm të përfshiheshim në më shumë projekte të lidhura me lloj-lloj shqetësimesh shoqërore nëpër botë, që nga Kriza e SIDA-s, e deri te problemi i ujit të papastër në botë, si dhe te çdo betejë e mundshme që lidhet me varfërinë. Ndërsa ecja në rrugën e shqetësimit për të drejtat e njeriut, kuptova se kjo duhet të përfshinte edhe të drejtat e të palindurve. Në bashkëpunim me Patrik Diksonin (Patrick Dixon), bëmë të vërshojnë nja dyqind mijë kopje të librit “AIDS Action” (Bookprint Creative, 2010) në shumë gjuhë. Me Rendi Ellkornin, nisëm të shpërndanim gjithashtu dhjetëra mijëra “Why Pro-Life?: Caring for the Unborn and Their Mothers” (Hendrickson, 2012) në shumë gjuhë. Në disa gjuhë, ky ishte libri i parë rreth kësaj teme që ishte shtypur ndonjëherë. Përndia hapi dyert për ta ndarë këtë mesazh, edhe në televizion e radio, anëmbanë botës dhe përmes faqes sime në internet **www.georgeverwer.com** si dhe faqeve të tjera; mesazhi u përhap gjithandej.

Nuk ka hapësirë të mjaftueshme në këtë libër për t’u futur në hollësitë e sfidave dhe ndryshimeve me të cilat u përballëm të gjithë në lëvizje ndërsa kjo ndodhi. Nuk ka qenë martesë e lehtë, por martesa sigurisht nuk është kurrë e lehtë. Disa ndjenë se ungjillëzimi bazë po shtyhej mënjane dhe projektet e veprimit dhe të ndihmave po e mbizotëronin plotësisht lëvizjen.

U bënë debate dhe u shkruan letra. E gjithë puna dukej sikur po bëhej më e ndërlikuar dhe e rrëmujshme. Trysnia për të ngritur fonde për lloj-lloj nevojash dhe krizash dukej shumë e lartë. Ndërsa kthej kokën pas, mahnitem vazhdimisht nga sigurimi i fondeve për një shërbesë kaq të madhe si përgjigje ndaj lutjeve. Nuk jam i sigurt nëse ndokush e di sesa më i madh është buxheti vjetor tani në krahasim me atë që disa e quajnë “kohët e vjetra”. Është dyfishuar disa herë. Ndiej se akoma kemi një balancë të mirë me çdo lloj ungjillëzimi. Kjo përfshin akoma arritjen e miliona njerëzve me ungjillin, gjë që është ende në zemër të lëvizjes dhe në timen gjithashtu. Librat dhe autovizualet që dalin nga OM-ja e tregojnë

qartë këtë. Për shembull, në rastin e shërbesës sime dhe Projekteve të Veçanta unë flas për të gjitha këto gjëra, por meqenëse shuma ime e parave është sasi e vogël në krahasim me të ardhurat totale të OM-së, mendoj se shumica prej tyre duhet të përdoren për aspekte të shërbesës që lidhen me ungjillëzimin dhe kishëmbjelljen.

Jam nxitur veçanërisht nga shërbesa me anije dhe mënyra sesi arrijta e njerëzve me ungjillin është akoma përparësi kaq kryesore, sidomos duke përdorur literaturën. Mëse 40 milionë njerëz janë ngjitur shkallëve të anijeve dhe dhjetëra miliona janë arritur me ungjillëzimet në breg dhe shërbesat e kishave.

Çfarë më shtyu në këtë drejtim? Së pari ishte studimi i thellë i Shkrimit, edhe i Dhjatës së Vjetër edhe i së Resë. E kuptova se gjithmonë e kisha besuar deri në njëfarë pike, por ndieja se grupe të tjera si “Tearfund”, “World Relief” dhe “World Vision” duhet të merreshin me këtë aspekt të punëve. Burra të Perëndisë si Xhon Stot, në karrigen e të cilit jam ulur këtu në këtë kasolle të qendrës së veçantë çlodhëse në Huksiz, dhe të tjerë me mendje të ngjashme patën një ndikim të madh. Edhe disa me të cilët nuk isha dakord më shtynë që të shqyrtoja zemrën time dhe të isha gati për ndryshim rrënjësor.

Po, OM-ja është bërë më e ndërlikuar dhe disave nuk u pëlqen e na kanë braktisur, por të tjerë po ngrihen, veçanërisht nga brezi më i ri, për ta çuar punën përpara. Një prej gjërave më nxitëse në lëvizje është ushtria e drejtuesve më të rinj (nga pothuajse njëqind kombësi) që Perëndia ka ngritur për ta çuar vizionin dhe punën përpara.

Jetët tona, Drena, unë dhe stafi ynë i vogël janë bërë gjithashtu më të ndërlikuara. Mesa duket kemi më pak kohë për të bërë gjëra që i bënim dikur, si shikimi i një filmi në aeroplan. Në ekranin e laptopit tim kam me qindra mesazhe elektronike, kështu që i jap përparësi kësaj. Kemi zbuluar një sërë minash dhe pengesash ndërsa ndjekim këtë rrugë, por në fund i jemi dorëzuar Perëndisë si gjithmonë. Kemi parë përgjigje të mrekullueshme ndaj lutjeve,

dhe falë disa librave fantastikë dimë më shumë sesi t'i trajtojmë lutjet e papërgjigjura. Pit (Pete) Greig, themeluesi i "24:7 Prayer Movement", ka shkruajtur një libër të titulluar "God on Mute" (Regal, 2007); kopertina e tij ballore më ka shërbyer shumë, ashtu si edhe libri i Fillip Jensi "Disappointment with God" (Zondervan, 2009) dhe ai i Ron Dan (Dunn) "When Heaven is Silent" (Paternoster, 1994).

KAPITULLI 14

NJË BARRË DHE VIZION QË NUK KANË NDRYSHUAR KURRË

Që para ardhjes sime në besim kisha dashuri për Biblën. Por marrja e ungjillit me postë verën e vitit 1953, bashkë me dëgjimin e mesazhit të Billi Graham më 3 mars 1955, e ndryshuan plotësisht rrjedhën e jetës sime.

Përpara kësaj kisha ndjekur Klubin e Biblës te “Ramsey High School” disa herë, dhe kjo mund të jetë arsyeja pse më dërguan një kopje të Ungjillit të Gjonit bashkë me letrën në faqen pasardhëse ...

Kampi “Word of Life”
Schroon Lake, New York
15 korrik 1953

I dashur anëtar i Klubit të Biblës!

Kjo verë ka kohë që ka nisur tani dhe shpresoj që po e shijoni shumë. Pavarësisht nëse po punoni ose po pushoni, ma merr mendja se keni pak kohë të lirë. Si president i Klubit të Biblës, kam dashur gjithmonë që secili anëtar të lexojë të paktën një pjesë të Biblës. Gjatë vitit shkollor koha jonë është goxha e zënë me ngarkesën shkollore, po tani që keni pak kohë, do të doja t’ju ftoja të lexoni një pjesë të Fjalës së Perëndisë që gjendet brenda, Ungjillin e Gjonit.

Ka disa arsye, që do t' i shpreh shkurtimisht, pse do të doja që ta lexonit. Së pari, Bibla vetë ju thotë të "shqyrtoni shkrimet" te Gjoni 5:39. Ky është njëri nga urdhërat e Perëndisë të cilit duhet t' i bindemi. Gjithashtu, në Bibël ka shumë histori interesante për mrekulli dhe përvoja emocionuese, të cilat janë të gjitha të vërteta, sikurse shkruhet te Gjoni 17:17: "Fjala Jote është e vërtetë". Përveç kësaj, Bibla ka qenë burim fantastik gëzimi dhe bekimi për shumë njerëz, përfshirë mua. Vetëm në këtë libër gjejmë udhëzimet e Perëndisë për ne dhe jetët tona.

Koha e shpenzuar duke lexuar këtë libër të shkurtër do të ishte shumë e dobishme dhe frymëzuese. Në këtë pjesë të shkurtër janë përfshirë shumica e të vërtetave bazë të Biblës dhe mënyra për të gjetur gëzimin, paqen dhe suksesin e vërtetë.

Kjo verë do të ketë atë vlerë që kanë edhe gjërat që bëni gjatë saj. Leximi i kësaj pjese të shkurtër të Fjalës së Perëndisë do të jetë shumë i dobishëm dhe lutem që të jetë burimi i gëzimit dhe bekimit. Nëse keni pyetje ose probleme me të cilat mund t' ju ndihmoj, ju lutem të më vini në dijeni. Do t' ju ndihmoja me shumë kënaqësi.

Perëndia ju bekoftë në udhën e Tij.

Përshëndetje të përzemërta,
Daniel Klep (Daniel Clapp)

Që përpara se të merrja këtë letër, isha bërë pjesë e "Pocket Testament League" dhe mbaja një Dhjatë të Re në xhepin tim. Në një prej prezantimeve të tyre kisha parë predikimin e tyre të ungjillit

dhe shpërndarjen e Ungjijve të Gjonit. Kësisoj, fara e dëshirës që të gjithë të kishin Fjalën e Perëndisë ishte mbjellë në zemrën time.

Shumica e njerëzve e dinë se unë jam përfshirë në shumë aspekte të punës së Perëndisë dhe e dinë gjithashtu sa shumë i çmoj të gjitha agjencitë dhe kishat që janë pjesë e forcës së madhe globale të Perëndisë. Ajo që ndaj tani me ju vjen nga zemra ime me shumë mendime nga një jetë në shërbesë.

Gjatë udhëtimit tim të fundit në Indi, ndërsa intervistova shumë njerëz, bëra ca detyra shtëpie dhe kuptova se pavarësisht lloj-lloj shërbesash fantastike, përfshirë ungjillëzimin e masave, radion, televizionin, shfaqjet e filmave, literaturën, etj, ka akoma shumë qindra miliona njerëz që KURRË NUK E KANË DËGJUAR OSE LEXUAR UNGJILLIN (përfshirë shikimin e një filmi të ungjillit). Po ashtu, shumë grupe i janë futur një shërbese tërësore, si shkollat që kemi mes dalitëve e që përfshijnë një sasi të madhe kohe dhe parash. Është bërë ungjillëzim dhe kishëmbjellje e jashtëzakonshme krah për krah dhe ne falënderojmë Perëndinë për rezultatet.

Dalitët së shpejti mund të bëhen megagrupi më i arritur në Indi, por në fakt, me një popullsi prej 250 milionësh, ç'përqindje prej tyre arrijmë me të paktën një pjesë të Mesazhit, duke ditur se shumë nuk mund të lexojnë? Thuhet se ka diku te 300 milionë nga "Kasta të Tjera të Ulëta" (KTU, OBC ang.), ndoshta më shumë, dhe pyes veten sa nuk e kanë patur akoma mundësinë për të dëgjuar ose njohur hirin shpëtues të Krishtit? Kjo vjen nga një njeri që beson se një rast për të dëgjuar për Jezusin nuk mjafton.

Ka mëse 170 milionë muslimanë në Indi. Ndoshta po të jemi optimistë, mund të themi se shumë miliona kanë qenë në një shfaqje të një filmi të ungjillit, ose mund të kenë dëgjuar ose parë një program ungjillit në radio ose TV. Po të bëheshin 70 milionë nga këto? Mbeten edhe 100 milionë! A e kuptoni ku dua të dal? Nuk jam i përditësuar për Kinën, por me gjithë atë rritje atje, nuk do ta vinte njeri në dyshim se ka qindra milionë edhe atje që nuk e kanë dëgjuar kurrë lajmin e mirë.

Kohët e fundit kam vënë re hapa të mëdhenj përpara për ta përkthyer Biblën ose pjesë të saj në çdo gjuhë. Disa prej këtyre gjuhëve përfaqësojnë një numër shumë të vogël njerëzish; mirë, besoj në këtë. Është fantastike kur lexoj se miliona dollarë të tjerë po jepen ose premtohen për këtë. Kjo ma bën më të vështirë për ta kuptuar sesi ka qindra milionë (disa do të thonin një miliard) përreth nesh, në gjuhët e të cilëve tashmë kemi përkthyer (Dhjata të Reja, fletushka, DVD, libërtha, disqe, etj) e prapëseprapë, akoma nuk u kemi dhënë gjë atyre. **PËR MUA NUK KA KUPTIM.** A mund të më ndihmojë ndonjëri prej jush që e lexoni këtë?

Shpallja e një grupi ose rrjeti se së shpejti do të sjellim një miliard njerëz të tjerë te Jezusi besoj se është e tepruar, por me rritjen e madhe të Kishës në disa pjesë të botës, ku i dihet! Mendoj se e vërteta është se do të kemi vetëm një ndikim të vogël tek qindra milionët e atyre që janë më kundërshtues ndaj ungjillit ose jetojnë larg zonave ku kjo përgjigje po ndodh. Për shembull, a do të arrihen brahmanët nga dalitët që vijnë në besim?

Kërkesa ime është që të lutemi më shumë për arritjen e këtyre qindra milionëve të paarritur me mesazhin e shpëtimit. A do të luteni për çlirimin e fondeve për këtë lloj shërbese? Përmirësimet me financat do të na mundësojnë t'u japim më shumë vegla ungjillëzuese mijëra punëtorëve që po i kërkojnë. Idealja do të ishte që paraja të mos ishte fokusi kryesor, por kur është gjëja kryesore, sikurse është shpesh në shërbesën time, le ta gjejmë atëherë në një mënyrë a një tjetër! Kjo nuk do të bëhet e mundur nga një agjenci ose kishë, por nga një lëvizje me bazë të gjerë (që tashmë po ndodh) në të cilën njerëzit, qoftë edhe të përfshirë në një shërbesë tjetër, do të duan të arrijnë milionat përreth tyre. Duhet të bëjmë çdo përpjekje që ta mësojmë çdo besimtar në çdo kishë të re se duhet të arrijnë të gjithë të humburit përreth tyre; ky do të ishte një hap gjigant përpara.

Do t'i jap më shumë kohë kësaj në shërbesën time dhe nëse njihni ndokënd, ndokund, që i rreh zemra për këtë gjë, do të më

pëlqente shumë të flisja me të personalisht. Jam mirënjohës që keni lexuar deri tani dhe do të më pëlqente të dëgjoja prej jush.

Para disa vitesh vendosa të bëja një listë të atyre shërbesave që ua kishin dhënë ungjillin të paktën 100 milionë njerëzve. E quajta “Klubi 100 Milionë”. Mund t’jua dërgoj listën nëse dëshironi; përmban rreth pesëdhjetë agjenci dhe shërbesa. Sigurisht që shumë njerëz në disa kombe dhe grupe gjuhësore e dëgjojnë dhe e lexojnë ungjillin shumë herë. Disa kanë një grumbull me ungjij, fletushka dhe libërtha që kanë marrë, por qindra milionë akoma nuk kanë asgjë.

Kemi shumë arsye për të gëzuar, por edhe aq shumë për të bërë.

KAPITULLI 15

KU SHKOJMË PREJ KËTU?

Jam këtu në shtëpinë e bukur të miqve të mi të dashur jashtë njërit prej qyteteve të mia të parapëlqyera, Belfastit në Irlandën e Veriut. Kam qenë këtu rreth njëqind herë, duke numëruar vizitat në pjesë të tjera të Irlandës, dhe është e mahnitshme të shohësh gjithçka që Perëndia ka qenë duke bërë në mes të asaj që besoj se ishte njëra prej rrëmuajave më të mëdha e më të tmerrshme në gjithë Evropën.

Gjithë këto vite kam dëgjuar kritikimin e Kishës për shkak se nuk ka bërë më shumë. Sa e lehtë është të fajësosh kishën! Nëse Kisha ishte aq keq, pse atëherë Perëndia i Gjallë po e përdorte Kishën këtu dhe po shpëtonte aq shumë njerëz në mes të gjithë kësaj? Ky është njëri prej vendeve të para në botë që ma hapi plotësisht derën për të folur në njërin prej ngjarjeve të tij më të mëdha dhe më të rëndësishme për misionin. U bë pjesa më proaktive e MB-së (Mbretërisë së Bashkuar), jo vetëm për OM-në, por për duzina grupesh të tjera misionare. Si mund të përdorte Perëndia ndonjëherë dikë ose madje edhe një kishë që, për shembull, ka një paragjykim të tillë ndaj popullatës katolike? Kjo ndarje e trishtueshme në vend egziston deri më sot dhe mua më duket betejë e madhe ... por Perëndia i Gjallë duket se është në gjendje për ta përballuar. Perëndia i Plotfuqishëm mund të hidhërohet nga njerëzit dhe në të njëjtën kohë t'i bekojë ata. Po, kjo është ajo që e quaj rrëmuajologji.

Ky është kapitulli im i fundit dhe zemrën e shpirtin i kam të mbushura me atë që dua të ndaj. Dua të ndaj vetëm pak rreth

disa çështjeve të tjera për të cilat do t'ju lutesha të mendoheshit. Mund të pyesni veten pse nuk ka më shumë rreth misioneve dhe veçanërisht rreth të paarriturve në këtë libër, por nuk desha të përsëris atë për të cilën kam shkruajtur në librat e mi të tjerë. Po ndërtoj mbi atë që kam ndarë në ato libra, me shpresën se do të ketë gjithsesi kuptim për ata që nuk i kanë lexuar ato. Për mëse dhjetë vjet, historia zyrtare e OM-së, e titulluar “Spiritual Revolution”, nga Ian Rendëll (Randall) ka qenë e disponueshme, dhe shpreh aq shumë atë që unë besoj dhe sesi Perëndia ka punuar në jetën time dhe tek OM-ja. Do t'i nxitja njerëzit ta lexonin atë libër me kujdes meqenëse ka aq shumë për të mësuar rreth mënyrës sesi Perëndia përdor të gjithë llojet e njerëzve në aq shumë mënyra të mahnitshme. Ka gjithashtu goxha libra rreth shërbesës me anije, përfshirë libra të pashoq si “Psalms from the Sea” (Amazon, 2012) nga Debi Merof (Debbie Meroff).

Dua të bëj një lutje të fundit që të shqyrtoni mundësinë për t'u bërë misionar/e karriere. Disave nuk u pëlqen fjala misionar, kështu që pse të mos themi “ambasador me kohë të plotë i Krishtit tek kombet”? Ky është vendimi që unë dhe Drena morëm që para se të takoheshim dhe tani kthejmë kokën pas dhe kujtojmë pesëdhjetepesë vite pune dhe shërbese sëbashku. Edhe në të shtatëdhjetat, Drena është misionare me kohë të plotë, duke punuar me orar shumë të zgjatur çdo ditë pas skenës. Kemi patur shumë ndryshime, por nuk besojmë në lënien e shërbimit tonë ndaj MBRETIT për të dalë në pension. Që tani e kam një strategji sesi të mund të qëndroj në krevat me telefonin tim Bлекberi (BlackBerry) dhe ta vazhdoj një pjesë të mirë të punës sime.

Sa e trishtueshme që aq shumë kisha tani e kanë flakur Veprat 13 dhe nuk dërgojnë më misionarë karriere afatgjatë nga kisha e tyre. Këtu përfshihen edhe kisha të mira që unë i vlerësoj shumë. Jam shumë i vetëdijshëm rreth disa historive negative të qarkulluara rreth misionarëve (disa prej të cilave të vërteta), të cilat i bëjnë edhe drejtuesit e njohur të krishterë të zhvillojnë idetë e tyre të

gabuar. Një prej librave më zemërthyes të shkruajtur nga një burrë që e dua fort e që është përdorur nga Perëndia na bën thirrje të mos dërgojmë misionarë ndërkulturorë, veçanërisht amerikanë. I bie që unë dhe Drena nuk duhet të kishim shkuar kurrë në Indi? A kanë njerëzit ndonjëfarë ideje sa MILIONA e miliona njerëz kanë ardhur te Krishti dhe akoma po vijnë te Krishti për shkak se kemi dërguar misionarë? Disa prej atyre vendeve nuk kanë më nevojë për aq shumë misionarë, por ka kombe të tjera, të paktën dyzet, që kanë dëshpërimisht nevojë për misionarë afatgjatë që duhet të mësojnë gjuhën. Besoj edhe te çadërbërësit që kanë punë, por shpesh, me sa kam vëzhguar, puna e tyre është rraskapitëse (veçanërisht nëse kanë familje) kështu që mbetet pak kohë për të ndarë ungjillin dhe për të mbjellë një kishë. Gëzohemi për çdo rast përjashtimor.

OM-ja është konsideruar si njëra nga organizatat kryesore që i kanë dhënë jetë misioneve afatshkurtra, por ky nuk ishte mendimi im fillestar. Ne, që nga dita e parë, po kërkonim për misionarë GJITHËJETËS.

Në Meksikë e dalluam menjëherë, madje shumë më tepër vëzhguam në Evropë, se në ç'mënyrë të mrekullueshme mund t'i përdorte Perëndia misionet afatshkurtra, të cilat pastaj u bënë fenomen global duke sjellë dhjetëra mijëra në Mbretëri. E vërtetë që përgjatë rrugës ka pasur shumë gabime dhe një rrëmujë të madhe.

Në gjithë këtë mësuam se shumë shpesh financat ishin më të vështira për t'u gjetur sesa njerëzit. Pamë përgjigje fantastike ndaj lutjes në lidhje me fondet dhe OM-ja konsiderohej pjesë e "Lëvizjes së Misionit të Besimit" (Faith Mission Movement), udhën e të cilit e hapën pa e ditur njerëz si Hadsën Tejllër (Hudson Taylor), C. T. Stad (Studd) e shumë të tjerë. Xhorxh Myller (George Mueller), i cili nuk kërkoi haptazi para, e çoi përpara gjithë punën e tij, kryesisht mes jetimëve, me besim dhe lutje. Ai konsiderohej gjithashtu njëri prej themeluesve të "Lëvizjes së Vëllezërve" (njërës prej lëvizjeve më të mëdha e më të rrëmujshme në histori) e cila, edhe gjatë jetës së tij, u bë shumë e rrëmujshme

ndërsa i prishi marrëdhëniet me njërin prej themeluesve të tjerë, J. N. Derbi (Darby).

Studimi im personal tregon se Xhorxh Myller ishte në fakt, sipas kulturës së kohës së tij, ngritës i mrekullueshëm fondesh dhe unë vendosa të ndjek shembullin e tij. Lutja dhe gjetja e financave për OM-në dhe shërbesa të tjera ka qenë njëra prej pjesëve më emocionuese dhe motivuese të jetës sime. Mund të shkruaja një libër për të, por po lutem që gjëra edhe më të mira të vijjnë. Dhjata e Re e tregon qartë se bashkë me lutjen, na duhet niveli më i lartë i komunikimit, sinqeritetit, ndershmërisë dhe integritetit. I kemi përmendur tashmë disa libra rreth kësaj teme, por libri më i fundit për të më ndihmuar titullohet “Gospel Patrons” (Reclaimed Publishing, 2014) nga Xhon Rajnhart (John Rinehart). Ai ndan atë që ka kuptuar se njerëzit e biznesit që kanë dhuntinë dhe aftësinë për të bërë para kanë qenë shumë shpesh pjesë vërtet jetësore e asaj që Perëndia ka bërë përmes njerëzve të tjerë të vajosur e të talentuar.

Nëse mesazhi i misterit, mëshirës, Rrëmuajologjisë (dhe hirit) nuk është shfaqur në këtë libër, atëherë kam dështuar. Disa prej jush që po e lexoni këtë nuk e keni marrë akoma dhuratën e shpëtimit të Perëndisë duke besuar se Zoti Jezus vdiq për mëkatet tuaja. JU duhet ta bëni këtë tani.

Të tjerë që e kanë patur këtë përvojë lindjeje të re dhe hiri nuk e kanë falur veten. Kjo sjell keqfunktionim dhe ndërlirim të vazhdueshëm në jetët dhe shërbesat e tyre. E kemi parë me siguri se Perëndia jo vetëm që punon në situata të rrëmuajshme që duhet ta hidhërojnë në të njëjtën kohë, por mund të punojë edhe në njerëz të rrëmuajshëm. AI DËSHIRON T’JU PËRDORË, pavarësisht sa beteja dhe dështime keni patur në jetën tuaj. Ndoshta, për shkak të mëkatit dhe marrëzisë, po ecni duke çaluar, por gjëja kryesore është se po ecni akoma. Ai mund të dojë që madje të ecni në ndonjë pjesë tjetër të botës ku nuk e kishit pritur kurrë. A do të luteni për këtë të paktën?

Njerëz të tjerë që po e lexojnë këtë nuk i kanë falur të tjerët në të vërtetë, veçanërisht ata që i kanë lënduar, zhgënjyer apo edhe tradhtuar ata. Ndoshta i kanë falur në mendje, por jo në realitetin praktik. Mund të jetë betejë e vazhdueshme, por ai hap duhet hedhur.

Nëse Perëndia ju ka folur përmes asaj që kam ndarë, do të doja që të shqyrtonit disa hapa të tjerë praktikë për ta çuar mesazhin nga koka, poshtë në zemër dhe te këmbët:

1. Merrni vendimin që të jeni më pozitivë dhe optimistë, si dhe nisni të praktikoni duke ndarë disa nga mënyrat e mrekullueshme përmes të cilave Perëndia po punon aty ku jeni dhe nëpër botë.
2. Përfshihuni në të paktën një grup lutjeje të çfarëdoshëm i cili përqendrohet te kombet dhe popujt më të paarritur. Shpresoj të jeni përfshirë në takimin e lutjes së kishës suaj lokale, por shpresoj që të përfshiheni në të paktën një tjetër. Uau, ndoshta mund ta nisni një vetë?!
3. Përfshihuni në shpërndarjen e librave dhe DVD-ve (ose në ndarjen e uebsajteve) që ju kanë ndihmuar dhe ndani gjithashtu pjesë të Shkrimit dhe DVD të krishtera me ata që njihni ose takoni e që nuk e njohin Zotin.
4. Shkoni në një mision afatshkurtër sa më shpejt të mundeni. Përpiquni t'i jepni përparësi një shërbese ku do të ndani ungjillin dhe do të përfshiheni me njerëz. Përpiquni të punoni mes të varfërve dhe të jetoni në një situatë ku do të tendoseni.
5. Përpiquni të dilni jashtë të zakonshmes suaj për ta takuar njerëz afër jush që janë nga kultura të tjera. Nisni të mësoni të paktën një gjuhë tjetër. Nëse e keni studiuar tashmë një

gjuhë (unë madje e nisa spanjishten në shkollë të mesme), merrni vendimin që të vazhdoni për t'u bërë të rrjedhshëm. Sa më shpejt, futuni mes njerëzve që e kanë gjuhë të parë. Zgjidhni qëllimisht rrugën që duket më e vështirë.

6. Mësoni dhe praktikoni përdorimin e kohës suaj në mënyrë më të frytshme. Motoja juaj duhet të jetë “shiko më pak, vepro më shumë”. Ruhuni nga kurthi i televizorit, kurthi i lojërave, dhe nga kurthi i bisedave të pafundme rreth vogëlsirave. Sigurisht, ka vend për të gjitha këto dhe shumë të tjera (po, edhe për gjëra gallatë), por duhet të marrin vetëm një sasi të vogël të kohës suaj. Nëse keni fëmijë ose fëmijë të fëmijëve, kjo kohë duhet të shtohet sigurisht. Gjithashtu, me miqtë që nuk janë besimtarë duhet të mos dukemi si të fiksuar, ekstremë ose të tensionuar. Mbani mend Palin te 1 Korintasve 9:22: “E kam bërë veten time të dobët me të dobëtit, për të fituar të dobëtit; e kam bërë veten time gjithçka për të gjithë, që të mund të shpëtoj me çdo mënyrë disa njerëz.”
7. Mendojeni njëherë vajtjen në kolegji biblik. Kjo mund të bëhet me mësim në distancë ose jashtë klase. Ne kemi një lidhje mbi pesëdhjetet vjeçare me “Capernwray Fellowship”, e cila zhvillon shkolla biblike afatshkurtra në pjesë të ndryshme të botës. Në një mënyrë a një tjetër, ju duhet më shumë kohë në Fjalën e Perëndisë. I nxis njerëzit veçanërisht që të mësojnë përmendësh vargje, gjë që ka ndihmuar për të transformuar jetën time që para se të vija në besim. Po, për të marrë çmimin “God and Country Award” nga bojskautët më është dashur të mësoj vargje nga Shkrimi. Kapitulli ishte Romakëve 8. Uau, para ca ditësh pashë foton kur ma dhanë këtë çmim.
8. Merrni vendimin për të qenë falënderues çdo ditë dhe praktikojeni. A ju ka dhënë ndokush ndonjë gjë së fundmi?

Qoftë edhe një libër, një filxhan çaj ose shoqërim me makinë deri te stacioni? A e keni falënderuar personin? Kam një shok që duket se e tepron me falënderimin e njerëzve. Mendoj se mund të jetë i vetmi. Unë dhuroj shumë libra. Shumica e njerëzve nuk më falënderojnë përveçse, sigurisht, kur ua jap personalisht; edhe atëherë zakonisht del ai falenderimi automatik. Marrja e një letre të çfarëdozshme falenderimi ose e një shënimi të shkurtër do të ishte çudi. E falënderoj Jezusin që më ka falur për rastet kur nuk kam qenë falënderues ose nuk i kam falënderuar njerëzit siç duhet me dashuri.

9. Përpiquni më fort që të flini mirë, të hani ushqimin e duhur dhe të keni një sasi të mirë stërvitjeje. Kjo ka qenë praktika e gjithë jetës sime dhe e rekomandoj vërtet. Njëri prej vargjeve më të fuqishme në Dhjatën e Re për mua është 1 Korintasve 9:24-27:

A nuk e dini se ata që vrapojnë në pistë, vërtet vrapojnë të gjithë, por vetëm një e fiton çmimin? Vraponi në mënyrë që ta merrni. Dhe kushdo që merr pjesë në garë kontrollon veten në të gjitha; dhe ata e bëjnë këtë për të marrë një kurorë që prishet, kurse ne për një kurorë që nuk prishet. Unë, pra, vrapoj, por jo sikur jam i pasigurt; kështu luftoj, por jo sikur rrah erën; madje e mundoj trupin tim dhe e nënshtroj, se mos, pasi t'u kem predikuar të tjerëve, të bëhem për t'u përjashtuar.

10. Merrni një vendim për të mbajtur lidhje me më shumë njerëz, duke e përzier me lutjen ku të mundeni. Përdorni një larmi të mirë metodash, por mbani mend se takimi ballë për ballë për kafe, çaj ose ujë është gjëja më e mirë. Dalja bashkë për të dashur të tjerët, për t'u shërbyer e për t'i arritur mund të jetë edhe më mirë. Më pëlqen shumë posta elektronike dhe

Facebook-u, por kuota e telefonatave ka rënë dhe dëgjimi i zërit të një personi seç ka diçka shumë të veçantë. Uau, lavdi Zotit kemi Skype dhe mënyra të tjera bashkëbisedimi. Kjo duhet të përzihet me falje meqenëse njerëzit mund t'ju zhgënjnë ose mund të ndieni refuzim në gjithë këtë. Gabimi më i madh është dështimi në hedhjen e hapit të parë. Mbaj lidhje me shumë njerëz që kanë nevojë për para dhe kam një fond për njerëz të tillë (i quajtur “Projekte të Veçanta”), por a e gjeni dot pse aq shumë njerëz kurrë nuk marrin para? ATA KURRË NUK KËRKOJNË. Meqë ra fjala, ka libra fantastikë rreth mënyrës për të ngritur fonde dhe jam bekuar prej tyre, veçanërisht nga “Funding the Family Business” (Stewardship, 2006) nga Majllz Uillsën (Myles Wilson) dhe “Friend Raising” (YWAM, 2012) nga Beti Barnet (Betty Barnett).

11. Përpiquini të keni njëfarë mentorimi dhe llogaridhënieje edhe kur marrëdhënia duket e papërsosur dhe spazmodike. Nëse jeni të martuar, sigurohuni që po kaloni mjaft kohë me bashkëshorten dhe familjen. Mos prisni të jetë e lehtë. Gjatë gjithë jetës sonë Drena dhe unë e kemi pasur betejë të veçantë lutjen më shumë sëbashku. Dhe mbani mend, nëse keni beteja serioze me epsin ose pornografinë, JU duhet vërtet të kërkoni që t'ju ndihmojnë.

Nëse keni përfunduar së lexuari librin tim, do të më pëlqente shumë të merrja një email prej jush, ku të më tregoni çfarë po bën Perëndia në jetën tuaj. Do të ishte gjithashtu ndihmë të dija nëse keni lexuar ndonjërin prej librave të mi të tjerë: “The Revolution of Love”, “Literature Evangelism”, “Hunger for Reality” (fillimisht “Come! Live! Die!”), “No Turning Back” (Paternoster, 2008) dhe “Drops from a Leaking Tap”. E kam të vështirë ta besoj se shpërndarja totale i ka kaluar 1,000,000 kopje në rreth pesëdhjetë gjuhë. Lavdi Zotit!

Për mua, përfundimi i këtij libri ka qenë maratonë e gjatë, por e shoh shiritin e finishit përpara dhe jam mirënjohës për gjithë **NDIHMËN** nga Lart gjatë rrugës. Jam mirënjohës për të gjithë njerëzit e mrekullueshëm të Perëndisë që e kanë ndikuar jetën time këto shtatëdhjeteshtatë vjet dhe thjesht përulem para Perëndisë në falënderim dhe adhurim.

LEXIME TË KËSHILLUARA

Alexander Strauch, “If You Bite and Devour One Another” (Lewis and Roth, 2011)

Alexander Strauch, “Leading with Love” (Lewis and Roth, 2006)

Andrew Murray, “Humility” (CreateSpace, 2012)

Betty Barnett, “Friend Raising” (YWAM, 2012)

Billy Graham, “Freedom From The Seven Deadly Sins” (Zondervan, 1963)

Billy Graham, “Peace with God” (Thomas Nelson, 2000)

Billy Graham, “The Secret of Happiness” (Thomas Nelson, 2002)

Brennan Manning, “The Ragamuffin Gospel” (Multnomah, 2005)

Charles Swindoll, “The Grace Awakening” (Thomas Nelson, 2006)

Chris Wright (ed.), “John Stott: A Portrait by His Friends” (IVP, 2011)

Chua Wee Hian, “Learning to Lead” (Authentic India, 2010)

David Platt, “Radical” (Random House, 2010)

Debbie Meroff, “Psalms from the Sea” (Amazon, 2012)

- Elaine Rhoton, "The Doulos Story" (BookRix, 2014)
- Elaine Rhoton, "The Logos Story" (Paternoster, 1992)
- Elisabeth Elliot, "Through Gates of Splendour" (Authentic Media, 2005)
- Gary Witherall, "Total Abandon" (Tyndale House, 2005)
- Gordon MacDonald, "Ordering Your Private World" (Thomas Nelson, 2012)
- Gordon MacDonald, "Rebuilding Your Broken World" (Thomas Nelson, 2004)
- Hanna Zack Miley, "A Garland from Ashes" (Outskirts, 2013)
- Hoise Birks, "A New Man" (H B Publishing, 2012)
- Ian Randall, "Spiritual Revolution" (Authentic Media, 2008)
- J. David Lundy, "Servant Leadership for Slow Learners" (Paternoster, 2002)
- J. Oswald Sanders, "Spiritual Leadership" (Moody, 2007)
- John Rinehart, "Gospel Patrons" (Reclaimed Publishing, 2014)
- John Stott, "Basic Christianity" (IVP, 2012)
- Joseph D'Souza, "Dalit Freedom: Now and Forever" (Dalit Freedom Network, 2005)

Myles Wilson, "Funding the Family Business" (Stewardship, 2006)

Noah (film), me regji të Darren Aronofsky (2014)

Norman Vincent Peale, "The Tough Minded Optimist" (Touchstone, 2003)

Oswald Smith, "The Passion for Souls" (Welch, 1986)

Patrick Dixon, "AIDS Action" (Bookprint Creative, 2010)

Peter Greig, "God on Mute" (Regal, 2007)

Peter Haas, "Pharisectomy: How to Joyfully Remove Your Inner Pharisee and Other Religiously Transmitted Diseases" (Influence Resources, 2012)

Philip Yancey, "Disappointment with God" (Zondervan, 2009)

Philip Yancey, "What's So Amazing About Grace?" (Zondervan, 2002)

Quo Vadis (film), me regji të Mervyn LeRoy (1951)

R.T. Kendall, "Holy Fire" (Charisma House, 2014)

R.T. Kendall, "Total Forgiveness" (Hodder & Stoughton, 2010)

Randy Alcorn, "The Grace and Truth Paradox" (Multnomah, 2003)

Randy Alcorn, "Why Pro-Life?: Caring for the Unborn and Their Mothers" (Hendrickson, 2012)

Rodney Hui dhe George Simpson, “Logos HOPE” (BookRix, 2014)

Ron Dunn, “When Heaven is Silent” (Paternoster, 1994)

Roy Hession, “The Calvary Road” (CLC, 1980)

Theodore Epp, “Love is the Answer” (Back to the Bible, 1960)

Tom Hovestol, “Extreme Righteousness” (Moody, 1997)

Viv Thomas, “Second Choice” (Paternoster, 2000)

William MacDonald, “True Discipleship” (Gospel Folio, 2003)

VEPRA TË TJERA NGA XHORXH VERUER

Në rend reference:

“Hunger for Reality” (Authentic Lifestyle, 1996) – fillimisht i titulluar “Come! Live! Die!”

“Drops from a Leaking Tap” (Authentic Media, 2011)

“Out of the Comfort Zone” (Bethany House, 2000)

“Grace Awakened Leadership” – një libërth që bashkon kapitujt “Grace” dhe “Leadership” nga “Out of the Comfort Zone” (Bethany House, 2000)

“The Revolution of Love” (Authentic Media, 2008)

“Book by Book: Proverbs”, DVD (Biblical Frameworks, 2015)

“Book by Book: Proverbs Study Guide”, shkruar nga Paul Blackham (Biblical Frameworks, 2015)

“George – for real”, DVD (CWR, 2015)

“Literature Evangelism” (Authentic Lifestyle, ribotuar në vitin 2003) – libri i parë i Xhorxhit

“No Turning Back” (Paternoster, 2008)

Xhorxhi – vërtet (DVD)

Ndiqni Xhorxh Veruerin në udhëtimet e tij në Indi, Meksikë, Hong Kong, MB dhe në qytetin ku banon, Nju Xhersi (New Jersey) dhe zbuloni se hiri i Perëndisë nuk ka kufizime. Ky dokumentar me xhirime të paplanifikuara kap energjinë, entuziazmin, vizionin dhe natyrën njerëzore të jetës dhe misionit të një njeriu. Historia e Xhorxhit, themeluesit të “Operation Mobilisation”, frymëzon, sfidon dhe nxit ata që pyesin veten nëse Perëndia mund t’i përdorë ndonjëherë për lavdinë e Tij.

DVD – Afërsisht 55 minuta

EAN: 5027957-001602